



UNITED NATIONS  
NORTH MACEDONIA



# 2020

## RAPORTI I REZULTATEVE VJETORE TË OKB-SË NË MAQEDONINË E VERIUT

MAJ 2021





**UNITED NATIONS  
NORTH MACEDONIA**



**Food and Agriculture  
Organization of the  
United Nations**



**IAEA**



**International  
Labour  
Organization**



**IOM  
UN MIGRATION**



**UNITED NATIONS  
HUMAN RIGHTS  
OFFICE OF THE HIGH COMMISSIONER**



**UNDRR  
UN Office for Disaster Risk Reduction**



**UNECE**



**UN  
environment  
programme**



**United Nations  
Educational, Scientific and  
Cultural Organization**



**UNHCR  
The UN Refugee Agency**



**UNODC  
United Nations Office on Drugs and Crime**



**UNOPS**



**THE WORLD BANK  
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP**



**World Health  
Organization**



**UN  
VOLUNTEERS**

## FALËNDERIM

Ky dokument është përpiluar nga Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara (ZKP) në Maqedoninë e Veriut në emër të ekipit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut. ZKP-ja dëshiron ta njohë kontributin e të gjithë palëve të përfshira në përgatitjen e këtij dokumenti.

Versioni i fundit i këtij dokumenti është në dispozicion në ueb faqen e OKB-së për Maqedoninë e Veriut në [northmacedonia.un.org](http://northmacedonia.un.org). Për më shumë informacione, ju lutemi kontaktoni: ZKP-në të OKB-së në Maqedoninë e Veriut [rc-northmacedonia@un.org](mailto:rc-northmacedonia@un.org).

Fotoja e kopertinës: Një fëmijë me çrregullim të spektrit autik dhe nëna e tij, shfrytëzues të një platforme arsimore në internet të zhvilluar nga OKB-ja, e cila ka marrë një rëndësi të shtuar përgjatë pandemisë KOVID-19. Foto © UNFPA

Shënimet e dhëna në këtë botim dhe prezantimi i materialit nuk e nënkuptojnë shprehjen e ndonjë mendimi të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin ligjor të çdo vendi, territori, qyteti ose zone ose të autoriteteve të tij, ose në lidhje me caktimin e kufijve të tij.

Të dhënat financiare janë të përkohshme dhe mund të ndryshojnë në bazë të certifikimit financiar.

# Përmbajtja

---

<b>PARATHËNIA</b> .....	<b>4</b>
<b>EKIPI I OKB-SË NË VEND</b> .....	<b>5</b>
<b>PARTNERËT KRYESORË TË OKB-SË PËR ZHVILLIM</b> .....	<b>6</b>
<b>ZHVILLIMET KRYESORE TË SHTETIT NË VITIN 2020</b> .....	<b>7</b>
<b>PASQYRA E REZULTATEVE TË VITEVE 2016-2020</b> .....	<b>9</b>
<b>REZULTATET E VITIT 2020*</b> .....	<b>13</b>
Më shumë vende pune dhe më cilësore .....	13
Qeverisje më përgjegjëse .....	14
Jetë më të mirë për personat vulnerabil .....	15
Mjedisi jetësor dhe reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë .....	16
Barazia gjinore .....	17
<b>PËRGJIGJA NDAJ KOVID-19</b> .....	<b>18</b>
<b>PARTNERITETET DHE FINANCIMI I QZHQ-VE</b> .....	<b>20</b>
<b>EVALUIMI DHE MËSIMET E MARRA</b> .....	<b>21</b>
<b>KOHERENCA, EFEKTSHMËRIA DHE EFIKASITETI I OKB-SË</b> .....	<b>22</b>
<b>MOBILIZIMI I FINANCAVE DHE RESURSEVE</b> .....	<b>24</b>
<b>OKB-JA NË MAQEDONINË E VERIUT NË VITIN 2021</b> .....	<b>26</b>
<b>SHTOJCAT: LISTA E SHKURTESAVE DHE PARTNERËVE</b> .....	<b>27</b>

\* Për më shumë detaje të rezultateve të Raportit 2020, në bazë të prodhimeve, shihni shtojcën e Raportit.

---

# Parathënia

“*Pandemia KOVID-19 është njëra ndër sfidat më të rrezikshme, me të cilat është përballë bota gjatë jetës sonë. Ajo është mbi të gjitha një krizë njerëzore me pasoja të rënda shëndetësore dhe socio-ekonomike.*”  
António Guterres, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së

Në fund të vitit 2019 përgatitëm për një vit të ngarkuar: OKB-ja në Maqedoninë e Veriut kishte plane ambicioze për arritjen e rezultateve për ciklin e zbatimit 2016-2020, për ta ndihmuar vendin me përshejtimin e aktiviteteve drejt arritjes së Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ) deri në vitin 2030 dhe njëkohësisht të angazhohet me partnerët dhe njerëzit në Maqedoninë e Veriut në një proces konsultativ për t'i identifikuar përparësitë tona të përbashkëta strategjike për vitet para nesh.

Në atë pikë askush nuk i imagjinonte sfidat, vuajtjet njerëzore dhe katastrofën socio-ekonomike, gjegjësisht intensitetin e vitit në vijim. Viti 2020 ishte test për botën dhe bashkësinë ndërkombëtare, për rajonin, për Maqedoninë e Veriut, për komunitetet tona, për të gjithë ne si individë dhe për OKB-në. Ky është një test që ne vazhdojmë ta bëjmë dhe do ta bëjmë, duke e testuar forcën e sistemeve tona, shkathtësinë dhe qëndrueshmërinë tonë, por edhe vizionin dhe aftësinë tonë për të menduar dhe vepruar ndryshe, gjegjësisht për t'u rimëkëmbur më mirë.

OKB-ja në Maqedoninë e Veriut e përkrahu me vendosmëri përgjigjen ndaj KOVID-19 që nga fillimi përmes riprogramimit, koordinimit, politikës dhe mbështetjes logjistike për Qeverinë. Fokusi ynë u zhvendos shpejt në ndikimin afatmesëm dhe afatgjatë të krizës, aspektet e saj socio-ekonomike dhe efektin shqetësues që ajo pati tek më të prekshmit dhe ata që mbeten më larg.

Në këtë kuptim, viti 2020 ishte veçanërisht sfidues pasi që vazhdimisht kërkonte një ekuilibrim midis mbështetjes së përgjigjes së bazuar në prova, përgjigjes së ndjeshme ndaj gjinisë, përgjigjes së bazuar në dialog dhe të menduarit dhe veprimit duke pasur parasysh të ardhmen, e cila shpesh përfshinte shkëmbime të vështira.

Duke punuar për së afërmi me Qeverinë e Maqedonisë së Veriut dhe partnerët tjerë, arritëm sukses në sigurimin e përqendrimit në zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmbushjen e QZHQ-ve - vizion i yni i përbashkët për t'i dhënë fund varfërisë, për ta shpëtuar planetin dhe për të ndërtuar një botë paqësore. Sidoqoftë, ne ishim mjaft fleksibil, në mënyrë që të mund të merreshim me vështirësi dhe sfida tjera, që duhej t'i trajtonim bashkërisht në vitin 2020.

Qeveria, e mbështetur nga OKB-ja dhe partnerët tjerë, meriton lëvdata për qëndrimin e saj të përkushtuar për ta përgatitur dhe paraqitur Rishikimin e saj të Parë Vullnetar Nacional (RVN) që e vuri në pah angazhimin e saj të ri për Agjenda 2030, madje edhe gjatë kohërave të vështira. Kjo ishte një deklaratë e fortë që demonstronte përkushtimin ndaj botës dhe njerëzve të Maqedonisë së Veriut në lidhje me

rëndësinë që i kushtohet përmirësimit të cilësisë së jetës dhe zhvillimit të qëndrueshëm në vend.

Në të njëjtin kontekst, OKB në Maqedoninë e Veriut e riafirmoi angazhimin e saj për ta mbështetur vendin në përpjekjet e saja të zhvillimit të qëndrueshëm, siç pasqyrohet në dokumentin e saj kryesor strategjik, Korniza e Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2021-2025 (KBZHQ). Në vitet para nesh, do të vazhdojmë t'i përgjigjemi dhe mbështesim përparësitë dhe reformat strategjike nacionale dhe ta mbështesim procesin e pranimit në BE, me fokus të veçantë për të siguruar që askush të mos lihet pas, veçanërisht duke u përqendruar në barazinë gjinore dhe respektimin e të drejtave të njeriut për të gjithë në Maqedonia e Veriut.



Ne do të vazhdojmë të jemi partner mbështetës dhe i besueshëm i të gjitha segmenteve të shoqërisë së Maqedonisë së Veriut, duke mos u shmangur nga ideja se disa mund të jenë më të prekshëm se të tjerët dhe se ata kërkojnë përpjekjet dhe vëmendjen tonë të shtuar për të mos ngel askush pas. Ne do ta bëjmë këtë duke vepruar bashkërisht si një OKB dhe duke siguruar që të gjithë njerëzit, të cilëve iu shërbejmë, të përfitojnë nga mandatet, ekspertiza dhe përpjekjet tona unike dhe kolektive. Ne do ta bëjmë këtë si një organizatë që e përkrah inovacionin dhe efikasitetin, e promovon përsosmërinë, transparencën dhe llogaridhënie dhe ofron ekspertizë. Ne do ta bëjmë këtë në mbështetje të vizionit të zhvilluar në nivel nacional të vendit, që e pasqyron konsensusin ndërmjet brezave, atë ndëretnik, ndërpartiak dhe gjinor, duke pasur parasysh interesin më të mirë të njerëzve të Maqedonisë së Veriut.

## Rosana Duxhak

Koordinatorë e Përhershme e OKB-së në Maqedoninë e Veriut



# Ekipi i OKB-së në vend

Kombet e Bashkuara në Maqedoninë e Veriut punuan drejt përparësive strategjike të identifikuar në Partneritetin për Zhvillim të Qëndrueshëm 2016-2020 (PZhQ), dokumenti kryesor strategjik, i cili u pasua nga strategjia e re pesëvjeçare (KBZhQ 2021-2025) e miratuar në vitin 2020.

Puna e OKB-së kontribuon në zhvillimin nacional dhe përparësitë strategjike të vendit, angazhimet e tij ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore dhe angazhimet për përmbushjen e QZhQ-ve.

PZhQ 2016-2020 u përkufizua rreth pesë fushave prioritare: më shumë punë dhe më cilësore, qeverisje më të përgjegjshme, jetë më të mirë për njerëzit e pambrojtur, barazi gjinore dhe mjedis më të pastër, të gjelbër, më elastik. Për secilën prej tyre, një deklaratë ombrellë e rezultateve i ka përcaktuar qëllimet e përbashkëta që OKB-ja, Qeveria dhe partnerët e kanë ndjekur bashkërisht deri në vitin 2020:

**1** më shumë gra dhe burra janë në gjendje ta përmirësojnë jetën e tyre, duke siguruar punësim të denjë dhe të qëndrueshëm në ekonomi garuese që është në rritje dhe me punë të larmishme;

**2** institucionet nacionale dhe lokale janë më mirë në gjendje t'i hartojnë dhe realizojnë shërbimet e cilësisë së lartë për të gjithë përdoruesit, edhe atë në mënyrë transparente, me kosto efektive, jodiskriminuese dhe me ndjeshmëri gjinore.

**3** më shumë anëtarë të grupeve të përjashtuara sociale dhe vulnerable janë të fuqizuara për t'i ushtruar të drejtat e tyre dhe për të gëzuar jetë më të mirë cilësore dhe qasje të barabartë në shërbimet themelore;

**4** individët, sektori privat dhe institucionet shtetërore i mbështesin veprimet e tyre në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, ndërsa komunitetet janë më të qëndrueshme ndaj katastrofave dhe rreziqeve të mjedisit jetësor; dhe

**5** institucionet shtetërore janë plotësisht të përgjegjshme ndaj barazisë gjinore dhe angazhimeve kundër diskriminimit, andaj më shumë gra dhe vajza bëjnë jetë të lirë nga diskriminimi dhe dhuna.

Në vitin 2020, 24 agjenci të Kombeve të Bashkuara janë angazhuar në aktivitete operative ose mbështetëse për zhvillim në Maqedoninë e Veriut, duke punuar së bashku përmes Ekipit të Kombeve të Bashkuara në vend (UNCT) dhe nën udhëheqjen e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së (KP), përfaqësuesit të ngarkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së për operacionet e zhvillimit në vend.

Midis tyre, 17 kanë pasur prani fizike në Maqedoninë e Veriut – qoftë përmes një zyre përfaqësuese të pavarur, stafit të projektit ose kapacitetit të përfshirë në Zyrën e Koordinatorit të Përhershëm (ZKP) – ndërsa katër agjenci i kanë kryer aktivitetet e tyre plotësisht nga distanca.

## 24

Agjencitë e OKB-së të angazhuara në aktivitete operative për zhvillim në Maqedoninë e Veriut

Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Maqedoninë e Veriut në vitin 2020 përfshiu më shumë 250 punonjës dhe personel mbështetës nacional dhe ndërkombëtar, të mbështetur nga ekspertë dhe personel nga zyrat rajonale dhe të selisë në të gjithë globin.

FAO	Organizata e OKB-së për Ushqim dhe Bujqësi
IAEA	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike *
ILO	Organizata Botërore e Punës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IOM	Organizata Botërore për Migracion
ITU	Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit *
OHCHR	Zyra e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNDRR	Zyra e OKB-së për Zvogëlim të Rreziqeve nga Katastrofat *
UNDSS	Departamenti i OKB-së për Siguri
UNECE	Komisioni Ekonomik për Evropë i Kombeve të Bashkuara *
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Jetësor
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë *
UNFPA	Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
UNIDO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve
UNV	Vullnetarët e Kombeve të Bashkuara *
UN RCO	Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së
UN Women	Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave
WB	Grupi i Bankës Botërore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

\* pa prezencë fizike pa nënshkrim të PZhQ-së



# Zhvillimet kryesore të shtetit në vitin 2020

## Viti sfidues politik fuqishëm i ndikuar nga KOVID-19

Në vitin 2020, Maqedonia e Veriut përgatiti Raportin e saj të parë Vullnetar Nacional (VNR), që shërben si bazë për përparim në raport me QZHQ-të, duke shënuar arritje të rëndësishme në kategoritë e njerëzve dhe prosperitetit. Vendi e ka përbushur një nga përparësitë e tij të gjata strategjike - anëtarësimin në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Në pamundësi për t'i filluar negociatat e aderimit në Bashkimin Evropian (BE), zgjedhjet e parakohshme parlamentare ishin planifikuar për në prill të vitit 2020, me Qeverinë teknike të themeluar në janar të vitit 2020.


Në këtë mënyrë shpërthimi i KOVID-19 në muajin mars e gjeti vendin me një Qeveri teknike dhe një Parlament të shpërndarë, gjë që e komplikoi ndjeshëm përgjigjen ndaj KOVID-19 pasi Qeveria kishte kompetenca dhe mandat të kufizuar për miratim të masave urgjente dhe komplekse ndaj pandemisë. Për ta kapërcyer këtë, Presidenti shpalli dhe zgjati dy herë gjendjen e jashtëzakonshme, e cila e fuqizoi Qeverinë teknike për t'iu përgjigjur me vendosmëri pandemisë. Për shkak të krizës së vazhdueshme, zgjedhjet u shtynë për në korrik, duke rezultuar në një rizgjedhja të ngushtë të qeverisë së koalicionit.

Ndikimi i krizës KOVID-19 i ndërpreu fitimet e zhvillimit të qëndrueshëm të dekadës së fundit. Ndikimi ndaj shëndetit ishte relativisht i moderuar dhe i mirëmenaxhuar gjatë gjithë vitit, megjithëse sistemi shëndetësor është përballë me një numër sfidash, kryesisht për shkak të burimeve të kufizuara, pajisjeve dhe materialeve. Nga ana psiko-sociale çrregullimi i arsimit në të gjitha nivelet i rrezikoi rezultatet e të nxënësve për shumë gjenerata, ndërsa vetë-izolimi, pasiguria financiare, frika dhe ankthi kontribuan në çrregullime psiko-sociale dhe e rritën dhunën gjinore dhe familjare deri në 45%, kurse fëmijët bënë 10% të viktimave.


Ndikimi i menjëhershëm ekonomik i KOVID-19 u shkaktua nga zinxhirët e furnizimit të vonuar dhe të ndërprerë, duke prekur kryesisht industrinë e orientuar drejt eksportit të varura shumë nga tregu i BE-së. Pasiguritë në ushqimin dhe furnizimet mjekësore për fat të mirë ishin jetëshkurtra për shkak të vendosjes së shpejtë të korsive të gjelbërta midis Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe vendeve të BE-së. Ndalimi i aktiviteteve shoqërore preku kryesisht mikro ndërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla në sektorin e hotelerisë (mikpritjes) dhe kulturës, ndërsa ndalimi i udhëtimit i preku sektorët e turizmit dhe transportit, dhe punëtorët sezonal. Situata u rëndua më tej gjatë tremujorit të dytë të vitit, kur u ndje ndikimi më i fortë ndaj ekonomisë, ndërsa ndikimi në shëndetësi ishte më i forti në tremujorin e fundit.

Kriza e shkaktuar nga KOVID-19 e shpiu ekonominë në recesionin më të thellë në më shumë se dy dekada, me 4.5% rënie vjetore. Rreth 90,000 vende pune janë vlerësuar si të humbura (Modeli Icasting i ILO-s); ndërsa ndikimi në papunësinë e përgjithshme ishte i moderuar, ajo u pasua nga tendencat e pasivitetit në rritje, të ardhurat e reduktuara të punës dhe remitancave. Humbja e prodhimit të [brendshëm është vlerësuar në 3.7 miliardë euro](#), duke prekur kryesisht industrinë e lëkurës, tekstilit, automobilizmit, pajisjeve elektrike, shitjes me pakicë dhe shërbimeve të mikpritjes. Çmimet e produkteve industriale dhe ushqimore u rritën për 3% midis janarit dhe gushtit të vitit 2020, duke i ngritur kështu më tej nivelet e varfërisë.

Ilustrim: Shkallët e rritjes së BPV-së së Maqedonisë së Veriut 2011-2020 shkalla e rritjes vjetore



2020 shkalla e rritjes tremujore




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, 2021

Më rëndë janë goditur prindërit e vetëm, punëtorët tepriçë mbi 50 vjeç, hyrësit e rinj në tregun e punës dhe të papunët afatgjatë. [Gratë ishin veçanërisht të goditura më rëndë](#) për shkak të ekspozimit të lartë ndaj sektorëve më të prekur si kujdesi shëndetësor dhe ekonomia joformale, gjegjësisht rritja disproporcionale e përgjegjësisë në shtëpi. [Rreth 16,000 fëmijë ka të ngjarë të kenë rënë nën pragun e varfërisë për shkak të krizës KOVID-19 në vitin 2020.](#)

Përgjigja ndaj krizës [krijoi një presion shtesë mbi qeveritë lokale në kontekstin e burimeve tashmë të cunguara](#). Në tremujorin e dytë të vitit 2020, të ardhurat komunale janë rritur me vetëm 1.8% krahasuar me 11.8% në tremujorin e parë, kryesisht si rezultat i uljes së taksës së pronës, madje më të theksuar në


## Indikatorët kryesor socio-ekonomik, 2011-2020




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, 2021

**Rrjedha e migracionit të përzier në Maqedoninë e Veriut**

2011-2020 rrjedha vjetore e migracionit, të ardhurit e rinj



2018-2020 rrjedha mujore e migracionit, të ardhurit e rinj



Burimi: UNHCR (2021), Qeveria e Maqedonisë së Veriut, AJRM (MYLA) (2015-2016)

komunat urbane. Në të njëjtën kohë, shpenzimet komunale kanë rënë mesatarisht për 17.8%, me përjashtim të subvencioneve publike, të cilat u janë rritur ndjeshëm. Shumica e shërbimeve komunale ishin të pandërprera dhe u mbështetën nga shërbimet vullnetare në rritje për shpërndarjen e pakove humanitare, ndonëse protokollet e punës në çerdhe, kopshte dhe qendra ditore kanë vazhduar të jenë sfiduese.

Rreth 1.2 miliardë euro - mbi 10% të BPV-së janë injektuar në përgjigjen dhe rimëkëmbjen e krizës COVID-19 nga Qeveria në vitin 2020, duke siguruar transferime parash për popullatën, mbështetje të pagave, përjashtime nga taksat dhe shtyrje të pagesave, kredi të favorshme për kompanitë, si dhe zbatimin e masave për përmirësim të ambientit të biznesit në mbështetje të digjitalizimit, uljes së tarifave doganore dhe shpenzimeve parafiskale. Këto masa arritën të ulnin rënien ekonomike në gjysmën e dytë të vitit, por gjithashtu e shtynë borxhin publik në

mbi 60% të BPV-së, gjë që mund të jetë kritike për ekonominë e Maqedonisë së Veriut, në rast se çalojnë rimëkëmbjet e ardhme.


Ndotja e ajrit dhe ndotja e trupave ujorë, menaxhimi jo i duhur i mbetjeve, ndikimi i ndryshimit të klimës, humbja e biodiversitetit dhe degradimi i pyjeve mbetën shqetësimet kryesore mjedisore në vitin 2020, me gjetjet veçanërisht alarmante në lidhje me gjendjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit. Sidoqoftë, angazhimi i Qeverisë për të rritur zvogëlimin e emetimit të gazit serrë në nivel nacional deri në 51% në vitin 2030 krahasuar me 1990, si dhe planet për t'u rreshtuar me Planin e Gjelbër të BE-së sigurojnë hapësirë optimizmi për Ballkanin Perëndimor. Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i masave të përgjigjes KOVID-19 kontribuuan në mënyrë të konsiderueshme drejt sigurimit të energjisë së përballeshme dhe të pastër dhe orientimit drejt burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Një hap i rëndësishëm është bërë drejt barazisë, kur Parlamenti miratoi përsëri Ligjin kundër diskriminimit që tani është në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke njohur në mënyrë të qartë orientimin seksual dhe identitetin gjinor si arsye mbrojtëse. Progres është bërë drejt barazisë gjinore dhe luftimit të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Qeveria promovoi dhe siguroi konsultime kuptimplota me protagonistët të ndryshëm, ndërsa shoqëria civile në vend vazhdoi ta luajë në mënyrë aktive rolin e kujdestarit. Sidoqoftë, kapacitetet dhe burimet administrative në nivelin lokal dhe qendror mbetën të kufizuara, me një hendek të konsiderueshëm në sigurimin e shërbimeve digjitale. Korrupsioni vazhdoi të jetë i përhapur, përkundër angazhimit të Qeverisë për ta adresuar atë.


Vendi gjendet përgjatë njëres prej rrugëve kryesore të lëvizjeve të përziera migruese në Evropë, gjë që ka rezultuar në më shumë se 41,000 migrantë që kanë tranzituar në vitin 2020, kryesisht nga Afganistani, Pakistani dhe vendet e tjera. Migrantët kanë ngel jashtëzakonisht të prekshëm, shpesh udhëtojnë në grupe të mëdha të ekspozuar ndaj rrezikut më të lartë të transmetimit të COVID-19. Të paktën 40,000 punëtorë migrantë sezonalë nga Maqedonia e Veriut janë prekur veçanërisht nga mbyllja e kufijve, gjë që ka çuar në një rënie të dërgesave të parave dhe zvogëlim të mbështetjes për familjet e lëna pas. Autoritetet zhvilluan një "Strategji pesëvjeçare të Luftimit të Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migracionit të Paligjshëm" dhe vazhduan të luftojnë krimin e organizuar ndërkufitar. Në vitin 2020, kontrabanda e migrantëve të zbuluar është rritur për 17.3% nga viti i kaluar, ndërsa 91 persona janë persekutuar për 65 raste të kontrabandës.

**Pjesa e indikatorëve kryesor socio-ekonomik dhe rajoneve të BPV-së nacionale**

Viti fillestar përballë vlerës më të fundit të disponueshme, pjesa e BPV-së rajonale për vitin 2019



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, UNDP (Raportet e Zhvillimit Njerëzor), Fondi për Inovacion Njerëzor





# Pasqyra e rezultateve të viteve 2016-2020

Në këtë pjesë theksohet kontributi i OKB-së në Maqedoninë e Veriut dhe rezultatet nga puna me Qeverinë, shoqërinë civile dhe partnerët për zhvillim në 5 fusha të PZhQ-së - punësimi i qëndrueshëm, qeverisja demokratike, mjedisi i përfshirjes sociale dhe zvogëlimi i rrezikut nga katastrofat, dhe barazia gjinore - gjatë periudhës 2016-2020.

## PZHQ-ja dhe prioritetet nacionale

Zbatimi i PZHQ-së u zhvillua përballë ndryshimit të shpejtë të kontekstit politik dhe zhvillimor në Maqedoninë e Veriut dhe rajonin, të shënuar nga krizë politike në vend gjatë viteve 2015/16 dhe krizës së migracionit në 2016. Përparimi në marrëdhëniet me fqinjët rezultoi me ndryshimin e emrit kushtetues në vitin 2018, të ndjekur më pas me anëtarësimin në NATO dhe përpjekjet e vazhdueshme për të përparuar në procesin e integritimit Euro-Atlantik. Kulmi i të gjithave ishte me krizën globale KOVID-19 të vitit 2020.

Para krizës KOVID-19, përfitimet e përgjithshme kanë qenë të konsiderueshme në disa fusha të zhvillimit të qëndrueshëm - pabarazia, varfëria - dhe të qëndrueshme në të tjera - qeverisja, mjedisi jetësor. Në vitin 2020, përkundër goditjeve, stimujt e Qeverisë parandaluan një goditje më të rëndë ndaj ekonomisë dhe papunësisë, ndonëse ndikimi i vërtetë i pandemisë ende nuk është parë.

Në mungesë të një strategjie gjithëpërfshirëse afatgjatë nacionale të zhvillimit, prioritetet e zhvillimit përcaktohen në disa strategji sektoriale dhe plane veprimi të përafëruara me agjendën e aderimit në BE dhe me programet e Qeverisë. Programi i Qeverisë 2017-2020 u përqendrua në (1) rritjen ekonomike, rritjen e punësimit, standardet më të larta të jetesës; (2) anëtarësimin në NATO dhe BE; (3) një shoqëri për të gjithë; (4) qeverinë e përgjegjshme dhe mbikëqyrjen e qeverisë; (5) institucionet në shërbim të qytetarëve; dhe, (6) investimet e rritjes së qëndrueshme.

Rezultatet e PZhQ-së iu përgjigjën drejtpërdrejt këtyre prioritetëve, duke kontribuar në objektivat më të rëndësishme të zhvillimit të vendit dhe duke i mbështetur reformat e procesit të aderimit në BE. Me angazhimin e riafirmuar në Agjendën 2030 gjatë 2018-2020, Qeveria zgjodhi QZhQ-të 1, 4, 8, 13 dhe 16 si QZhQ me prioritet.

Me miratimin e PZhQ-së dhe miratimin e Qeverisë, njësitë e OKB-së e miratuan realizimin e punës përmes një qasje të vetme, e cila e mandatonte planifikimin, raportimin dhe zbatimin e përbashkët. Zbatimi i PZHQ-së ishte planifikuar në tre plane pune të përbashkëta (2016, 2017-2018 dhe 2019-2020), të cilat u zbatuan plotësisht. Për vlerësimin përfundimtar të PZhQ-së të kryer në fund të vitit 2019, PZhQ-ja u vlerësua se është e harmonizuar dhe e përgjegjshme ndaj objektivave afatgjata të vendit, gjegjësisht QZhQ-ve përkatëse dhe nevojat aktuale, veçanërisht ato për njerëzit më të prekshëm dhe të marginalizuar.

## Më shumë punë për të gjithë

Rritja e pamjaftueshme ekonomike, nivelet e larta të papunësisë dhe varfëria e të ardhurave ishin sfidat kryesore të zhvillimit të identifikuar dhe ndër përparësitë më të larta të Qeverisë në Evropë periudha e formulimit të PZhQ-së. Veprimet e ndërmarra midis viteve 2016-2020 dhanë rezultate të dukshme, me një

rënie të shkallëve të papunësisë prej 40%, nga 26.1% në 2015 në 16.1% në tremujorin e katër 2020.

OKB-ja ishte një kontribuues me vlerë përmes ndërhyrjeve në të gjitha nivelet - duke mbrojtur dhe mbështetur zhvillimin e politikave të punës dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme NVM-ve, duke punuar me autoritetet për t'i rregulluar programet mësimore të arsimit me nevojat e tregut dhe për zbatim të masave të synuara aktive të tregut të punës (MATP) dhe programet e zhvillimit të aftësive. Gjithashtu OKB-ja i ka ndërtuar kapacitetet e institucioneve nacionale dhe partnerëve socialë për ta përmirësuar ekosistemin e biznesit përmes dialogut kuptimplotë social, iniciativave efektive të vetpunësimit, rritjen e konkurrencës së sektorit privat dhe mbështetjen për inovacion.

Përmes Programit të Punëve të Komunitetit, OKB-ja e ka promovuar punësimin e njerëzve me vulnerabilitet (veçanërisht, gratë e papunë) për ofrimin e shërbimeve sociale për grupet e ndjeshme, kryesisht të moshuar, fëmijët e moshës parashkollore dhe personat me aftësi të kufizuara (PAK), si dhe rritjen e punësimit dhe punësimin e stimuluar të romëve dhe PAK-ve. Janë krijuar 6,298 vende pune me kohë të plotë (38% gra), 5483 kompani të reja të krijuara (rreth 13% e të gjitha kompanive të krijuara në vend, 36% në pronësi të të rinjve), mbi 50,000 njerëz të përfshirë në trajnime të ndryshme ose programe tjera mbështetëse të punësimit; dhe mbi 56,605 persona në nevojë morën shërbime sociale përmes ndërhyrjeve programore midis 2016-2020.



*Në vitin 2019, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave nisi një masë të re që synon t'u japë grave prodhuese bujqësore mbështetje financiare për ta përmirësuar situatën e tyre ekonomike. Ky ndryshim i politikës ishte një përpjekje bashkëpunuese midis UN Women, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe Grupit të punës për barazi gjinore të krijuar brenda Ministrisë, që përfaqëson institucionet kryesore, akademinë dhe organizatat e shoqërisë civile.*

Foto©UN Women/Dimitrovski



*Partneriteti Lokal i Punësimit është një mjet i ILO-s për ta nxitur tregun e punës nga poshtë-lart, me zgjidhje lokale për sfidat specifike, me të cilat përballen bashkësitë lokale. Foto©ILO*



## Qeverisja e mirë

Në fushën e qeverisjes së mirë ka pasur përparimi modest në Maqedoninë e Veriut, megjithëse ofron optimizëm angazhimi i përtërirë i Qeverisë për ta forcuar sundimin e ligjit, qasjen në drejtësi, transparencë dhe llogaridhënie, si dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara në hapësirën publike. Në të kundërt, Maqedonia e Veriut ka bërë përparim të rëndësishëm në procesin e decentralizimit, madje kjo përvojë ka qenë transformuese për jetën e njerëzve të përfshirë.

Midis viteve 2016 dhe 2020, përveç ndihmës për politikën zhvillimit dhe implementimin, OKB i ka mbështetur analizat funksionale të institucioneve të sektorit publik, që synojnë shpërndarjen më efektive, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme të shërbimeve publike në nivelin qendror. Aderimi në BE u shfrytëzua përmes mbështetjes së Planit nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së (PNML), i cili përfshin portalin e qasshëm për publikun PNML, si dhe rreth 60 pjesë të legjislacionit të ndërlidhura me BE-në në fushat e reformës gjyqësore, energjisë, bujqësisë, mjedisit, tregtisë dhe arsimit – si dhe kapacitetet e rritura të 600 nëpunësve civilë, mbi gjysma e tyre gra, si rezultat i përgjithshëm i procesit të PNML-së. Po ashtu OKB-ja e ka mbështetur angazhimin e palëve të interesuara nacionale me mekanizmat ndërkombëtarë të drejtave të njeriut dhe e ka mbrojtur zbatimin e rekomandimeve përkatëse. Në nivelin lokal, OKB-ja ka kontribuar në rritjen e

*UNODC e mbështeti Maqedoninë e Veriut në rritjen e kontrollit kufitar dhe sigurinë e përgjithshme përmes krijimit të kornizave përkatëse ligjore dhe ndërtimit të kapaciteteve të policisë kufitare dhe doganave. Foto©UNODC*



*Pesëdhjetë oficerë të policisë kufitare nga aeroporti i Shkupit dhe Ohrit dhe nga katër qendrat rajonale të policisë kufitare patën mundësinë të njihen me konceptin e ndërmjetësimit kulturor dhe punën e ndërmjetësuesve për ndihmë. IOM Shkup ka organizuar trajnimin mbi "Kompetencën kulturore dhe vetëdijen", nën kujdesin e projektit rajonal IPA 2 "Mbrojtja e ndjeshme e menaxhimit të migracionit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi". Foto©IOM*



kapaciteteve dhe shërbimeve komunale, të vlerësuara rregullisht përmes anketave të kënaqësisë së qytetarëve, përmes së cilave synohet rritja e bashkëpunimit ndër-komunal, dialogut ndëretnik dhe kohezionit social. Krijimi i qendrave të biznesit dhe rrjeteve rajonale e mbështetën zhvillimin lokal dhe siguruan mbështetjen e nevojshme këshilluese dhe zbatuese.

Deri në fund të vitit 2020, 30 komunat kishin plane të integruara dhe gjithëpërfshirëse të zhvillimit lokal, 21 komuna prezantuan buxhetim të përgjegjshëm gjinor dhe më shumë se 1,000 anëtarë të këshillave komunale ishin të aftësuar për të marrë një rol më të fortë në vendimmarrjen dhe mbikëqyrjen lokale. Shoqëria civile dhe qytetarët ishin të fuqizuar që të mund të merrnin pjesë aktive në politikëbërjen dhe ofrimin e shërbimeve, shumë prej tyre duke e përdorur modelin e sapo hartuar të fondeve të bazuara në projekt nga buxhetet lokale të qeverisjes. Në përgjigje të krizës së migrantëve të vitit 2016, qytetit të Gjevgjeliës iu siguroi një deponi për mbeturina të ngurta dhe një spital të rinovuar, ndërsa spitali i Kumanovës e siguroi një njësi të re të ambulancës. Promovimi i inovacionit në sektorin publik ishte elementi shumë i rëndësishëm i punës së OKB-së, ose duke përdorur metodologji inovative për të ridizajnuar shërbime për shpërndarje të përmirësuar (për shembull: inovacion i hapur për bujqësi të përmirësuar, mendimi për

*Ekipi eBionics janë fituesit e përgjithshëm të sfidës globale të UNICEF-it për të rinj Generation Unlimited 2.0 në kategorinë nën 18 vjet, me zgjidhjen e tyre për të zgjeruar qasjen në kujdesin protetik me Venus Arm, një krah bionik i bërë me printer 3D, si burim të hapur për njerëzit me mungesë të gjymtyrëve të sipërme. Foto©UNICEF*



modelim të përmirësimit të punës së programit të bashkësisë, etj.). Laboratori i Qytetit të Shkupit i mbështetur nga OKB-ja ka ndihmuar në përmirësimin e përgjegjësisë dhe transparencës së Qytetit në ofrimin e shërbimeve dhe ka mundur testimin e një modeli tjetër të qeverisjes lokale. Sfidat e reja të UPSHIFT dhe të inovacionit Generation Unlimited kanë përfshirë një numër të konsiderueshëm të të rinjve në inovacione të hapura përmes ngritjes së kapaciteteve në të menduarit për modelim. Generation Unlimited shënoi arritje të veçanta - ekipet lokale të finalistëve që për dy vite morën pjesë në raundin global, në fund dolën si fitues.

## Përfshirja sociale

Në fushën e shërbimeve sociale, reformat e filluara u mbështetën nga OKB-ja në të tre sektorët - arsimi, shëndetësia dhe mbrojtja sociale, duke sjellë rezultate të konsiderueshme. Reforma e mbrojtjes sociale rezultoi në shpërndarje më adekuatë të përfitimeve të parave, duke kontribuar në uljen e niveleve të varfërisë. Sistemi shëndetësor përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë indikatorët, veçanërisht duke arritur ta ndryshojë trendin alarmues të vdekshmërisë së foshnjave nga 11.9/1.000 në 2017 në 5.6/1.000 në vitin 2019. Në fushën e arsimit, regjistrimi i fëmijëve në edukimin parashkollor është rritur nga 30% në 42%, madje vendi ka arritur të jetë në mesin e shteteve me përmirësim të lartë të rezultateve në PISA në të tre lëndët. Sigurimi i qasjes së plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme dhe parashkollorët arriti një pikë kthese dhe Qeveria u zotua të zëvendësojë të gjithë kujdesin e institucionalizuar për fëmijët dhe të rriturit, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, me shërbime alternative. Maqedonia e Veriut siguroi mbrojtjen e duhur për migrantët dhe refugjatët gjatë krizës në vitet 2015-2016 dhe më pas.

Ndihma e OKB-së ishte thelbësore në këto procese, duke vendosur fort punën e saj në gjenerimin e të dhënave dhe statistikave, për t'i ndihmuar institucionet përkatëse t'i zbatojnë politikat e synuara për të mos lënë askënd pas. Në të gjitha fushat e politikave, OKB-ja ka qenë një partner i zgjedhur për hartimin dhe zbatimin e reformave, strategjive dhe shërbimeve. OKB-ja ndihmoi në zhvillimin dhe zbatimin e Ligjit të ri për mbrojtjen sociale dhe një rishikim të madh të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve; një Plan të përgjithshëm për t'iu adresuar shkaqeve kryesore të vdekshmërisë së foshnjave; Plani nacional i veprimtimit për shëndetin seksual dhe riprodaktiv (ShSR) 2018-2020 me një sërë standardesh të cilësisë për shërbimet ShSR; si dhe një Ligj për Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe të Përkohshme dhe

*Pas një rritjeje të vdekshmërisë neonatale në vitin 2015, u ndërmor veprimi i shpejtë nga Ministria e Shëndetësisë me mbështetje teknike nga OBSH-ja, UNFPA-ja dhe UNICEF-i. Një vlerësim pasues i thelluar i sqaroi mënyrat për ta forcuar sistemin shëndetësor dhe përmirësimet e shpejta në rezultatet e shëndetit të nënave dhe të porsalindurve. Foto©OBSSH*



Strategjinë për Integrimin e Refugjatëve dhe të Huajve (2018-2028) me kontributet e vendit në Planin Rajonal të përgjigjes për Refugjatët dhe Migracionin. OKB-ja

**50%** RËNIE TË VDEKSHMËRISË SE FOSHNJAVE

**NO** ASNJË FËMIJË NË INSTITUCIONE TË PËRMASAVE TË MËDHA

me mbështetje të OKB-së

ofroi dëshmi, mbështetje shumë-sektorëshe, mbështetje teknike dhe inovacione për reformën në arsim, duke përfshirë modelimin e arsimit gjithëpërfshirës në 30 shkolla fillore dhe 25 kopshte, si dhe mbështetje për deinstitutionalizimin dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shërbimet sociale dhe punësim. Janë siguruar modele të reja për ofrimin e kujdesit shëndetësor primar (KSHP) përmes digjitalizimit, investimeve dhe ndërtimit të kapaciteteve në shëndetësi; menaxhimi i çështjeve është prezantuar në Qendrat për Punë Sociale për të siguruar qasje gjithëpërfshirëse; njashu zyrtarët e kufirit dhe migracionit ishin të aftësuar në menaxhimin e kufirit humanitar dhe personelin e menaxhimit të krizës në menaxhimin e kampeve.

Pas vazhdimin të punës dhe mbështetjes së OKB-së, qeveria e rregulloi ligjërisht mbylljen e shkollave fillore speciale dhe i shfuqizoi grupet e veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara në edukimin parashkollor në vitin 2019. Deri në fund të vitit 2019, nuk kishte më fëmijë pa kujdestarë në institucione të shkallës së gjerë, gjë që paraqet një përmirësim krahasuar me vitin 2016 (133.6/100,000 fëmijë), me 30% rritje të fëmijëve në kujdestari. Numri i fëmijëve që përfitojnë nga transferimet për zvogëlim të varfërisë është rritur pesëfish që nga viti 2016, me një mbështetje të rritur nga 89 në 188 dollarë në vitin 2020. Në vitin 2020, vendi gjithashtu e ratifikoi Konventën për Reduktimin e Pashtetësisë.

## Mbrojtja e mjedisit jetësor

Mbrojtja e mjedisit kërkon përpjekje të shtuara nga shteti dhe partnerët e zhvillimit, përfshirë burimet njerëzore të fuqizuara dhe qasje të përmirësuar në financim. Ndotja e ajrit është një kërcënim serioz i shëndetit të mjedisit jetësor në zonat urbane, të renditur në mesin e dhjetë qyteteve më të ndotura në Evropë në vitet 2017-2018. Për fat të mirë, ndryshimi i klimës tani është një sferë e fokusit në rritje dhe ndër përparësitë më të larta në vend.

*Njëzet e shtatë vjeçarja Sandra nga Kongo po e ndjek kursin e gjuhës maqedonase, me qëllim që ta ndihmojë atë, ta rindërtojë jetën e saj në Maqedoninë e Veriut, ku jeton me fëmijët e saj pasi që ka marrë një përgjigje pozitive në kërkesën e saj për azil. Orët për mësimin e gjuhës, të ofruara për t'i ndihmuar azilkërkuesit, janë vetëm një nga instrumentet e shumta të prezantuara nga UNHCR-ja dhe organizatat partnere për ta lehtësuar integrimin e tyre në shoqëri. Foto©UNHCR*





*Raporti i Komisionit Evropian 2020 për Maqedoninë e Veriut e ka konstatuar statusin e përparuar të konsolidimit të tokës në vend. Kjo arritje është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të FAO-s, BE-së dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Foto©FAO*

Mbështetja e OKB ishte shumë e vlefshme në të gjitha sferat, duke filluar nga sigurimi i provave përmes katër publikimeve të "Rishikimit të Performancës së Mjedisit Jetësor" dhe promovimit të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore me zhvillimin e kapaciteteve dhe demonstrimeve në 25 zona të mbrojtura dhe mbështetja për shpalljen e parqeve të reja nacionale dhe zonave të mbrojtura, si dhe zhvillimin e një Inventari nacional të pyjeve dhe një kadastër të gjelbër të Qytetit të Shkupit. Me mbështetjen e OKB-së, Qeveria e ka avancuar një proces të gjatë dhe kompleks të konsolidimit të tokës për ta kapërcyer copëzimin e tepërt të tokës bujqësore, e ka prezantuar klimën e teknologjisë së mençur bujqësore, e ka themeluar Sistemin nacional të zonave agro-ekologjike dhe burimeve të tokës për menaxhimin e informacioneve, me qëllim të përmirësimit të prodhimit bujqësor dhe adaptues të kapacitetit të prodhuesve bujqësorë, gjegjësisht përfshirjes së aspekteve të ndryshimit të klimës në planifikimin sektorial. Në këtë drejtim është mbështetur Vlerësimi i shtrirjes së truallit për përdorimin e tokës dhe ndryshimet në sektorin e pylltarisë dhe një Metodologjia për hartimin e një Sistemi të ardhshëm nacional të monitorimit të pyjeve, për të mundësuar vendimmarrje të bazuar në prova dhe formulim të zbatueshëm të politikave për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve.

Në fushën e menaxhimit të integruar të pellgut të lumenjve, OKB-ja e ka mbështetur Planin e menaxhimit të pellgut të ujërave për Liqenin e Prespës, i përsëritur më vonë në Pellgun e Lumit Strumica, dhe ia ka transferuar komunës funksionet mbrojtjes dhe menaxhimit. Gjithashtu u iniciua bashkëpunimi ndërkomunal dhe menaxhimi i integruar i burimeve ujore në basenin e zgjeruar të lumit Drin. Menaxhimi i mbeturinave u forcua me katër impiante të trajtimit të ujërave të ndotura dhe deponinë e parë në Gjevgjeli sipas standardeve të BE-së. Huluntimi i praktikave të ngrohjes dhe ndotjes së ajrit ofroi dëshmi të vlefshme për zhvillimin e një qasjeje të bazuar në zona të lagjeve me emetime afër zeros të demonstruara në një nga zonat më të ndotura të Shkupit.

Gjithashtu OKB siguroi mbështetje politike për Raportet nacionale të komunikimit/azhurnimit bienal mbi ndryshimin e klimës dhe për planin e parë të veprimit të klimës, që i integron konsideratat gjinore në raportimin e Kornizës së Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK). Në fushën e zvogëlimit të rrezikut nga katastrofat (ZRK), OKB-ja i ka ndihmuar institucionet nacionale për ta përmirësuar mënyrë aktive të menaxhimit të rrezikut nga vërshimet pas përmblytjeve të mëdha në vitet 2015-2016, përmes sistemeve të integruara

për menaxhim të rreziqeve, dobësive dhe ekspozimin e komuniteteve dhe aseteve.

Përmes këtyre intervenimeve, zonat e mbrojtura nën menaxhim të përmirësuar u rritën në rreth 190,000 hektarë. Në Prespë, mbi 80% e fermerëve vendas i miratuan praktikat agro-ekologjike në 360,000 hektarë (krahasuar me zero), përdorimi i ujit për ujitje ka rënë për rreth 60%, ndërsa përdorimi i pesticideve është ulur për 30%. Kanë filluar aktivitetet për pastrimin e mbeturinave të rrezikshme në njërin prej pikave kryesore në vend-fabrika OHIS, e cila është një kërcënim i madh ndaj mjedisit jetësor në kryeqytet. Në rajonet e Pollogut dhe Strumicës, rritja prej 50% rritje e kapacitetit të shkarkimit të kanaleve të rehabilituara, ka parandaluar një humbje mesatare vjetore të ekonomisë nga 50,000 deri në 100,000 dollarë amerikan nga ngjarjet e ardhshme të përmblytjes me probabilitet të lartë. Në rajonin e Pellagonisë dëmi i parandaluar tejkaloi 2 milion dollarë për më shumë se 230,000 njerëz. Gjithsej rreth 5,500 hektarë tokë bujqësore, 35 hektarë zonë të urbanizuara dhe zonë industriale dhe 10 hektarë infrastrukturë transporti janë mbuluar në programimin e zvogëlimit të rrezikut nga katastrofat. Planet e reja janë zhvilluar në sektorët e bujqësisë dhe shëndetësisë, që e përfshijnë shëndetin seksual dhe riprodhues në raste urgjente, me qëllim që të mbështetet një ushtrim simulues në shkallë të plotë.

## Barazia gjinore

Miratimi i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) ishte një arritje kryesore në nivelin nacional, e ndjekur nga krijimi i strukturave kryesore institucionale, përfshirë tre Qendrat e referimi ndaj sulmit seksual në spitalet e Tetovës, Shkupit dhe Kumanovës.

OKB-ja ka bërë përpjekje të konsiderueshme në promovimin e barazisë gjinore dhe rritjen e kapaciteteve nacionale në një varg fushash të lidhura. Kjo përfshinte ndihmën në hartimin e ligjit antidiskriminim dhe krijimin e Trupit nacional të koordinimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; mbështetjen e Planit nacional të veprimit për barazinë gjinore (2018-2020) dhe Strategjisë nacionale dhe Planit të veprimit për ta luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe migracionin e paligjshëm (2017-2020).

Mbi 6,000 kapacitete të nëpunësve civilë në integrimin gjinor dhe buxhetimin e bazuar në gjini janë përmirësuar përmes kurseve të strukturuar brenda Sistemit të menaxhimit të mësimi shtetëror dhe ndërhyrjeve të tjera. Për herë të parë, dispozitat specifike gjinore janë modernizuar në Metodologjinë e planifikimit strategjik të qeverisë, përdërisa rezultate të dukshme janë vënë re në fushën e punësimit të grave.

# Rezultatet e vitit 2020\*

\* Për rezultate të detajuara të vitit 2020 për çdo prodhim, shihni Raportin Plotësues

Kjo pjesë e thekson kontributin e OKB-së të Maqedonisë së Veriut dhe rezultatet nga puna me Qeverinë, shoqërinë civile dhe partnerët e zhvillimit në 5 zona të PZhQ-së në vitin 2020, dhe përgjigjen e përbashkët ndaj pandemisë KOVID-19 dhe zbutjen e ndikimit të saj socio-ekonomik.

## REZULTATI 1:

# Më shumë vende pune dhe më cilësore

Deri në vitin 2020 më shumë gra dhe burra do të jenë në gjendje ta përmirësojnë jetesën e tyre, duke siguruar punësim të qëndrueshëm në ekonomi me rritje konkurruese dhe të pasur me vende pune.

### Kontributi në:



Zhvillimin e ekonomisë, rritjen e punësimit produktiv dhe ngritjen e nivelit të jetesës së qytetarëve;  
Reformat në sistemin arsimor dhe investimet në inovacion dhe teknologjitë e informacionit;



Pikësëpari elementet bazë: Zhvillimi ekonomik dhe konkurrenca  
19. Politika sociale dhe punësimi;  
20. Sipërmarrja dhe politika industriale;  
26. Arsimi dhe kultura

Agjencitë e OKB-së që kontribuojnë në përmbushjen e këtyre rezultateve:  
ILO, IOM, UNDP, UNECE

Qeveria dhe partnerët tjerë zhvillimorë:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Agjencia e Shërbimit të Punësimit, shoqëria civile, sektori privat, bota akademike dhe të tjerët

Në fillim të vitit 2020, OKB-ja vazhdoi me ndërhyrjet e saja kolektive për ta përmirësuar jetesën e njerëzve duke ndihmuar dhe ngritur kapacitetet e institucioneve përkatëse për të hartuar dhe zbatuar strategji punësimi, plane dhe masa aktive të punës, duke rregulluar kurrikulën arsimore me nevojat e tregut dhe duke siguruar zhvillimin e aftësive të personave më vulnerabil, si dhe rritjen e ambientit të biznesit, dialogut social dhe konkurrencës së sektorit privat. Disa nga arritjet më të rëndësishme në këtë fushë përfshijnë fushata për të drejtat e punëtorëve dhe formulimin mbështetës të Strategjisë Nacionale të Punësimit, të bazuar në prova me planet e ndërlidhura të veprimit, zgjerimin e kapacitetit dhe shërbimeve të Agjencisë për Punësim (AP) dhe sigurimin e 314 punësimeve afatgjata përmes pakove të ndryshme të masave aktive të tregut të punës dhe vendeve të punës për 67% të kthyerve të synuar. Janë ofruar politika dhe mbështetje praktike për NVM-të, përfshirë vlerësimin e aftësive në disa industri, angazhimin e 186 kompanive në zhvillimin e një programi për trajnim dhe sigurimi i aftësive përkatëse të tregut për 584 të papunë dhe certifikata të njohura për 29 të burgosur.

Mirëpo kriza KOVID-19 imponoi rregullim urgjent të planeve dhe programeve në vazhdim për t'i mbështetur në mënyrë efektive përfituesit. OKB-ja menjëherë bëri analiza të shpejta të ndikimit në tregun e punës dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), duke ofruar rekomandime të mirëfillta dhe të bazuara në fakte, përfshirë masat e politikave plotësisht të zhvilluara për reagim të menjëhershëm. Analiza është shtrirë më vonë në një vlerësim më gjithëpërfshirës socio-ekonomik, përfshirë vendet e punës në nivelin lokal dhe nacional, si dhe në disa prej industrive specifike që kontribuojnë më shumë në punësim dhe rritje. OKB-ja e mbështeti Këshillin Ekonomik dhe Social (KES) për t'u angazhuar në mënyrë aktive me Qeverinë në hartimin e pakove të kundërpërgjigjes ndaj krizës, duke ndikuar në reagimin e Qeverisë dhe duke e zgatur kohën dhe shtrirjen e masave stimuluese për 3,803 persona shtesë.

Gjatë gjithë vitit, OKB-ja gjithashtu ka siguruar mbështetje të drejtpërdrejtë për grupet më të prekura të të papunëve, duke lehtësuar angazhimin e organizuar të 613 të papunëve në ofrimin

e shërbimeve sociale, zhvillimin e një qendre për NVM-të, duke lehtësuar mundësitë e biznesit që rezultuan me 126 kompani të reja të krijuara nga njerëz të cilët i kishin humbur vendet e punës për shkak të krizës, pastaj lidhjen e kontratave bujqësore me 35 fermerë lokalë për t'i tejkualuar sfidat e prodhimit, shpërndarjes dhe vendosjes në treg. Si rezultat i kësaj, masat stimuluese të Qeverisë siguruan që ndikimi i përgjithshëm në papunësi në vitin 2020 të ngel i kufizuar, përkundër 13.8% të orëve të punës të humbura në vit, madje ky trend pësoi rënie pas një goditjeje më të rëndë në tremujorin e dytë. Njëkohësisht, pasiviteti është rritur për pothuajse 4% në fund të vitit 2020, që është një arsye për shqetësim.

*Përfundimisht Estira Ajvazovska arriti të punësohet si bukëpjekëse, që për të ishte karrierë e ëndrrave, pasi ishte ndër të parat, që u përfshi në masat e punësimit të mbështetura nga programi Acceder për punësim të romëve, të implementuar nga UNDP. Foto©UNDP*



## REZULTATI 2

## Qeverisje më përgjegjëse

*Deri në vitin 2020, institucionet nacionale dhe lokale do të jenë më të afta, që në një mënyrë transparente të hartojnë dhe ofrojnë shërbime me cilësi të lartë për të gjithë përdoruesit, edhe atë me kosto efektive, jodiskriminuese dhe të ndjeshme ndaj gjinisë.*

## Kontributi në:



Qeverisja demokratike dhe e përgjegjshme  
Reformat në administratën publike, policinë dhe sektorin e drejtësisë  
Lufta kundër korrupsionit



Pikësëpari elementet bazë: Kriteret politike dhe Sundimi i ligjit  
23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore  
24: Drejtësia, liria dhe siguria  
19: Politika sociale dhe punësimi

Agjencitë e OKB-së që kontribuojnë në përbushjen e këtyre rezultateve:  
IOM, OHCHR, UNDP, UNECE, UNESCO, UNFPA, UNODC, UNOPS, UN Women

Qeveria dhe partnerët tjerë zhvillimorë:

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Sekretariati për Çështjet Evropiane, Enti Shtetëror i Statistikës, shoqëria civile, sektori privat, bota akademike dhe të tjerët.

OKB e ka mbështetur një qeverisje më të përgjegjshme, të përqendruar në njerëz dhe gjithëpërfshirëse, decentralizim efektiv dhe shërbime cilësore publike të përshtatura për nevojat dhe pritjet e qytetarëve. Vendimmarrja transparente dhe pjesëmarrëse dhe planifikimi i buxhetit çuan në një zhvillim më të ekuilibruar socio-ekonomik dhe përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë së jetës për grupet më të rrezikuara. "Forumet e qytetarëve", të promovuara nga OKB-ja, mundësuan pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në 70 nga gjithsej 81 komuna. Zërat e shoqërisë civile, të rinjve, grave dhe burrave dhe njerëzve të lënë pas ndikuan në politikat në fokus kryesor dhe në shpenzimet publike në nivelin qendror, rajonal dhe atë lokal. Njerëzit dhe komunitetet e prekura nga flukset e migracionit janë ndihmuar për t'u përballë me sfidat e imponuara nga dobësitë e tyre komplekse përmes kapaciteteve të forcuara të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve sociale, procedurave të lidhura me migracionin në përputhje me BE-në dhe rinovimet e spitaleve dhe objekteve tjera. Mbështetja e OKB-së në përafrimin e legjislacionit të drejtësisë penale me standardet ndërkombëtare dhe forcimin e kapaciteteve të zbatimit të ligjit mundësoi një përgjigje dhe bashkëpunim më efektiv me vendet e Ballkanit Perëndimor në adresimin e trafikimit të paligjshëm në porte dhe aeroporte, korrupsionin, flukset e paligjshme financiare dhe format tjera të krimit të organizuar.

Zgjidhjet digjitale të prezantuara në nivelin lokal me mbështetjen e OKB-së, duke përfshirë pagesën elektronike të taksave, platformën e-mësimin të arritshme për të gjithë 1,347 këshilltarët komunalë në vend dhe mjetet tjera, ishin me rëndësi kritike për të siguruar vazhdimin e proceseve të biznesit komunal gjatë pandemisë, duke çuar në një rritje të kënaqësisë

**Konsultimet e të rinjve në Rishikimin Vullnetar Nacional - RVN janë organizuar nga Rrjeti Rinor Y-PEER, në bashkëpunim me Qeverinë e Maqedonisë së Veriut dhe mbështetjen e UNFPA-së.** Foto©UNFPA



**60** pjesë të harmonizuara të legjislacionit të BE-së

**600** nëpunës civil të trajnuar

së qytetarëve lidhur me disponueshmërinë e informacioneve 38.4% dhe komunikimin me komunën dhe organet lokale të krijuara enkas për t'u përballë me krizën 43.1%.

Në kontekstin sfidues, OKB ka vazhduar ta mbështesë Qeverinë për ruajtjen vullit të reformave dhe për progres në agjendën e aderimit në BE përmes harmonizimit të intensifikuar të legjislacionit nacional me legjislacionin e BE-së dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, rritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë dhe një portal, të qasshëm për publikun të PNML-së.

Janë avancuar më tej kapacitetet e institucioneve qeveritare, ombudsmanit dhe shoqërisë civile për t'i transformuar në praktikë angazhimet e të drejtave të njeriut në shtet. Përgatitjet për regjistrimin e popullsisë në vitin 2021, duke u përqendruar në komunikim, kanë qenë ndër përparësitë që synuan ta kapërcejnë hendekun e të dhënave të sakta dhe të ndara thelbësore për planifikimin dhe monitorimin e progresit nacional drejt QZHQ-ve.

Raporti i parë vullnetar nacional (RVN) në vend është përgatitur me mbështetje kyçe të OKB-së, përmes inpueteve dhe sigurimit të cilësisë në fushat përkatëse të ekspertizës, Vlerësimin të Shpejtë të Integruar, të mbështetur nga OKB-ja, i cili i hartëzoi dhe analizoi pikat që përputhen të Kapitujve të BE-së, konventave ndërkombëtare dhe QZHQ-ve, si dhe këshillimit të lehtësuara nga OKB-ja për t'iu ndihmuar të rinjve përmes rrjetit të bashkëmoshatarëve të rinj (Y-Peer). Për më tepër, Strategjia Nacionale për Zhvillimin e Balancuar Rajonal 2020-2029, e zhvilluar me mbështetjen e OKB-së, pritet ta lehtësojë lokalizimin e QZHQ-ve, pasi i identifikon boshllëqet e mëdha të të dhënave për sa i përket mbulimit gjeografik, kohëzgjatjes dhe nivelit të ndarjes, që pengon një lokalizim të tillë, si dhe një dokument politikash që ofron një kornizë dhe një mjet fleksibël për krijimin e politikave të bazuara në fakte dhe politika të integruara në kontekstin e procesit të integritimit në BE të harmonizuara me QZHQ-të.

## REZULTATI 3

## Jetë më të mirë për personat vulnerabil

*Deri në vitin 2020 më shumë anëtarë grupeve të përjashtuara sociale dhe vulnerable janë fuqizuar për t'i ushtruar të drejtat e tyre dhe për të pasur cilësi më të mirë të jetës dhe qasjes së barabartë në shërbimet themelore.*

## Kontributi në:



Një shoqëri për të gjithë  
Reformat në sistemin arsimor dhe investimet në inovacion  
dhe teknologji informatike  
Shërbime sociale cilësore për të gjithë



18 (statistika)  
19 (politika sociale dhe punësimi)  
25 (shkenca dhe hulumtimi)  
26 (arsimi dhe kultura)

Agjencitë e OKB-së që kontribuojnë në përmbushjen e këtyre rezultateve:  
IOM, OHCHR, UNDP, UNFPA, UNHCR, UNICEF, UNODC, UNOPS, UN Women, OBSH

Qeveria dhe partnerët tjerë zhvillimorë:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, shoqëria civile, sektori privat, bota akademike dhe tjerët.

Agjencitë e OKB-së kanë punuar me Qeverinë dhe partnerët tjerë të zhvillimit për të krijuar ndryshime pozitive shoqërore për grupet më të ndjeshme në shoqëri në të gjithë sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve; dhe për ta zbutur ndikimin e pandemisë COVID-19 te grupet më të ndikuara.

OKB-ja ofroi mbështetje teknike, operacionale dhe të politikave për Qeverinë, e cila e menaxhoi me sukses pandeminë COVID-19 përmes masave të kufizimit dhe zbutjes që synojnë kufizimin e përhapjes së virusit, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe punonjësve shëndetësorë në vijën e parë, duke e ruajtur kapacitetin e sistemit të kujdesit shëndetësor dhe qëndrueshmërinë për t'u përgjigjur dhe ofruar shërbime thelbësore për popullatën dhe duke e mbështetur komunikimin e rrezikut dhe angazhimin e komunitetit kundër COVID-19.

Këto ndërhyrje u zbatuan dorë për dorë me ndërhyrjet për forcimin e mbulimit shëndetësor universal: qasjen e përmirësuar në shërbimet thelbësore shëndetësore cilësore; forcimin i sistemit e-shëndetësor; dhe mbështetjen për zbatimin e reformës së sistemit shëndetësor me theks të kujdesit shëndetësor primar dhe shëndetit të nënës dhe fëmijës, duke shndërruar nfermierinë në një fuqi të vlerësuar shëndetësore në modelin e ri të kujdesit të shëndetit primar (KShP), si dhe duke e përmirësuar disponueshmërinë e ilaçeve dhe duke përgatitur sistemin shëndetësor për imunizim në shkallë të gjerë.

OKB-ja vazhdoi të sigurojë mbështetje për Qeverinë në sigurimin e arsimit të vazhdueshëm për të gjithë nxënësit në vend pas mbylljes së shkollave në mbarë vendin. Duke e rivendosur platformën e Zhvillimit në fëmijëri të hershme (ZhFH) në zhvillim e sipër, për të mbledhur burime dhe për shpërndarë video mësim, OKB e mbështeti një platformë nacionale të mësimin në distancë (Eduino), e cila e riktheu në mënyrë efektive arsimin e vazhdueshëm cilësor për të gjithë 300,000 ndjekësit. Paralelisht, reformat në sektorin e arsimit janë përsheptuar në fund të vitit 2020, me çka OKB-ja ka ofruar mbështetje për të dy aktivitetet e arsimit fillor dhe të mesëm dhe për mësimin për të rritur dhe mësimin gjatë gjithë jetës.

Shërbimet themelore - duke filluar nga mbështetja e thjeshtë gjatë pandemisë deri te siguri i shërbimeve (mobile) shëndetësore të integruara në shtëpi dhe ato të mbrojtjes sociale - u janë ofruar kategorive më vulnerable të popullsisë në mbi 80% të komunave, duke depërtuar te familjet në rrezik dhe fëmijë, romët, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar.

Tre shërbimet shoqërore të sapo dizajnuara në kuadër të programit të fuqizimit të grave do ta përmirësojnë cilësinë e kujdesit dhe do ta forcojnë rolin e grave në familjet, në të cilat ofrohet kujdes për ata që janë në nevojë. Dy Qendrat e para për rehabilitimin e orientuar drejt punës u hapën në Strumicë dhe Shkup për ta lehtësuar punësimin e personave me aftësi të kufizuara, duke rezultuar në 20 ndërmarrje të vogla, tashmë të hapura nga personat me aftësi të kufizuara në 2020.

Digjitalizimi i shërbimeve të palëve kryesore qeveritare, që kanë të bëjnë me azilin, duke ofruar pajisje trajnimi dhe teknologji të largëta, mundësoi që procedura e azilit të vazhdojë pa ndërprerje, duke rezultuar në 22.7% rritje të vendimeve të shkallës së parë të marra në vitin 2020 krahasuar me 4.2% në vitin 2019. Vetëm dy personave iu dha mbrojtje subsidiare (plotësuese) në vitin 2020, pa status refugjati të dhënë që nga viti 2016.

*Duke u nisur nga synimi për të siguruar burime arsimore digjitale dhe për t'iu mundësuar fëmijëve të mësojnë gjatë pandemisë, përveç Eduino, UNICEF-it dhe partnerëve, gjithashtu u nis iniciativa e TV klasës (e ilustruar në foton më poshtë). TV klasa është një bashkëpunim midis Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, UNICEF-it, producentëve të emisioneve televizive për fëmijë OXO dhe transmetuesit nacional Radio dhe Televizioni të Maqedonisë së Veriut. Foto©UNICEF/Nikolovski*



REZULTATI 4

# Mjedisi jetësor dhe reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë

*Deri në vitin 2020 individët e sektorit privat dhe institucionet e shtetit do t'i bazojnë veprimet e tyre në parimet e qëndrueshmërisë, ndërsa bashkësitë janë më rezistuese ndaj fatkeqësive dhe rreziqeve ndaj mjedisit jetësor.*

**Kontributi në:**



Investimet në Zhvillimin e Qëndrueshëm: Zhvillimin Bujqësor dhe Energjinë  
Mjedisi i shëndetshëm  
Mbrojtja nga katastrofat natyrore



11: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural  
15: Energjia  
27: Mjedisi

Agjencitë OKB-së që kontribuojnë në përbushjen e këtyre rezultateve në bashkëpunim me partnerët tjerë zhvillimor:

FAO, IOM, UNDP, UNECE, UNEP, UNFPA, UNIDO, OBSH

Qeveria dhe partnerët tjerë zhvillimorë:

Kabineti i Zëvendës Kryeministrit për Çështjet Ekonomike, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Shëndetësisë, autoritetet lokale, institucionet shtetërore, shoqëria civile, sektori privat, bota akademike.

**300%** rritje të përmasës së zonave të mbrojtura ndërmjet viteve 2016 dhe 2020

OKB-ja është fokusuar në mbështetjen strategjike për përbushjen e kërkesave të vendit për raportim, lidhur me

marrëveshjet shumëpalëshe të mjedisit jetësor (ndryshimit të klimës, biodiversitetit dhe degradimit të tokës), reduktimin e emetimeve të gazrave serë (GS), përmirësimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura, promovimin e bujqësisë së qëndrueshme, zvogëlimin e rrezikut të fatkeqësive dhe trajtimin e ndotjes së ajrit. Për shkak të pandemisë KOVID-19, janë rritur aktivitetet për reagimin e menjëhershëm të krizës.

Rezultatet kryesore në kuadër të rezultati të qëndrueshmërisë së mjedisit jetësor përfshinin mbështetjen strategjike për krijimin e një mjedisi të mundshëm për veprim klimatik dhe menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Vendi u angazhua për një synim ambicioz nacional për zvogëlimin e 82% të emetimeve neto të gazrave serrë deri në vitin 2030. Mbështetja është sigurua përmes ndërtimit të kapaciteteve të palëve të interesuara nacionale në ndërprerjen e Hidrofluorokarbonit (HCFC) dhe në hyrjen e drejtpërdrejtë në Fondin e Klimës së Gjelbër (FKGj). OKB-ja e ka mbështetur Qeverinë në hapjen e shtegut për shpalljen e një parku të ri nacional - Mali Sharr - përmes përfundimit të studimit të valorizimit si dhe ndryshimeve transformuese të vështira, për a i përket mënyrës se si vendi i administron burimet e tij natyrore. 3,000 hektarë tokë bujqësore janë në fazën e përparuar të konsolidimit të tokës, duke mundësuar menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonat rurale. Në sferën e ujërave të zeza, është ndërtuar një sistem i ri i kanalizimit për fshatin Suvodol (Makedonski Brod)

UNEP e mbështeti Qeverinë në hapjen e shtegut për shpalljen e një parku të ri nacional - Mali i Sharr. Foto©UNEP/Bozhinovski



dhe është përgatitur vendi për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura në Tetovë përmes largimit të mbeturinave. Rezultate të rëndësishme janë arritur në gatishmërinë e katastrofës, përmes prezantimit të masave të ndryshme për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofa, me fokus në menaxhimin e rrezikut nga përmblytjet dhe përgjigja ndaj krizës KOVID-19. Fokusi ishte në forcimin e Shërbimit Nacional Hidrometeorologjik përmes azhurnimit të pajisjeve të TI-së dhe softuerit të specializuar të bazës së të dhënave klimatologjike dhe zgjerimin e rrjetit të stacioneve hidrologjike dhe meteorologjike me 46 shërbime të reja ose të rinuara (32 në Pollog dhe 14 në Pellgun e Lumit Drini) si bazë për krijimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm. Këto aktivitete iu shtuan punës së mëparshme për menaxhimin e rrezikut nga përmblytjet në pellgun e lumit Strumica, madje numri i komunave me kapacitete të përmirësuara për menaxhimin e rrezikut nga përmblytja u rrit në 22, me 300,000 njerëz të tjerë që përfitojnë nga reduktimi i rreziqeve.

Mbështetja e fuqishme e sistemit shëndetësor në krijimin e një përgjigje të shpejtë dhe të organizuar ndaj krizës KOVID-19 u sigurua përmes trajnimit të më shumë se 3,500 punonjësve të kujdesit shëndetësor mbi kujdesin nga KOVID-19, prokurimit të pajisjeve të ndryshme mjekësore për ngritje të reparteve KOVID-19 dhe ngritja e Qendrës së re të Inteligjencës Epidemike dhe Operacioneve Emergjente, analiza e njohurive të sjelljes, prezantimi i hershëm i protokolleve për shtëpitë e kujdesit për të moshuarit, protokollat për kujdesin para lindjes gjatë pandemisë KOVID-19 dhe përmes aktiviteteve tjera.

UNDP e rindërtoi digën e vjetruar të Marvoricës për ta zvogëluar rrezikun e tejbushjes dhe përmblytjes në komunën e Sveti Nikollës. Ndërhyrje të ngjashme për zvogëlimin e rrezikut nga përmblytjet do të ndërmerren në rajonin e Pollogut. Foto©UNDP





## REZULTATI 5

## Barazia gjinore

*Deri në vitin 2020 institucionet nacionale dhe lokale do të mund më mirë të hartojnë dhe realizojnë shërbime të cilësisë së lartë për të gjithë përdoruesit, në mënyrë transparente, me kosto efektive dhe duke iu përmbajtur parimeve të ndjeshmërisë gjinore.*

## Kontributi në:



Barazia gjinore dhe mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat  
Parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave  
Bërja e politikave dhe buxhetimi i përgjegjshëm ndaj gjinisë i bazuar në të dhëna të ndara



23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore  
19: Politika Sociale dhe Punësimi  
19.7: Anti-diskriminim dhe mundësitë e barabarta

Agjencitë e OKB-së që kontribuojnë në përmbushjen e këtij rezultati:  
FAO, IOM, OHCHR, UNDP, UNFPA, UNICEF, UN Women

Qeveria dhe partnerët tjerë zhvillimorë:

Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, njësitë e vetëqeverisjes lokale, Avokati i Popullit, shoqëria civile, sektori privat, bota akademike dhe të tjerët.

Përkrahja dhe ekspertiza kolektive e OKB-së e mbështet përparimin e vendit në përmbushjen e angazhimeve të tij për barazinë gjinore. Legjislacioni i ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe mbi dhunën ndaj grave është harmonizuar me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, CEDAW dhe Konventën e Stambollit të Këshillit të Evropës.

OKB-ja ka ofruar një këshillë kritike në hartimin e një Ligji të ri për barazinë gjinore, së bashku me strategjinë përkatëse nacionale dhe planin e veprimit, si dhe inkriminimet e reja të veprimeve ndaj grave dhe kompensimin e financuar nga shteti për viktimat e të gjitha formave të krimeve të dhunshme, përfshirë DhGj-në dhe DhF-në. OKB-ja njashtu e ka mbështetur Qeverinë në zhvillimin e Planit të dytë nacional të veprimit (PNV) për Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, nga Agjenda e grave, paqes dhe sigurisë, me kornizën strategjike dhe planet operative për shtrirjen e saj.

Përfaqësimi dhe pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje është rritur në nivelin nacional dhe lokal, ndonëse një numër i kufizuar i zyrave publike dhe pozicioneve të niveleve të larta mbahen nga gratë. Qeveria qendrore dhe lokale gjithnjë e më shumë e përfshijnë perspektivën gjinore në politikat, programet dhe alokimet e buxhetit në shumë sektorë. Me mbështetjen e OKB-së, 14 ministri dhe 21 komuna kanë krijuar politikat dhe buxhetet e tyre, madje projektligji organik i buxhetit, për herë të parë i përfshin parimet e përgjegjshme gjinore.

Zërat e grave të marginalizuara dhe të përjashtuara, veçanërisht ato që përballen me diskriminim, abuzim dhe dhunë të kryqëzuar dhe të shumëfishtë, u bënë më të dukshme përmes avokimit dhe ndërgjegjësimit. Në formësimin e përgjigje me ndjeshmëri gjinore ndaj gjinisë ndaj pandemisë, politikëbërësit janë informuar nga Vlerësimi i shpejtë i gjinisë në kontekst të KOVID-19, Studimi i hartëzimit mbi ndikimin e KOVID-19 në situatën socio-ekonomike të grave në nivelin lokal dhe analizën e rialokimit të buxhetit gjinor.

Ofruesit e shërbimeve të OKB-së u aftësuan për zbatimin e një qasje shumë disiplinore dhe të përqendruar të viktimat në adresimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave. U përdorën protokollat e reja, dy strehimore shtesë, zgjidhjet digjitale dhe inovative, siç ishte aplikacioni celular "Be Safe" (Bëhu i/e sigurt) për rritjen e ndërgjegjësimit dhe raportimin e dhunës së bazuar në gjini dhe platformën në internet për nxënësit (studentët) për ta ndarë punën e tyre mbi dhunën ndaj grave dhe dhunës në familje, me qëllim të adresimit të më efektiv të dhunës ndaj grave nën hije të pandemisë.

Mbështetja e OKB-së e shtoi përkrahjen dhe krijoi aleanca më të forta midis grave, organizatave bazë dhe autoriteteve nacionale dhe lokale në integrimin gjinor dhe adresimin e pabarazive gjinore, stereotipave negative dhe dhunës ndaj grave. Kjo rezultoi në fushata të avokimit për fuqizimin e grave të drejtuara nga dy organizata të grave, 14 organizata lokale bazë dhe dy shoqata të autoriteteve lokale; 263 gra morën pjesë në formulimin e 144 rekomandimeve të politikave për programet komunale dhe buxhetet gjinore; 36 përfaqësues të OShC-ve u aftësuan për mbikëqyrje të politikave dhe buxhetet komunale nga një perspektivë gjinore; u arrit bashkëpunimi i 15 OShC-ve që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës mbi bazë gjinore; dhe 18 profesionistë të shkollave të mesme u trajnuan për parandalimin e dhunës ndaj grave. 1,897 njerëz përfituan drejtpërdrejt nga implementimi i projekteve të OShC-ve në 5 komuna me fokus në angazhimin e të rinjve dhe njerëzve nga grupet e ndjeshme, duke rezultuar në angazhimin e 989 personave dhe komuniteteve të përjashtuara nga shoqëria, përfshirë fëmijët romët, personat me aftësi të kufizuar dhe socializimin e të rinjve gjatë pandemisë.


14  
21

ministritë

komuna

me politika dhe  
buxhete të krijuara për shkak  
të mbështetjes së OKB

Aplikacioni celular "Be Safe" (Bëhu i/e sigurt) në partneritet mes Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe UNDP-së.



# Përgjigja ndaj KOVID-19



Kriza KOVID-19 i vuri në pah dobësitë ekzistuese sistimore në vend, i preku grupet më të rrezikuara dhe zvogëloi përfitimet e zhvillimit nga periudha e mëparshme. Në të njëjtën kohë, KOVID-19 paraqiti një mundësi për t'u rikthyer më mirë, me një fokus në reformat strukturore dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor. Përfaqësia e OKB-së në Maqedoninë e Veriut ishte në mesin e partnerëve kryesorë të Qeverisë në përgjigjen ndaj KOVID-19, që nga ditët e para të krizës, për të ndihmuar në formimin e rimëkëmbjes së gjelbër dhe gjithëpërfshirëse, ndërtimin e sistemeve dhe kapaciteteve të qëndrueshme për t'iu përgjigjur krizave të ardhshme.

## Mbështetja e përgjigjes së menjëhershme ndaj Kovid-19



Që nga janari i vitit 2020, OKB-ja ka dhënë këshilla të përditshme teknike dhe këshilla rreth politikave për Qeverinë mbi strategjitë e kontrollit dhe zbutjes, analizave, komunikimit të rreziqeve, hetimeve dhe reagimit, testimit dhe mbështetjes së kapaciteteve të menaxhimit të emergjencave shëndetësore. Pasi u përkeqësua gjendja shëndetësore në mars të vitit 2020, OKB-ja e rriti mbështetjen kolektive përmes ndihmës teknike, koordinimit dhe mobilizimit të burimeve për kundërpërgjigje. Kjo përfshinte ndihmën për konsolidimin e nevojave dhe kërkesave për pajisje mjekësore dhe pajisje për reagim të menjëhershëm; si dhe prokurimin e disa prej atyre artikujve.

Në vitin 2020, OKB-ja i ofroi vendit mbështetje për rimëkëmbje, si pjesë e përgjigjes kundër KOVID-19, me gati 12 milion dollarë në formën e furnizimeve, pajisjeve dhe shërbimeve mbështetëse që i synojnë më të prekshmit. Kjo mbështetje ishte prokuruar me burime të brendshme dhe ekzistuese të OKB-së ose në emër të donatorëve tjerë. Mes tjerash përfshinte një blerje të madhe të pajisjeve mjekësore që shpëtojnë jetë, siç janë ventilatorët, pajisjet personale mbrojtëse (PPM) dhe pajisjet tjera shëndetësore dhe sanitare, që iu dedikohen personave (mjekësor) të vijës parë dhe enteve shëndetësore. Kjo gjithashtu përfshinte ushqim dhe ndihmë në të holla për më të rrezikuarit dhe më të prekurit nga KOVID-19, mbështetje për komunikimin me rreziqet dhe aktivitetet parandaluese, ndihmë me rritjen

Donacioni i dhënë Ministrisë së Shëndetësisë si përgjigje ndaj KOVID-19. Foto©OBSH



e përmasës së aktiviteteve të arsimit në distancë dhe atij digjital, mbështetje dhe këshillim psiko-social për fëmijët dhe kujdestarin, të ndikuar nga KOVID-19 dhe të ngjashme.

## Shqyrtimi i ndikimit socio-ekonomik

Nga marsi e më tej, OKB në Maqedoninë e Veriut e kishte theksuar nevojën për ta parë dhe adresuar me shpejtësi ndikimin socio-ekonomik të krizës dhe për të siguruar një përgjigje koherente, të kornizuar mirë dhe të bazuar në prova. Ekipi i OKB-së në vend e ofroi ekspertizën e saj kolektive për ta mbështetur mendimin e autoriteteve mbi përgjigjen përmes analizave dhe sugjeri masa si kundërpërgjigje, duke e përdorë një qasje me faza (të menjëhershme, afatmesme dhe afatgjatë), si rezultat i së cilës u hartua Korniza e Reagimit ndaj KOVID-19 (KRK) në Maqedoninë e Veriut, e filluar në qershor të vitit 2020. KRK-ja e siguroi një analizë gjithëpërfshirëse të përgjithshme të ndikimit socio-ekonomik në pesë shtylla dalluese dhe sugjeri masa afatmesme dhe afatgjatë në përgjigje ndaj krizës; ajo u azhurnua më tej përmes nëntë masave të politikave të zhvilluara plotësisht dhe të kushtuara që e formësuan procesin buxhetor të Qeverinë për vitin 2020/2021.

Gjatë vitit 2020 OKB-ja vazhdoi të ndërmerr analiza të shpejta dhe të thelluara për të ndihmuar në ndërhyrjet e politikave të bazuara në prova të përqendruara në nevojat e grupeve më të ndjeshme, përfshirë Raportin e Vlerësimit Integral mbi ndikimin e KOVID-19 dhe Panelin e Vlerësimit të Nevojave ndaj KOVID-19.

## Të arriturat kryesore në raport me shtyllat e KRK-së

Në kuadër të iniciativës Shëndeti në rend të parë, OKB-ja mobilizoi dhe riprogramoi 8 milion dollarë për mbështetje dhe ekspertizë të dorës së parë, duke përfshirë kontrollin dhe zbutjen, prokurimin e pajisjeve dhe furnizimeve, trajnimin e personelit etj. Maqedonia e Veriut ishte ndër të parat në rajon për vlerësimin dhe monitorimin e barazisë shëndetësore dhe ndikimin socio-ekonomik të KOVID-19. Ekipi i OKB-së në vend gjithashtu ndihmoi me ndërhyrjet e fokusuar në analizën e sjelljes, hartimin dhe shpërndarjen e strategjive të komunikimit publik (të rrezikut), si dhe me mbështetjen teknike për projekte urgjente dhe me përparësi për rindërtimin e objekteve të kujdesit shëndetësor.

\$8 M

të mobilizuar dhe riprogramuar për mbështetje të drejtpërdrejtë

Në kuadër të shtyllës Mbrojtja e njerëzve, OKB-ja mobilizoi dhe ri-programoi më shumë se 1.3 milion dollarë për të ndihmuar në analizën e ndikimit në grupe të veçanta - fëmijë, gra, fermerë,

romë, migrantë, refugjatë, azilkërkuar, persona me aftësi të kufizuara dhe të tjerë - dhe për të siguruar drejtpërdrejt mbështetje për ta. Mbështetja në të gjithë sistemin - siç është mbështetja gjithëpërfshirëse për sistemin arsimor ose ndihma e autoriteteve për të futur qasje të ndjeshme gjinore në masat e përgjigjes - u plotësua me ndërhyrje dhe analiza që synonin grupe specifike - gratë shtatzëna, familjet me fëmijë në arsim, personat me aftësi të kufizuara - ose sektorë - gjegjësisht statusin e prodhimit dhe ushqimit të zinxhirëve të furnizimit me ushqim në vend.

Në kuadër të shtyllës për Rimëkëmbje ekonomike (2.1 milion dollarë), Këshilli socio-ekonomik u mbështet në analiza dhe argumente të bazuara në prova për të ndikuar në përgjigjen e Qeverisë; si dhe siguroi informacione dhe mbështetje të politikave për planifikimin buxhetor, tregun e punës, NVM-të dhe industritë specifike, siç është ndërtimtaria, tekstili, burimet e ripërtëritshme. Në raste të kufizuara, OKB-ja ofroi mbështetje të drejtpërdrejtë për përfituesit e ndihmës sociale dhe të papunët me masa aktive të punës dhe mundësi të vetëpunësimit dhe mbështetje të financimit të kontratave për fermerët, me qëllim që të zgjerohen shitjet gjatë krizës. Mbështetja nën përgjigjen makro-ekonomike dhe bashkëpunimin rajonal u zgjerua nga analiza dhe monitorimi i treguesve socio-ekonomik për këshillat e politikave dhe sigurimin e ndihmës financiare në një formë kredie nga FMN-ja dhe BB-ja.


Në kuadër të Kohezionit social dhe qëndrueshmërisë së komunitetit (0.5 milion dollarë) fokusi ishte përqendruar në analizat dhe rekomandimet në lidhje me ndikimin e krizës në komuna dhe ndërtimin e kapaciteteve komunale për reagim lokal në fushat e lidhura si menaxhimi i krizës dhe komunikimi i rrezikut, si dhe përdorimi i zgjidhjeve inovative për t'i zgjeruar shërbimet digjitale për qytetarët. OKB-ja e mbështeti përgjigjen lokale ndaj dhunës gjinore dhe siguroi mbështetje teknike për agjencitë e zbatimit të ligjit që merren me kërcënimet e krimin të organizuar, përfshirë kërcënimet kibernetike. Është ndërtuar kapaciteti i partnerëve socialë - sindikatave dhe shoqatave të punëdhënësve - për t'u angazhuar në konsultim me qeverinë; si dhe është ofruar mbështetje me organizimin e shërbimeve vullnetare për furnizimin dhe kujdesin për të moshuarit dhe grupet e tjera në nevojë.

## Shtegu drejt rimëkëmbjes më të mirë

Në dhjetor, dhe në partneritet me Finance Think, OKB-ja i ftoi ministrat kryesorë të angazhuar në përgjigjen socio-ekonomike ndaj COVID19, Bankën Botërore, BE-në dhe partnerët tjerë ndërkombëtarë, shoqërinë civile dhe akademinë për të diskutuar lidhur me mësimet e marra dhe mënyrat e rekomanduara për rimëkëmbjen efektive dhe për rifillimin e progresit në vend drejt QZhq-ve, duke rezultuar në përfundimet e mëposhtme:

1. Ndërtimi i kapitalit njerëzor është parakusht kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm në Maqedoninë e Veriut.
2. Shëndeti është një parakusht për zhvillim të qëndrueshëm dhe shumëzues të fortë ekonomik.
3. Rimëkëmbja e qëndrueshme bën thirrje për reagim të koordinuar të politikave drejt "tranzicionit të drejtë" që integron burime jeshile dhe inovative në rritjen post-pandemike, përderisa e ndërton qëndrueshmërinë e sistemit dhe siguron gjithëpërfshirjen, me fokus të veçantë te gratë.
4. Shërbimet themelore për sigurimin e mbrojtjes dhe mbështetjes psikosociale duhet të qëndrojnë të disponueshme, të përballeshme dhe të arritshme në çdo kohë.

## Përgjigja ndaj COVID-19 dhe rimëkëmbja e drejtuar nga OKB Të dhëna nga 31 Dhjetor 2020 në milionë dollarë amerikanë (US\$)



Burimi: OKB në Maqedoninë e Veriut, 2021

5. Për të ndërtuar sisteme ushqimore më të rezistueshme dhe më të qëndrueshme lokale, vendi duhet t'i diversifikojë furnizimet ushqimore dhe burimet ushqimore, ta përforcojë prodhimin vendor të ushqimit kur është e mundur, dhe të hyjë në tregjet për të siguruar shitjet e ushqimeve të prodhuara në vend.
6. Shteti duhet t'i rindërtojë mbrojtësit fiskalë, ndonëse konsolidimi fiskal nuk duhet ta kufizojë rritjen ekonomike. Maqedonia e Veriut duhet t'i japë përparësi reformave strukturore për ta rritur produktivitetin përmes proceseve produktive dhe inovative në sektorin e biznesit, i cili duhet të përshtatet me realitetet e reja ekonomike, përderisa Qeveria duhet ta lehtësojë këtë përmes rregullimit.
7. Fokusi vetëm në shkallën e papunësisë mund të shprijë në zgjedhje të gabuara të politikave, pasi shumë prej njerëzve që sapo kanë ngel pa punë, veçanërisht gratë, kalojnë drejtpërsëdrejti në pasivitet, i cili është shumë më i vështirë dhe i kushtueshëm për t'u rikthyer.
8. Vendi duhet të hapë dialog mbi cilësinë e vendeve thelbësore të punës, duke pasur parasysh që punëtorët thelbësorë - siç janë fermerët dhe personat e vijës së parë - kryesisht fitojnë një pagë të ulët.
9. Politikat publike duhet të zhvillohen në konsultime kuptimplota me palët kryesore.

UNFPA i mbështet ekipet mobile të Kryqit të Kuq, për t'i ndihmuar personat e moshuar gjatë pandemisë COVID-19. Foto©UNFPA



# Partneritetet dhe financimi i QZhQ-ve

Në vitin 2020, OKB në Maqedoninë e Veriut ndihmoi në përafrimin e përpjekjeve të partnerëve të shumtë rreth temave të QZhQ-ve dhe shfrytëzimin e avantazheve ose harmonizimin me të mirë të flukseve financiare vendore dhe ndërkombëtare. Këto partneritete, disa prej të cilave janë të paraqitura këtu, ishin krijuar rreth avokimit, mbështetjes së politikave, krijimit të përbashkët dhe rirreshtimit të burimeve dhe mobilizimit.

## Mbështetja e përgjithshme e QZHQ-së

Procesi i përgatitjes së Rishikimit Vullnetar Nacional (RVN), i cili u zhvillua gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, ndihmoi në mobilizimin e palëve rreth QZhQ-ve. Procesi i përgatitjes ishte shumë konsultativ, duke mbledhur përfaqësues të institucioneve qeveritare, shoqërisë civile, sektorit privat dhe akademisë për ta diskutuar progresin në raport me QZhQ-të dhe për t'i identifikuar sfidat dhe mundësitë ekzistuese. Procesi gjithashtu kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit dhe kuptimit të Agjendës 2030 midis palëve të interesuara. Po ashtu, në fund të vitit OKB-ja u angazhua me partnerë nacionalë për fillimin e punës në përgatitjen e Strategjisë Nacionale të Zhvillimit.

Në partneritet me disa ministri, OKB-ja ka ndihmuar me përlllogaritjen e kostos së masave të reagimit socio-ekonomik KOVID-19 dhe përmes kësaj e ka mbështetur procesin e buxhetimit të Qeverisë. Për më tepër, ka filluar dialogu midis OKB-së dhe Parlamentit për ta rritur rolin e tij në zbatimin e Agjendës 2030 dhe për t'i forcuar marrëdhëniet e tij me OKB-në.

## Shëndeti i mirë dhe mirëqenia



OKB-ja e ka lehtësuar mobilizimin e shpejtë dhe të koordinuar të burimeve për përgjigjen e menjëhershme ndaj KOVID-19 (shih 2.2.6) duke zhvilluar qasje proaktive dhe duke i përkrahur iniciativat së bashku me partnerë ndërkombëtarë të zhvillimit për rialokim më të shpejtë dhe më të lehtë të fondeve për përgjigje. Po ashtu OKB-ja e ka mbështetur udhëheqjen e qeverisë në koordinimin e donatorëve përmes sigurimit të informacioneve financiare transparente për nevojat dhe fondet e vëna në dispozicion nga partnerët ndërkombëtarë për përgjigje.

Përmes mbështetjes (avokimit), shkëmbimit të përvojave dhe gjenerimit të provave, OKB-ja e ka mundësuar angazhimin e BE-së dhe Bankës Botërore në temën e Shëndetit, duke i rirregulluar në këtë mënyrë financimet e konsiderueshme shtesë drejt QZhQ 3, veçanërisht për kujdesin shëndetësor primar, shëndetin para lindjes dhe shërbimet elektronike shëndetësore. Kjo ishte hera e parë që BE-ja ishte angazhuar në mbështetjen e çështjeve shëndetësore në vend, ndërsa angazhimi i Bankës Botërore u përtëri pasi për 12 vite nuk kishte ofruar mbështetje në këtë fushë tematike.

## Energji të disponueshme dhe të pastër si dhe ndryshimet klimatike



Qasja në financa për miratimin e efikasitet të energjisë (EE) dhe veçanërisht zgjidhjet e energjisë së rinovueshme (ER) e kanë zanafillën e vet në vend, me pak dhe vetëm nisma sporadike për rritjen e qasjes në financimin e ER-së dhe EE, të përqendruar në sektorin publik EE (Banka Botërore), financimi investimeve ER në përmasë të madhe dhe financimi për sektorin më të pasur të banimit (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim – BERZH/

EBRD). Partneriteti OKB-EBRD i krijuar në vitin 2020 u përqendrua në krijimin dhe financimin e përbashkët të një instrumenti të ri të financave të gjelbra, për ta mbështetur miratimin e përsheptuar të ER-së dhe EE-së në sektorin e biznesit dhe banimit. Një partneriteti i OKB-EBRD do të mund të rezultojë me 23.6 dollarë amerikan fonde të shfrytëzuara nga kontributi i OKB-së me 7.35 dollarë amerikan.

Vazhdoi mbështetja për t'i mundësuar Maqedonisë së Veriut qasje në fonde nga Fondi i Klimës së Gjelbër (FKGj), instrumenti kryesor financiar global për t'i mbështetur masat e zbutjes dhe adaptimit të ndryshimit të klimës përmes një projekti të dytë të gatishmërisë së FKGj-së dhe përgatitjes së një Programi të punës së FKGj-së në vend të projekteve/programave në fushat e energjisë, transportit, burimeve ujore, bujqësisë, pylltarisë, mbeturinave, biodiversitetit, shëndetësisë dhe trashëgimisë kulturore, që do të zbatohen si pjesë e përpjekjeve të vendit për trajtim të ndryshimeve klimatike. OKB-ja gjithashtu vazhdoi mbështetjen e Qeverisë për qasje në fonde përmes instrumentit të mjedisit global (IMG). Rreth 7.24 milion dollarë u arritën përmes zbatimit të OKB në vitin 2020 në mbështetje të vendit në përbushjen e objektivave të konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mbi mjedisin jetësor.

Rrjeti nacional i praktikuesve të ndryshimeve klimatike u krijua me 64 përfaqësues nga 27 institucione, përfshirë shoqërinë civile dhe botën akademike, si dhe një rrjet prej 320 personash që punojnë në fushat e barazisë gjinore ose ndryshimeve klimatike në nivel nacional dhe lokal. Personat në këto rrjete ishin të përfshirë në mënyrë aktive në zhvillimin e Kontributeve të Përbledhura të Përcaktuara Nacionale (KPN) të zgjeruara në Raportin e 3-të të Përditësimit Bial për Ndryshimin e Klimës dhe të informuara për rezultatet e projektit dhe rekomandimet.

## Zvogëlimi i pabarazive



Në partneritet me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, qendrat rajonale, komunat, OShC-të dhe sektorin privat, OKB-ja e mbështeti përgatitjen e Strategjisë Nacionale për Zhvillimin e Balancuar Rajonal 2020-2029, e cila përshkruan veprimin e kërkuar për t'i adresuar pabarazitë e vazhdueshme midis rajoneve të vendit dhe hap potencialin për angazhim më të madh të partnerëve të tjerë. Strategjia i identifikoi barrierat që e pengojnë lokalizimin e QZhQ-ve siç janë boshllëqet e mëdha të të dhënave për sa i përket mbulimit gjeografik, afatet kohore dhe niveli i ndarjes, duke siguruar një hartë për angazhimin e mëtejshëm analitik të nevojshëm për ta zhbllokuar lokalizimin dhe përbushjen e QZhQ-ve.

Partneriteti i kërkimit dhe të dhënave u krijua me Fakultetin Filozofik për kryerjen e kërkimit etnografik të perceptimeve të përparësive të njerëzve dhe studimit të sjelljes së të rinjve mbi proritetet e zhvillimit për ta mbështetur procesin e Analizës së Përbashkët të Vendit dhe për ta formësuar programimin e ardhshëm të OKB-së. Këto aktivitete i kanë hedhur bazat për partneritet të ardhshëm me institucionet akademike.

# Evaluimi dhe mësimet e mara

## Evaluimi i PZHQ-së

Në vitin 2020, përfundoi vlerësimi i pavarur për mbledhje të gjetjeve kryesore dhe mësimet të nxjerra nga zbatimi i PZHQ-së 2016-2020 dhe për mbështetje të llogaridhënies më të madhe të sistemit të OKB-së ndaj objektivave dhe përparësive nacionale të rena dakord. Vlerësimi u miratua bashkërisht nga Komitetin e Përbashkët Drejtues PZHQ të OKB-së-Qeverisë, ku perceptimi i OKB-së iu prezantua partnerëve ndërkombëtarë dhe qeveritarë dhe u vërtetua më tej përmes studimit onlajn (maj 2020), i cili kishte për synim partnerët e OKB-së.

Vlerësimi konstatoi që PZHQ-ja është në përputhje me përparësitë dhe politikat nacionale dhe rezultatet e saj që mbështesin drejtpërdrejt arritjen e objektivave afatgjatë nacionale dhe agjendën e integritimit në BE. PZHQ ishte e përgjegjshme ndaj nevojave aktuale të vendit, veçanërisht të segmenteve më të prekshme dhe të marginalizuara të popullsisë. Përkundër sfidave, përfituesit dhe partnerët ishin të kënaqur, ndërsa rezultatet e parashtruara u përbushën në masë të madhe.


Rekomandimet kryesore ndërlihdeshin me:

- \* Fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive
- \* Menaxhimin e të dhënave dhe hartimin dhe monitorimin e programit
- \* Qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve të ndërmarra
- \* Qëndrueshmërinë e financimit; dhe
- \* Fuqizimin e rolit të ekipit të OKB-së në vend në koordinimin me partnerët e zhvillimit.

Ekipi i OKB-së në shtet i pranoi plotësisht pesë grupet e vlerësimit të rekomandimeve dhe u angazhua për zbatimin e tyre përmes Planit të Reagimit të Menaxhimit për Vlerësimin, andaj shumë rekomandime u vunë në praktikë të menjëhershme tashmë gjatë vitit 2020. Për shembull, gjatë hartimit të KBZHQ 2021-2025, ekipi i OKB-së në vend përfshinte tregues specifik, të matshëm, të arritshëm, të rëndësishëm dhe me kohë (SMART) më pak të zgjedhur por me kujdes, bazuar në kornizën QZHQ dhe në përputhje me Kornizën për vlerësimin e punës së Qeverisë në lidhje me IPA-n; gjegjësisht rezultatet e KBZHQ-së

### Përgjigjet menaxhuese të ekipit të OKB-së në vend për evaluimin e PZHQ-së

Statusi i implementimit nga 31 dhjetori i vitit 2020



### Mësimet kyçe nga evaluimi i PZHQ-së

**Mësimi 1:** Bashkëpunimi i ngushtë midis agjencive të OKB-së zakonisht shfaqet në ato zona ku ka një agjendë të qartë reformash, të mbështetura nga një problem i identifikuar qartë dhe një angazhim i fortë i qeverisë për ndryshim. Prandaj pronësia nacionale është një faktor i rëndësishëm, që krijon ndërveprimin e agjencive të OKB-së në nivelin e vendit.

**Mësimi 2:** Sistemi i OKB-së mund të bëhet i shpejtë dhe i rëndësishëm dhe të jep një kontribut të madh në fushat ku më parë ka pasur angazhim minimal. Për shembull, i tillë ishte rasti gjatë krizës së migrimit [2016], Nëse ekziston një nevojë e qartë në një fushë të ekspertizës, kapacitetit dhe përvojës së OKB-së, është e mundur që agjencitë e OKB-së të bashkohen, ta koordinojnë në mënyrë efektive dhe efikase bashkëpunimin e ngushtë me njëra tjetrën.

të hartuara, duke u bazuar në një teori të shëndoshë dhe solide të ndryshimit. Për më tepër, ekipi i OKB-së në shtet e rregulloi strukturën mbështetëse të KBZHQ-së përmes krijimit të Ekipit për menaxhim të programit (EMP) dhe Grupet e rezultateve të KBZHQ-së për të siguruar bashkëpunim horizontal dhe tematik. Deri në fund të vitit 2020, shkalla e zbatimit të vlerësimit ishte në 45%, e cila ishte kryesisht në rrugën e duhur për ta përmbyllur ashtu vitin 2021.

### Mësime nga viti 2020

COVID-19 dhe sfida tjera operative në vitin 2020 e testuan aftësinë e OKB-së në Maqedoninë e Veriut, duke rezultuar në mësimet strategjike dhe operative, të marra në të gjitha fushat e punës, disa prej të cilave janë përmbledhur më poshtë.

\* Partneritetet e fuqishme janë thelbësore për adresimin sistematik të sfidave komplekse të zhvillimit.

\* Krizat i forcojnë pabarazitë dhe disparitetet; si pasojë e kësaj personat e lënë pas kanë nevojë për më shumë mbështetje dhe shërbime sociale.

\* Kjo është një nevojë për të përsheptuar përdorimin e mjeteve të reja dhe për të përfituar plotësisht nga digjitalizimi.

\* Analiza e trendeve të ardhshme dhe drejtuesve e nxori në pah nevojën për ta sistemuar planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen e ardhshme brenda operacionit, për ta zgjeruar angazhimin me njerëzit e interesuar dhe shoqërinë civile si aktorë të ndryshimit dhe për t'u angazhuar në mënyrë aktive në transformimin e narracionit publik në lidhje me refugjatët, duke ndërtuar qëndrime dhe sjellje të reja në komunitete dhe duke zgjeruar platformën e palëve të interesuara për luftë kundër dezinformimit.

# Koherenca, efektshmëria dhe efikasiteti i OKB-së

**OKB në Maqedoninë e Veriut arriti rezultate të rëndësishme në zbatimin e reformës së sistemit të zhvillimit të OKB-së në terren si dhe ishte i shpejtë dhe iu përgjigj ndryshimeve dhe sfidave të rënda kontekstuale dhe sfidave tjera në vitin 2020.**

OKB në Maqedoninë e Veriut arriti rezultate të rëndësishme në zbatimin e reformës së sistemit të zhvillimit të OKB-së në terren si dhe ishte e shpejtë dhe iu përgjigj ndryshimeve dhe sfidave të rënda kontekstuale dhe sfidave tjera në vitin 2020.

Në kohën e nënshkrimit të PZhQ-së në Maqedoninë e Veriut në vitin 2016, Realizimi i aktiviteteve si një qasje u miratua nga njësitë e OKB-së në vend dhe u operacionalizua përmes planeve të përbashkëta vjetore dhe dy-vjetore dhe krijimit të forumeve të koordinimit duke përfshirë stafin e programit të OKB-së dhe përfaqësuesit teknikë të Qeverisë. Komiteti Drejtues i Përbashkët Qeveri-OKB ishte organi më i lartë vendimmarrës i PZhQ-së-së që e siguroi rishikimin dhe mbikëqyrjen e implementimit.

Që nga viti 2016, sistemi global i OKB-së për zhvillim ka pësuar ndryshime të rëndësishme që kanë ndikuar në organizimin dhe shpërndarjen e OKB-së në nivel shtetëror. Në 2019 filloi zbatimin e sistemit të rigjallëruar të Koordinatorit të Përhershëm, i reformuar me qëllim të mbështetjes së shpërndarjes e përbashkët të aktiviteteve të OKB-së në raport me përparësitë kryesore strategjike dhe ato të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha vendet ku operon OKB-ja, në Maqedoninë e Veriut, ndërsa u konsolidua në vitin 2020 - një vit që papritur kërkoi përkushtim të shkathhtë dhe përgjegjësi të jashtëzakonshme.

Ritmi i shpejtë i ndryshimit gjatë ditëve të para të krizës COVID kërkoi përshtatje të shpejtë në modalitetet e punës dhe riformësimin e përparësive. Subjektet e OKB-së shpejt rregulluan dhe ofruan mbështetje të menjëhershme për Qeverinë me aspekte strategjike dhe operacionale të reagimit të menjëhershëm, duke zbatuar udhëzimet e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për të qëndruar pranë dhe siguruar mbështetje. Kjo ndihmoi për të drejtuar përgjigjen e qeverisë ndaj krizës, për të ofruar kujdes më të mirë për pacientët me COVID-19, për të mbështetur vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve

**Ekipi i OKB-së në vend mbolli 75 pemë për ta shënuar 75 vjetorin e OKB së bashku me Kryeministrin Zoran Zaev, disa zyrtarë të tjerë qeveritarë, diplomatë dhe përfaqësues nga Ndërmarrja Publike Pyjet e Maqedonisë me rastin e shënimit të Ditës së OKB-së në vitin 2020. Foto©UNDP**



thelbësore dhe për t'i vlerësuar, zhvilluar dhe zbatuar disa nga masat e rimëkëmbjes afatmesme dhe afatgjata për zbutjen e aspektet ekonomike të krizës.



*"Ka një përparim të konsiderueshëm në mënyrën se si ekipi i OKB-së në vend mendon dhe vepron që nga tubimi i fundit i përbashkët. Veç më është shumë më koherent, gjithnjë e më shumë anëtarët e shohin fotografinë e madhe - përtej agjencive të tyre, janë të hapura për bashkëpunim, e kanë më shumë të qartë se bashkërisht mund të bëjmë më shumë sesa individualisht. Në përgjithësi, ekziston fryma e një familjeje të përbashkët të OKB-së."*

*Përgjigje anonime e një anëtar të ekipit të OKB-së në vend, sondazhi nga tubimi i përbashkët i ekipit të OKB-së në vend*

Gjatë dhënies së mbështetjes, OKB-ja është përpjekur në drejtim të koherencës dhe koordinimit nën udhëheqjen e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së që nga ditët e para të krizës, ashtu siç zhvillohej situata theksohej nevoja për rifokusim të operacioneve të veta. Më shumë se 20 agjenci të OKB-së funksionojnë në vend dhe pavarësisht nga prania e tyre fizike, ato e kanë demonstruar në praktikë angazhimin e tyre për të punuar ngushtë dhe në mënyrë koherente së bashku me Qeverinë dhe partnerët e tjerë. Ata e kanë ruajtur fokusin e fortë në prioritetet afatgjata duke i mbështetur nevojat e menjëhershme në raport me COVID-19 dhe planifikimin e rimëkëmbjes së qeverisë.

Si indikator i përkushtimit për punë të përbashkët ishte rritja e iniciativave të programit të përbashkët të konfirmuar, të cilat, u rritën për katërfish, gjegjësisht me katër projekte të përbashkëta, që realizoheshin ose kishin siguruar burime deri në fund të vitit 2020 krahasuar me një projekt të tillë në vitin 2019. Në përgjithësi, gjatë vitit 2020 ekipi i OKB-së në vend finalizoi konceptualisht nëntë ide të reja të përbashkëta në fushat e përgjigjes dhe rimëkëmbjes ndaj COVID-19, shëndetit, qeverisjes dhe ekonomisë, migrimit, financimit të QZhQ-ve dhe promovimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Duke pasur parasysh rimëkëmbjen ndaj COVID-19 dhe Agjendën 2030, OKB-ja dhe Qeveria e zhvilluan së bashku strategjinë e re 5-vjeçare (KBZhQ) që synonte përshejtimin e QZhQ-ve dhe përparësive nacionale të zhvillimit të qëndrueshëm. Përkundër rrethanave sfiduese, mbi 1,500 njerëz - pothuajse 1,100 qytetarë që morën pjesë në studimin e perceptimit dhe mbi 400 përfaqësues të subjekteve të ndryshme - ishin të përfshirë në këtë proces konsultativ. Kjo e ndërtoi një analizë gjithëpërfshirëse të kontekstit të vendit - Analiza e Përbashkët e Vendit 2020 (APV) - dhe u pasua nga një ushtrim gjithëpërfshirës i priorizimit strategjik.



**1,100** QYTETARË  
**400** PERSONEL TË AGJENCIVE  
TË KONSULTUAR GJATË PROCESIT TË KBZHQ-SË

Po ashtu ekipi i OKB-së në vend ndërmori një vetëvlerësim të kapaciteteve të veta teknike, operacionale dhe financiare për ta provuar gatishmërinë e vet për ta mbështetur Qeverinë në përbushjen e Agjendës 2030. Ushtrimi i konfigurimit të OKB-së rezultoi në disa ndryshime përpara ciklit KBZHQ, ku Konferenca e OKB-së për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD) dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (IAEA) nuk ishin pjesë e konfigurimit të ri të ekipit të OKB-së në vend, ndërsa ishin përfshirë UNOPS dhe UN-Habitat. Përderisa Unioni Ndërkombëtar për Telekomunikim (UNT) nuk e nënshkroi KBZHQ-në, njësitë ekonomike filloi të kontribuojë në mënyrë aktive në punën e përbashkët.

Gjatë vitit 2020, agjencitë e OKB-së e ruajtën praninë e fortë brenda vendit gjatë gjithë krizës COVID-19, e cila kontribuoi në pozicionimin e saj të fortë gjatë vitit sfidues. Aftësia e OKB-së për të analizuar dhe shkëmbyer njohuri në kohë reale, për t'iu përshtatur situatës lokale dhe për të ofruar mbështetje me zgjidhje të qëndrueshme për zhvillim dhe sfidat e krizës, u dëshmuar e vlefshme për mbështetjen të shpërndarjes së rezultateve. Aftësia për t'i shfrytëzuar njohuritë dhe ekspertizën e zyrave rajonale dhe globale dhe subjekteve jorezidente, për të mësuar dhe për ta shkëmbyer përvojën nga mjediset e tjera, ishte veçanërisht e vlefshme në vitin 2020 kur COVID-19 i kishte përshkallëzuar rëndë sfidat ekzistuese të zhvillimit. OKB-ja ishte e shpejtë në mbështetje të reagimit nacional dhe për të ndihmuar në vlerësimin e ndikimit të përparësive të ndryshme të zhvillimit. Përderisa strategjitë dhe prioritetet e zhvilluara në vitin 2020 - KBZHQ dhe KPK - mund të kenë nevojë për përshtatje, meqenëse janë në dispozicion prova të reja të ndikimit, sistemi i OKB-së e ka demonstruar fleksibilitetin e nevojshëm për ta rregulluar dhe mbështetur Qeverinë dhe partnerët e tjerë në identifikimin dhe zbatimin e zgjidhjeve afatgjate.

Roli i fuqizuar i Përfaqësuesit të Përhershëm të OKB-së, duke përfshirë edhe konsolidimin e një zyre të dedikuar për koordinim, kontribuoi në unifikimin e punës së OKB-së dhe koherencën e saj operacionale dhe strategjike. Puna e disa grupeve të brendshme tematike dhe operacionale është intensifikuar, duke siguruar një efikasitet më të madh, gjegjësisht koordinim dhe planifikim të përbashkët dhe pozicionim të jashtëm të një OKB.

Janë fuqizuar aktivitetet e përbashkëta të avokimit dhe të informimit për rritje të vizibilitetit të OKB-së dhe për përafrim të të gjitha aspekteve të punës së saj drejt njerëzve, përfshirë edhe nisjen e ueb faqes së re të korporatës së OKB në Maqedoninë e Veriut (<https://northmacedonia.un.org>) dhe publikimit të rregullt mujor të Buletinit të Zhvillimit të Qëndrueshëm, i cili synon të rrisë transparencën e OKB-së dhe ta përmirësojë mbështetjen e ofruar. Komunikimet janë në favor të mbështetjes së përgjigjes ndaj COVID-19 – siç është zhvillimi dhe zbatimi i komunikimit me rrezik dhe aktivitetet e angazhimit të komunitetit, që i synojnë segmentet më të prekshme dhe të ndikuara të popullsisë - ose fushata të rregullta vjetore - siç janë 16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës Gjimore - përfaqësojnë vetëm disa shembuj të punës së përbashkët dhe të fuqishme të mbështetjes së ofruar nga OKB në vitin 2020. Përpos kësaj, disa aktivitete kryesore të brendshme përgatitore janë realizuar në vitin 2020, me qëllim të avancimit të avancuar llogaridhënies dhe transparencës së operacioneve të OKB dhe rezultateve të arritura përpara zbatimit të KBZHQ 2021-2025, përfshirë hapjen e mjetit të ri të planifikimit dhe monitorimit UN INFO dhe punës preliminare për Kornizën e Financimit të KBZHQ-së.

Zhvillimi i Strategjisë së Operacioneve të Biznesit (SOB) 2.0 në vitin 2020 ishte një hap i rëndësishëm drejt realizimit të Agjendës Globale të Efikasitetit të OKB-së. Zbatimi i planit pesëvjeçar (2021-2025) do të gjenerojë efikasitete më të

mëdha operacionale, sinergji dhe koherencë, e cila vlerësohet të rezultojë në 1.1 milion dollarë kursime përmes eliminimit të kostove të transaksionit, kursimit të kohës së stafit dhe përfitimit nga ekonomitë e shkallës, për shembull përmes vëllimit më të madh të prokurimit. OKB-ja në Maqedoninë e Veriut është zotuar të zhvillojë më tej shërbime të përbashkëta në fushat e menaxhimit të objekteve dhe lokaleve, teknologjisë së informacionit, burimeve njerëzore, financave dhe prokurimit. Kjo do ta mundësojë eliminimin e mëtejshëm të dyfishimit dhe përdorimin e fuqisë së përbashkët të negociatave të OKB-së. Në fund të vitit 2020, tre agjenci të OKB-së e kishin në objekt të përbashkët - një objekt të OKB-së - ku ishte e vendosur edhe Zyra për Koordinim e OKB-së, ndërsa agjencitë tjera gjendeshin në godina dhe zyra të ndara.

Meqenëse ishte shumë e ndikuar nga kriza COVID-19, OKB-ja në Maqedoninë e Veriut siguroi vazhdimësinë e punës dhe funksionimin pa ndërprerje, duke e ruajtur kujdesin për sigurinë dhe shëndetin e stafit të saj si përparësinë kryesore. Marrëveshjet e punës fleksibile dhe të largëta u vendosën herët dhe kur ishte e nevojshme, së bashku me zbatimin e rreptë të masave të parandalimit, zbutjes dhe gatishmërisë.

*Djaloshi i ri Pavell Milanovski nga Maqedonia e Veriut e fitoi çmimin e parë në konkursin e afishes më të mirë në Ditën Botërore të Ushqimit për vitin 2020 të organizuar nga FAO, duke u përqendruar te heronjtë e ushqimit: fermerët dhe punëtorët në të gjithë zinxhirin e furnizimit ushqimor. Foto©FAO*



# Mobilizimi i financave dhe resurseve

## Pasqyra financiare

Në vitin 2020, 40.1 milion dollarë u vunë në dispozicion të OKB-së në Maqedoninë e Veriut nga të cilat u shpenzuan 35.8 milion dollarë, duke arritur në 89% të shkallës së realizimit. Duke parë rezultatet e PZHQ-së, qëndrueshmëria e mjedisit jetësor, përfshirja sociale dhe punësimi ishin burimet më intensive, përkatësisht me shpenzime prej 16.8 milion dollarë, 7.8 milion dollarë dhe 6.2 milion dollarë, pasuar nga qeverisja e mirë dhe barazia gjinore, përkatësisht me 4.2 milion dollarë dhe 0.8 milion dollarë amerikan.


Shumica e fondeve u mor në formën e burimeve jo-thelbësore (33.3 milion \$, 89%). Ndër burimet e financimit jo-thelbësor, shumica e kontributeve vijnë nga financimi specifik i projektit

dhe programit (76%) të ndjekur nga fondet vertikale globale (14%), fondet tematike (4%), fondet e bashkuara (3%) dhe fondet qeveritare (3%).

10 burimet kryesore të fondeve jo-thelbësore në vitin 2020 për punën e OKB-së në Maqedoninë e Veriut ishin BE-ja, Mekanizmi Global për Mjedisin Jetësor, Zvicra, Suedia, Shtetet e Bashkuara, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia, Migracionit Multi-partner (MPTF) dhe Maqedonia e Veriut. Të dhënat financiare për vitin 2020 janë paraqitur në grafikët më poshtë. Të dhënat janë sipas raportimit në dollarë amerikanë me 19 mars të vitit 2021 dhe kanë të bëjnë me periudhën 1 janar - 31 dhjetor të vitit 2020.

### Resurset e nevojshme, të disponueshme dhe të shpenzuara – në total dhe për çdo rezultat

Të dhënat nga 19 marsi i vitit 2021 për periudhën 1 janar – 31 dhjetor të vitit 2020, të paraqitura në milion dollarë amerikan




Burimi: OKB në Maqedoninë e Veriut 2021; financimi dhe shpenzimet e disponueshme bazohen në sistemet financiare ose informacionet për sistemet financiare të agjencive të OKB-së nga 19 marsi i vitit 2021.

### Kontributet sipas modelit dhe burimit të financimit:

për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2020, në milion dollarë amerikan

Burimet e përgjithshme themelore dhe jo themelore (37.6 milion dollarë) i përfaqësojnë fondet e marra mes 1 janarit dhe 31 dhjetorit të vitit 2020 (pjesërisht në të holla të gatshme). Shuma është më e vogël se të gjitha fondet e disponueshme për vitin 2020 (40.1 milion dollarë, bazë përlllogaritje rrjedhëse) pasi disa fonde për aktivitetet e vitit 2020 u morën në fund të vitit 2019, ndërsa më pak mjete si avans për vitin 2021 u morën në vitin 2020.



Burimi: OKB në Maqedoninë e Veriut 2021



## Mobilizimi i resurseve

**Mobilizimi i resurseve në vitin 2020 u përqendrua në mobilizimin e financimit të përgjigjes KOVID-19 dhe në qasjen e fondeve globale për ndërhyrje të përbashkëta të OKB-së.**

### Identifikimi i burimeve për përgjigje ndaj KOVID-19

OKB-të në mënyrë rapide u angazhuan në mobilizimin e shpejt të burimeve për reagim të menjëhershëm dhe të duhur ndaj krizës në mbështetje të përpjekjeve të Qeverisë. Fondet u siguruan nga donatorët dypalësh në vend, nga fondet tematike globale dhe të bashkuara dhe përmes rialokimit të burimeve ekzistuese. Në vitin 2020, OKB-ja i dha mbështetje vendit me vlerë prej gati 12 milion dollarë, shumica e të cilave u mobilizuan rishtas. Agjencitë e OKB-së ishin të suksesshme në shfrytëzimin e burimeve të tyre të brendshme, sikurse përmes Fondit KOVID-19 të OBSH-së ose Fondit të UNDP-së për reagim të shpejtë.

### Kërkimi i mbështetjes për veprim të përbashkët

Si një nga përparësitë e saja strategjike, OKB në Maqedoninë e Veriut u përqendrua në vitin 2020 në rritjen e pjesës së saj të fondeve të siguruar për veprim të përbashkët, me një fokus kryesor në objektet e financimit global si burime të financimit. Nëntë projekte të zhvilluara u dorëzuan në katër fonde të bashkuara të OKB-së:

\* Thirrja e Përbashkët për Financim e Fondit QZHQ, Komponentët 1 dhe 2 (dy konceptet e projektit janë dorëzuar)

\* Fondi i Mirëbesimit me Shumë Partnerë të Migracionit (tre koncepte të projektit janë dorëzuar)

\* Fondi i Reagimit dhe Rimëkëmbjes KOVID-19 MPTF (paraqitur tre koncepte të projektit)

\* Fondi i OKB-së i Partneritetit të Personave me nevoja të posaçme (PPNP) (një shprehje interesit është dorëzuar)

Për më tepër ekipi i OKB-së në vend ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në përgatitjen e përshtatshmërisë rajonale të aplikimit të Fondit për Ndërtim të Paqes për Ballkanin Perëndimor.

Përmes këtyre përpjekjeve të koordinuar, OKB-ja në Maqedoninë e Veriut me sukses e ka ngritur shumën 2.75 milion dollarë për tre nga nëntë projektet e reja të përbashkëta përmes fondeve të bashkuara të OKB-së:

- "Planifikimi dhe diskursi i politikave të migracionit, të bazuara në prova në Maqedoninë e Veriut", financuar nga MPTF e Migracionit (1.5 milion dollarë) dhe zbatuar nga IOM, UNHCR dhe UNFPA mbi 30 muaj.
- "Shërbime shëndetësore të sigurta dhe inovative në kohën e KOVID-19, financuar nga Fondi i Reagimit dhe Rimëkëmbjes KOVID-19 (0,85 milion dollarë), zbatuar nga UNFPA-ja, OBSH-ja dhe UNICEF-i, mbi 14,5 muaj.

- Faza fillestare e projektit të përbashkët për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, financuar nga Fondacioni për Bazën e Patentimit të Barërave MPPF MPP të OKB-së (0.4 milion \$), gjatë periudhës 24 mujore.

**9** PROJEKTE TË PËRBASHKËTA të zhvilluara në vitin 2020

**33%** SHKALLA E SUKSESIT me dorëzimin e përbashkët të projektit

**\$2.75M** të mobilizuara përmes fondeve globale të bashkuara të OKB-së

Këto përpjekje synonin të përmirësonin përzjerjen e burimeve të financimit, duke e rritur përqindjen e llojeve të fondeve më pak të destinuara, siç ishin fondet vertikale, të bashkuara dhe tematike, dhe duke zvogëluar mbështetjen në financimin specifik të projektit si burimi i financimit më të përcaktuar. Në fund të vitit 2020, financimi specifik i projektit dhe programit ngeli burimi kryesor për aktivitetet e OKB-së në Maqedoninë e Veriut. Kalimi në burime më pak të destinuara të financimit do të lejonte shënjestrimin më fleksibël të mbështetjes së OKB-së dhe shfrytëzimit optimal të dispozitës së ekspertizës së OKB-së.

### Planifikimi për KBZHQ 2021-2025

Në tremujorin e fundit të vitit, u zhvillua Korniza e Financimit e KBZHQ-së, e cila ofron një përmbledhje të hollësishme të nevojave për mobilizimin e burimeve për periudhën e ardhshme pesëvjeçare, si dhe një analizë të përzjerjes të financimit të fondeve në dispozicion. Bazuar në këto informacione, Strategjia e Mobilizimit të Burimeve KBZHQ do të zhvillohet në gjysmën e parë të vitit 2021, duke i përcaktuar qasjet dhe mjetet specifike për të siguruar mobilizimin e koordinuar të burimeve dhe dialogun më të strukturuar të financimit me partnerët kontribuues.

**UNOPS prokuroi dhe dorëzoi pajisje dhe materiale vitale mjekësore për ta luftuar KOVID-19 në vlerë prej 4 milion € të alokuara nga BE-ja.** Foto©UNOPS



# OKB-ja në Maqedoninë e Veriut në vitin 2021

OKB-ja dhe Qeveria e Maqedonisë së Veriut filluan zbatimin e strategjisë së re pesëvjeçare (2021-2025), e cila ka tre prioritetet strategjike:

\* Zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik dhe shoqëror

\* Veprimi i klimës, burimet natyrore dhe menaxhimi i rrezikut nga katastrofat

\* Qeverisje demokratike transparente dhe e përgjegjshme

KBZhQ-ja do të kontribuojë në përbushjen e synimeve, me çka deri në vitin 2025 njerëzit e Maqedonisë së Veriut:

1. do ta kenë të përmirësuar standardin e jetesës përmes qasjes së barabartë në punë të denjë dhe punësim produktiv të gjeneruar nga një ekosistem biznesi gjithëpërfshirës dhe inovativ;
2. do të kenë qasje universale në shërbime sociale me cilësi të bazuar në të drejtat - kujdesin shëndetësor, arsimin dhe mbrojtjen e nevojshme sociale dhe të fëmijëve - të rrënjësura në sisteme të qëndrueshme ndaj emergjencave;
3. do të përfitojnë nga veprimet ambicioze të klimës, burimet natyrore të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe biodiversiteti i ruajtur mirë përmes qeverisjes së mirë të mjedisit jetësor dhe komuniteteve të qëndrueshme ndaj katastrofave; dhe
4. do të përfitojnë nga sundimi i përmirësuar i ligjit; politikave e bazuara në prova, parashikuese dhe reaguese ndaj gjinisë; kohezioni më i madh shoqëror; dhe ofrim efektiv i shërbimeve nga institucione transparente, llogaridhënëse dhe të përgjegjshme.

Në vitin 2021, fokusi kryesor i ekipit të OKB-së në vend do të jetë:

Përgjigja ndaj COVID-19 do të ngel përparësi kryesore. Ekipi i OKB-së në Maqedoninë e Veriut do të vazhdojë të sigurojë mbështetje politike dhe teknike për përgjigjen shëndetësore dhe socio-ekonomike të udhëhequr nga qeveria ndaj ndikimit të COVID-19, si dhe të fillojë dhe nxisë ndërhyrje për rimëkëmbje të qëndrueshme, të barabartë dhe të gjelbër të shoqërisë si një tërësi përmes integritit të mbështetjes së COVID-19 me zbatimin e KBZhQ-së.

Implementimi i KBZhQ-së dhe përshpejtimi i Agjendës 2030 do të jetë në qendër të përpjekjeve të ekipit të OKB-së përmes zbatimit të KBZhQ-së - duke siguruar këshilla politike dhe mbështetje për institucionet shtetërore, të përafuara ngushtë me rrjedhat e punës nacionale, në veçanti procesin e Strategjisë Nacionale për Zhvillim.

OKB-ja në Maqedoninë e Veriut do të punojë drejt funksionalizimit të mëtejshëm të vizionit parandalues të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së - për t'i parashikuar, parandaluar dhe menaxhuar rreziqet në lidhje me goditjet e brendshme dhe të jashtme që mund ta minojnë përbushjen e Agjendës 2030 dhe ta mbështesë qëndrueshmërinë; të kërkojë mundësi për

iniciativa të bashkëpunimit rajonal që përfshijnë aktivitete të përqendruara në parandalim dhe të punojnë së bashku me të gjithë partnerët për ta minimizuar ndikimin rikthyes të krizave të vazhdueshme, siç është COVID-19 dhe kërcënimet në të ardhmen.

Financimi strategjik dhe partneriteti janë me rëndësi thelbësore për përbushjen e QZhQ-ve. Në vitin 2021, ekipi i OKB-së në Maqedoninë e Veriut do ta promovojë dhe përmirësojë më tej qasjen e koordinuar ndaj partneriteteve, e cila do të përfshijë përqendrim të shtuar në identifikimin dhe sigurimin e mundësive të përbashkëta të financimit të KBZhQ-së dhe rritjen e partneriteteve dhe avokimit të financimit të QZhQ-ve.

OKB në Maqedoninë e Veriut do ta forcojë më tej promovimin e parimit askush të mos lihet pas, barazinë gjinore, të drejtat e njeriut dhe vlerat e saja themelore, standardet dhe parimet e rrënjësura brenda Kartës dhe traktateve të OKB-së - përmes avokimit dhe promovimit, përfshirjes së vazhdueshme në politikë dhe planifikimit dhe zbatimit të fuqizuar.

Në fushën e inovacionit të biznesit, ekipi i OKB-së në Maqedoninë e Veriut do t'i vlerësojë, rregullojë dhe forcojë më tej proceset e brendshme për të promovuar dhe gjeneruar efikasitete më të mëdha operationale, sinergji dhe koherencë përmes zbatimit të Strategjisë së Operacioneve të Biznesit dhe rrjedhave të tjera të punës.

*Korniza për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Qëndrueshëm e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kombeve të Bashkuara 2021-2025* Foto©ZKP



Linku i dokumentit

[ENG](#)

[MKD](#)

[ALB](#)

# Shtojcat

## Lista e shkurtesave

AP	Agjencia për Punësim
BERZh	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) CEFTA Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
DPSH	Dokumenti i Programit të Shtetit
DShRS	Të drejtat e shëndetit riproduktiv seksual
DhBgj	Dhuna e bazuar në gjini
DhF	Dhuna Familjare
EE	Efikasiteti Energjetik
EOKBV Ekipi	i OKB-së në vend
ER	Energjia e ripërtitshme
ESGj	Edukimi seksual gjithëpërfshirës
FKGj	Fondi i Klimës së Gjelbër
GS	Gazrat serrë
IGMJ	Instrumenti Global i Mjedisit Jetësor
KBD	Komiteti i Përbashkët Drejtues
KBZhQ	Korniza e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Bashkëpunim
KKQ	Kyri i Kuq i Qytetit
KPK	Korniza e Përgjigjes ndaj COVID-19
KPN	Kontributet e Përcaktuara Nacionale
KSE	Këshillin Social Ekonomik

MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
NPAA	Programi Nacional për Miratimin e legjislacionit të BE-së
PNP	Personat me nevoja të posaçme
PZHQ	Partneriteti për Zhvillim të Qëndrueshëm
RVN	Rishikimin Vullnetar Nacional
RZhNj	Raporti për zhvillimin e njerëzve
SNZh	Strategjia Nacionale për Zhvillim
ShRS	Shëndeti riproduktiv seksual
UNRN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
ZhFH	Zhvillimi në Fëmijëri të Hershme

## Lista e partnerëve

### Qeveria e agjencitë shtetërore

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave  
Ministria e Kulturës  
Ministria e Mbrojtjes  
Ministria e Ekonomisë  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës  
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministria e Financave  
Ministria e Punëve të Jashtme  
Ministria e Shëndetësisë  
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës  
Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministria e Drejtësisë  
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale  
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale  
Ministria e Transportit dhe Lidhjeve  
Akademia e Gjakatësve dhe Prokurorëve  
Agjencia për Promovimin e Sipërmarrësisë  
Agjencia e Kadastrës  
Zyra e Prokurorisë Themelore Publike  
Byroja për Zhvillimin e Arsimit  
Byroja për Zhvillim Rajonal  
Qendra për Arsim të Personave të Rritur  
Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim  
Qendrat për Shëndet Publik  
Qendrat për Zhvillim Rajonal  
Qendrat për Punë Sociale  
Qendra për Menaxhimin e Krizave  
Drejtoria e Doganave  
Zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike,  
Koordinimi i Departamenteve Ekonomike dhe Investimeve  
Zëvendëskryeministri për Çështje evropiane  
Zëvendëskryeministri për Luftë kundër Korrupsionit  
Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Kapital Njerezor  
Drejtoria për Ekzekutimin e Sanskioneve  
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim  
Drejtoria për Menaxhim të Ujërave  
Agjencia për Punësim  
Zëvendëskryeministri dhe Ministër përgjegjës për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Komuniteteve  
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë  
Fondi për Inovacion dhe Zhvillim të Teknologjisë  
Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë  
Fondi për Sigurim Shëndetësor  
Shërbimi Hidrometeorologjik  
Këshilli për Imunizim  
Instituti i Shëndetit Publik  
Grupi ndërparlamentar për të drejtat e personave me nevoja të posaçme  
Giyqësia  
Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale  
Komisioni Nacional për Luftë kundër Trafikimit me Njerëz  
Komisioni Nacional i Maqedonisë së Veriut për UNESCO  
Këshilli Nacional për Zhvillim të Qëndrueshëm (KNZhQ)  
Agjencia Nacionale për Zgjerim  
Parqet Nacionale  
Kabineti i Kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Kabineti i Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Ombudspersoni  
Komisioni parlamentar për ekonomi  
Komisioni parlamentar për arsim, shkencë dhe sport  
Komisioni parlamentar për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat  
Komisioni parlamentar për çështje evropiane  
Komisioni parlamentar për kujdesin shëndetësor  
Komisioni parlamentar për punë dhe politikë sociale  
Entet shëndetësore të nivelit primar  
Prokuroria Publike për Krim të Organizuar dhe Korrupsion  
Spitalet rajonale  
Komisioni për amësi të sigurtë  
Sekretariat për Çështje Evropiane

Komisioni i përhershëm hetimor për mbrojtjen e qytetarëve  
Liritë dhe të drejtat  
Inspektorati Shtetëror i Arsimit  
Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor  
Enti Shtetëror i Statistikës  
Klinikat Universitare

### Organizatet e shoqërisë civile

OSHC-të për zhvillim bujqësor dhe rural  
OSHC-të për luftë kundër varfërisë  
Asociacioni CeProSARD  
Asociacioni Eko Svest  
Asociacioni Fagrikom  
Asociacioni për Emancipim, Solidaritet dhe Barazitë Grave (ESG)  
Asociacioni Qendra e Gjelbër  
Asociacioni Kocka  
Asociacioni Milieukontakt Macedonia  
Asociacioni Gjinekologji dhe Akusheri  
Asociacioni i infermiereve dhe mamive  
Asociacioni edukatorëve të posaçëm  
Bashkësia e njësitë të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut – BNJVL  
Fondacioni i Ballkanit për Zhvillim të Qëndrueshëm (FBZhQ)  
Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit  
Ndërlidhja e vlerave të natyrshme dhe njerëzve (NVNj) Maqedonia)  
OSHC-të e mjedisit jetësor  
OSHC-të e të drejtave gjinore  
Asociacioni për Shëndet, Arsim dhe Hulumtim (HERA)  
Projekt për Mundësi të Shëndetshme (HOPS)  
Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut  
Asociacionet e ligjit të punës së Maqedonisë së Veriut  
OSHC-të për të drejtat e LGBTI-së  
Platforma maqedonase kundër varfërisë (PMKV)  
Shoqëria ekologjike të Maqedonisë së Veriut (ShEMV)  
Asociacioni i Juristëve të Maqedonisë së Veriut (AJMV)  
Asociacioni i mjekeve të Maqedonisë së Veriut  
Asociacioni i sigurisë së punës në Maqedoninë e Veriut  
Kryqi i Kuq i Maqedonisë së Veriut  
Asociacioni i Juristëve të Rinj të Maqedonisë së Veriut  
OSHC-të për të drejtat e migrantëve, refugjatëve dhe personave pa shtetësi  
Këshilli nacional për personat me nevoja të posaçme  
Federata Nacionale e Fermerëve  
Hapni Dyert - La Strada Maqedonia e Veriut  
Organizata e Punëdhënësve të Maqedonisë së Veriut  
Organizatet e personave me nevoja të posaçme  
Platforma – Miqtë e Sharrit  
OSHC-të për të drejtat e romëve  
Rrjeti për Zhvillim Rural  
Të drejtat e punëtorëve seksual  
Skopje Lab (Qyteti i Shkupit)  
Smart-ap – Laboratori për inovacion social  
STAR STAR – Kolektivi i parë i punëtorëve seksuale në Ballkan  
Sindikatat tregtare  
OSHC-të e të rinjve  
Rrjeti i të rinjve bashkëmoshatarë (Y-PEER)  
Zaedno Posilni (Së bashku më të fortët)

### Bota akademike

Qendra për Arsim të Vazhdueshëm të Mjekëve Familjarë  
Qendra për konsultim dhe hulumtim për zhvillim të hershëm të fëmijëve (ECD Cor)  
Fakulteti i Shkencave të Bujqësisë dhe Ushqimit (USHKM)  
Fakulteti për Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri (USHKM)  
Fakulteti i Shkencave të Pylltarisë, Arkitekturës, Peisazhit dhe Ekoinxhinierisë "Hans Em" (USHKM)  
Fakulteti Juridik "Justinian Prima" (USHKM)  
Fakulteti i Mjekësisë (USHKM)  
Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Matematikës (USHKM)  
Fakulteti i Filozofisë (USHKM)  
Instituti Hidrobiologjik i Ohrit

Instituti për të Drejtat e Njeriut  
Instituti për Shëndetin e Nënave dhe Fëmijëve  
Instituti i Ekonomisë (USHKM)  
Instituti Studimeve Gjinore (USHCM)  
Instituti i Punës dhe Politikës Sociale (USHKM)  
Qendra e Maqedonisë së Veriut për Arsim Qytetar  
Qendra për Hulumtim të Energjisë dhe Zhvillimit të Qëndrueshmërisë (ASHAM)  
Akademia Policore Shkup  
Universiteti "Sh. Kirili dhe Metodi" (USHKM)  
Fakultetet për Trajnimin e Arsimtarëve në Shkup, Shtip, Tetovë, Manastir  
Think-tank  
Zyra e UNESCO-s  
Universitet "Gocë Dellçev" Shtip  
Klinika Universitare e Pediatrisë (Qendra Klinike "Nënë Tereza") (USHKM)  
Universiteti i Tetovës  
Institute të ndryshme mjekësore të specializuara

### Partnerët ndërkombëtarë

Ambasada e Austrisë (ADA)  
Ambasada Britanike së Madhe  
Banka Qendrore Evropiane (BQE)  
Zyra Konsullore e Republikës së Sllovakisë  
Delegacioni i Bashkimit Evropian  
Iniciativa për Përgatitje dhe Parandalim në Jug  
Iniciativa për Jug  
Evropa Lindore (DPPi E.JL)  
Ambasada e Francës  
Ambasada e Suedisë (SIDA)  
Ambasada e Zvicrës (SDC, SECO)  
Ambasada e Republikës së Turqisë  
Ambasada e Federatës së Rusisë  
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)  
Fondacioni Evropian për Trajnim (FET)  
Konsullata e Përgjithshme e Belgjikës  
Kompani të ndryshme  
Qendra e Gjenezës për Qeverisje të Sektorit të Sigurisë (DCAF)  
Ambasada e Gjermanisë  
Zyra e GIZ-së  
Qendra Ndërkombëtare për Zhvillim të Politikave për Migracion (ICMPD)  
Sindikata Ndërkombëtare për Ruajtje të Natyrës, Zyra Rajonale për Evropë Perëndimore dhe Azi Qendrore (IUCN – ECARO)  
Fondacioni Ndërkombëtar për Klubi Lion  
Iniciativa Rajonale për Migracion, Azil dhe Refugjatë (MARRI)  
Ambasada e Holandës  
Rrjeti i Asociacionit të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS)  
Misioni i OSBE-së  
Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë  
Zyra Rajonale për Bashkëpunim të Rinisë (RYCO)  
Programi Pan-evropian për transport, shëndet dhe mjedis jetësor (PEP)  
Ambasada e Shteteve të Bashkuara (USAID)  
Grupi i ekspertëve për efikasitet energjetik UNECE

### Sektori privat dhe të tjerët

Asociacioni i avokatëve  
Konfederata e Bizneseve të Maqedonisë së Veriut  
Oda e ndërmjetësuesve  
Diaspora  
Oda e mjekeve  
Mediat  
Institucionet e kujdesit shëndetësor

Kompani të ndryshme



UNITED NATIONS  
NORTH MACEDONIA



[northmacedonia.un.org](http://northmacedonia.un.org)

[www.facebook.com/1un.mk](https://www.facebook.com/1un.mk)

[www.twitter.com/1UN\\_MK](https://www.twitter.com/1UN_MK)

# Shtojca: Rezultatet e prodhimeve të vitit 2020

## REZULTATI 1

### Më shumë vende pune dhe më cilësore

*Deri në vitin 2020 më shumë gra dhe burra do të jenë në gjendje ta përmirësojnë jetesën e tyre, duke siguruar punësim të qëndrueshëm në ekonomi me rritje konkurruese dhe të pasur me vende pune.*

#### Kontributi në:



Zhvillimin e ekonomisë, rritjen e punësimit produktiv dhe ngritjen e nivelit të jetesës së qytetarëve;  
Reformat në sistemin arsimor dhe investimet në inovacion dhe teknologjitë e informacionit;



Pikësëpari elementet bazë: Zhvillimi ekonomik dhe konkurrenca  
19. Politika sociale dhe punësimi;  
20. Sipërmarrja dhe politika industriale;  
26. Arsimi dhe kultura

Agjencitë e OKB-së që kontribuojnë në përbushjen e këtyre rezultateve:  
ILO, IOM, UNDP, UNECE

Qeveria dhe partnerët tjerë zhvillimorë:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Agjencia e Shërbimit të Punësimit, shoqëria civile, sektori privat, bota akademike dhe të tjerët

#### (1.1) Institucionet nacionale i kanë përmirësuar kapacitetet për zhvillim, i kanë implementuar dhe monitoruar politikat dhe masat, të cilat ndihmojnë në gjenerimin e më shumë vendeve të qëndrueshme të punës

Brenda rrethanave të ndryshuara, OKB-ja vazhdoi të bashkëpunojë me institucionet nacionale, duke i ndërtuar kapacitetet e tyre për t'i hartuar, zbatuar dhe monitoruar politikat e punës. Kjo përfshiu sigurimin e diagnostikimit të punësimit për ta mbështetur formulimin e Strategjisë Nacionale të Punësimit dhe Planin e Veprimit të bazuar në fakte, përfshirë Punësimin e të rinjve (që do të finalizohet në qershor të vitit 2021). Institucionet nacionale ishin të pajisura me modelin e parashikimit të OKB-së dhe parashikimet e tregut të punës dhe indikatorët e varfërisë për programimin e Instrumentit të Ndihmës Para-aderuese (IPA) III, të bazuar në dëshmi. Institucionet e reja u krijuan me mbështetjen e OKB-së (dy Qendra trajnuese gjithëpërfshirëse për rehabilitim, të orientuar në punë për personat me aftësi të kufizuara), si dhe Partneriteti i parë Lokal i Punësimit, i zbatuar nga Qendra për startap e Manastirit me zgjidhje lokale për sfidat specifike të komuniteteve.

Agjencia për Punësim (AP) ishte në gjendje ta merrte përsipër me sukses dhe ta zbatonte masën e vetëpunësimit të filluar nga OKB-ja, madje njashtu përfitoi nga ndërtimi i kapaciteteve të stafit të saj në 30 Qendra të Punësimit. Për më tepër, për të mbështetur krijimin e një partneriteti më të fortë midis AP-së dhe sektorit privat, OKB-ja i avancoi njohuritë dhe aftësitë e 49 këshilltarëve të punëdhënësve të AP-së, nga të cilët 65% ishin gra. AP-ja gjithashtu arriti t'i integrojë plotësisht shërbimet e reja për punëdhënësit në operacionet e saj, të tilla si Platforma e Veprimit për NVM-të që funksionon si një pikë për NVM-të, me qëllim që të tejkalohen sfidat e paraqitura nga pandemia e KOVID-19. Me mbështetjen e OKB-së, partnerët socialë ishin në gjendje ta rrisin dukshmërinë dhe avokimin e mbështetur në prova, dhe të ruajnë dhe tërheqin anëtarë të rinj duke i përshtatur shërbimet e tyre me realitetin e ri.

Ashtu siç u zhvillua kriza KOVID-19, OKB-ja më vonë gjatë vitit ofroi rekomandime të bazuara në dëshmi mbi ndikimin socio-ekonomik, përmes: "Vlerësimit të Shpejtë të Ndikimeve të Punësimit dhe Përgjigjeve të Politikave", "Ndikimi i pandemisë Kovid-19 në ndërmarrjet në Maqedoninë e Veriut" dhe më

gjërë "Vlerësimi Socio-Ekonomik i Ndikimit të KOVID-19 në Maqedoninë e Veriut". Një task forcë për KOVID-19 dhe Botën e Punës u krijua brenda Këshillit Ekonomik e Social (KES), e cila mundësoi pjesëmarrjen e saj aktive në hartimin e masave të Qeverisë kundër krizës. Si rezultat i kësaj, u zgjerua stimuli qeveritar për të siguruar përfitime të papunësisë për 3,803 persona të tjerë të përjashtuar, për shkak të rregulloreve të miratuara nga pronarët e ndërmarrjeve; ndërsa skema e subvencionimit të pagës minimale u zgjat deri në qershor të vitit 2020.

Me ndërhyrje të synuara dhe mbështetje të OKB-së, 314 punësime afatgjata u siguruan përmes grupeve të ndryshme të masave aktive të tregut të punës; ndërsa 126 kompani të reja u krijuan përmes vetë-punësimit të sapo prezantuar për t'i mbështetur njerëzit që i kanë humbur vendet e punës. OKB-ja gjithashtu i mbështeti fermerët duke prezantuar bujqësi kontraktuale dhe teknologji të re inovative në përpunimin e ushqimit, dehidratimin dhe paketimin në qendrën e trajnimit në Strumicë. Si rezultat i kësaj, 35 bujq lokalë ishin në gjendje t'i tejkalonin sfidat e prodhimit, shpërndarjes dhe vendosjes në treg të produkteve vendore, veçanërisht në kontekstin e krizës KOVID-19.

**314** punësime  
afatgjate

**126** kompani të reja  
të themeluara

#### (1.2) Grupet me pjesëmarrje të ulët të fuqisë punëtore dhe shkallë të ulët të punësimit i fitojnë aftësitë dhe qasjet e duhura për të siguruar punë më të denjë në tregun zyrtar të punës

Gjatë gjithë vitit OKB-ja vazhdoi t'i avancojë aftësitë e grupeve më të cenushme për ta rritur mundësinë e tyre për punë të formalizuar dhe të denjë. Në këtë kontekst, me ndihmën e OKB-së 584 personave të papunë ju mundësua t'i përvetësojnë aftësitë përkatëse të tregut, nga të cilat 65% ishin gra dhe 29 ishin të burgosur (8 sosh ishin gra). Të gjithë këta morën certifikata të pranuar nga shteti.

OKB-ja njashtu i mbështeti përfituesit e synuar duke përfshirë të kthyerit, përfituesit e Programit të Kthimit Vullnetar dhe Ri-integrimit, nga të cilat 67% kanë gjetur punë. Po ashtu OKB-ja e ka lehtësuar punësimin e 12 të rinjve nga 183 personat e trajnuar përmes 5 Klubeve të Informimit të Rinisë në 4 universitete shtetërore. Përveç kësaj, një Qendër e Burimeve Rinore në Gostivar u krijua rishtazi për inovacion, karrierë, aftësi dhe qendër fillestare për t'i mbështetur të rinjtë në rajonin e Pollogut.

Me ndërhyrje të synuara, OKB-ja ishte në gjendje të angazhonte 613 të papunë, nga të cilët 71 pranues të ndihmës minimale të garantuar për të ofruar shërbime sociale për mbi 8,900 përfitues të fundit në 52 komuna.

<b>107</b> Romë të punësuar	<b>584</b> persona të papunë të trajnuar	<b>29</b> të burgosur që morën çertifikata
-----------------------------	--	--

**(1.3) Sistemi i arsimit dhe trajnimit është i fuqizuar, me qëllim që t'iu ofrojë ndihmë personave, të cilët nuk kanë kualifikime dhe shkathësi të nevojshme për t'i përmbushur kërkesat e tregut të punës**

Në bashkëpunim me qeverinë, OKB-ja ka punuar në analizën e mundësive të punësimit që do ta plotësonin kërkesën e biznesit për fuqi punëtore të kualifikuar, për të krijuar ndryshime sistematike në modelin e arsimit. Mjetet e ndryshme metodologjike përfshinin vlerësimin e lidhjeve dhe boshllëqeve midis arsimit dhe punësimit, si dhe vlerësimin e aftësive për ndërtimin, industrinë e tekstilit dhe energjisë së rinovueshme. Gjithashtu OKB-ja e ka përfshirë analizën e gjendjes së arsimit pas shkollës së mesëm dhe konceptin për përgatitjen e një qendre rajonale private të arsimit dhe aftësimin profesional në Maqedoninë e Veriut.

Procesi ka qenë shumë konsultativ - ishin të përfshirë 186 kompani, 32 institucione arsimore dhe 30 institucione të qeverisjes qendrore dhe lokale; 48 përfaqësues nga sektori privat (80% gra), përfituan nga ndërtimi i kapaciteteve në menaxhimin e burimeve njerëzore (BNJ). Nga këto, 12 ndërmarrje duhej të ndiqnin trajnime të mëtejshme për të përgatitur plane afatgjata të BNJ me metrika gjinore (%) të grave dhe burrave të përfshirë në industri. Trajnimi profesional gjithashtu u krijua për t'i përmbushur nevojat e 40 ndërmarrjeve dhe iu ofruar

*Falë mbështetjes që iu dha përmes Programit të vetë-punësimit të zhvilluar nga UNDP, Mezgjun Vejselov ishte në gjendje ta realizojë ëndrrën e tij për hapjen e sallit të tij të floktarisë në qytetin e tij të lindjes, në Shtip. Foto©UNDP*



149 personave të papunë, nga të cilët mbi gjysma pritej të punësoheshin pas përfundimit të suksesshëm të trajnimit.

**(1.4) Institucionet dhe proceset trepalëshe të dialogut social janë përmirësuar si një mjet për ta promovuar punën e denjë dhe rritjen e qëndrueshme**

Gjatë gjithë vitit, OKB-ja vazhdoi t'i mbështeste KES-të për t'u angazhuar në mënyrë domethënëse në dialogun social me ndërhyrje të bazuara në prova. Në këtë kontekst, OKB-ja ka siguruar analiza të procedurave të negociatave kolektive, me një fokus në mekanizmat e vendosjes së pagave dhe ka zbatuar një projekt në terren për ta forcuar kapacitetin e qeverive nacionale dhe lokale për adresim të nevojave të grupeve më të prekshme të popullsisë, që jetojnë në vendbanimet joformale, madje është përgatitur edhe propozim plani i veprimit për rimëkëmbje.

Përderisa morri hov kriza KOVID-19, me kërkesë të Qeverisë, OKB-ja zhvilloi një Shënim teknik për mbrojtjen ligjore dhe sociale të kategorive specifike të punonjësve, që ndikoi në hartimin e masave stimuluese. OKB-ja njashtu e përgatiti një analizë ligjore mbi rregullimin dhe zbatimin e punës na distanca (tele-puna) dhe i pajisi KES-të me udhëzime për zbatimin e Marrëveshjes kornizë evropiane për tele-punë. Shërbimet e partnerëve socialë u përmirësuan më tej, përmes mbështetjes së dhjetë projekte nga ana e OKB-së për përfshirjen e shërbimeve të reja dhe modernizimin e shërbimeve ekzistuese, pakot gjithëpërfshirëse të trajnimit për Fillimin dhe përmirësimin e biznesit tuaj. Për më tepër, OKB-ja i lokalizoi dhe përzgjodhi nëntë KES lokale, ku do të zhvillohen planet lokale të veprimit për punësimin në 2021.

OKB-ja gjithashtu e rriti dukshmërinë e partnerëve socialë gjatë periudhës së krizës, duke filluar fushatën për të drejtat e punëtorëve dhe duke zhvilluar strategji komunikimi për katër sindikatat.

Në kontekstin e promovimit të lidhjes tregtare rajonale, autoritetet nacionale përfituan nga ndërtimi i kapaciteteve në mekanizëm të vetëm dhe ndarja e të dhënave për Ballkanin Perëndimor, si dhe nga Mekanizmi Nacional i Monitorimit të Lehtësimit të Tregtisë dhe Transportit.

*% e rekomandimeve/opinionëve mbi reformat ekonomike dhe sociale të diskutuara në Këshillin Ekonomik dhe Social të OKB-së*

<b>60%</b>	<b>pika fillestare</b>
<b>80%</b>	<b>të synuara</b>
<b>100%</b>	<b>të arritura</b>

**(1.5) Politikat nacionale e përkrahin sipërmarrësinë, mjedisin pozitiv të biznesit, rritjen e qëndrueshme të sektorit privat dhe përdorimin produktiv dhe transferin e remitancave me kosto të ulët**


Agjencitë e OKB-së ofruan një kontribut të konsiderueshëm të politikave për përmirësim të mjedisit të biznesit, veçanërisht në fushën e sipërmarrjes dhe NVM-ve. Kjo përfshin propozimin e politikave për kulturën sipërmarrëse - shërbimin fillestar dhe mbështetjen e ndërmarrjes që i identifikon sfidat, politikat dhe

strategjitë në lidhje me aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerësimin e tregut të ekosistemit të ndërmarrësisë në Maqedoninë e Veriut dhe analizën e pengesave për qasje në Financat për NVMM-të. Për më tepër, vlerësimet e mbështetura nga OKB-ja për ekonominë rrethore demonstuan që zbatimi i praktikave qarkore në rrjedhat e zgjedhura të mbeturinave deri në vitin 2030 mund të sjellë: 951 Gg CO<sub>2</sub>-eq / kursime në vit, 2,740 vende të reja të punës dhe 47.17 milion € përfitime ekonomike.

Në kontekstin e krizës KOVID-19, OKB-ja ofroi vlerësimin e ndikimit socio-ekonomik dhe panelin e vlerësimit të nevojave me njohuri kritike dhe të vazhdueshme për politikëbërësit, me njohuri dhe udhëzime më të thella për rimëkëmbjen në bujqësi dhe industrinë e tekstit.

Për më tepër, gjatë krizës, OKB-ja i ndihmoi bizneset të mbijetojnë dhe t'i mbajnë punëtorët duke siguruar shërbime onlajn për të papunët dhe punëdhënësit përmes Qendrave të Punësimit dhe duke krijuar një Platformë aksioni për NVM-të ([bizz4all.mk](http://bizz4all.mk)) e cila është e integruar, e mbështetur me shitore onlajn me një pikë që lehtëson një qasje më të barabartë në shërbime dhe i ndihmon kompanitë t'i tejkalojnë sfidat e shkaktuara nga pandemia. Karakteristikat e saja përfshijnë ueb

Platforma e veprimit për NVM ([bizz4all.mk](http://bizz4all.mk)) Foto©UNDP



faqe falas, shumëgjuhëshe, e lehtë për përdorim në internet dhe në celular, që iu lejojnë përdoruesve të gjejnë këshilla dhe ide të thjeshta dhe të dobishme të biznesit përmes pamjeve të gjalla dhe të animuara, informacioneve të azhuruara për mekanizmat financiarë të disponueshëm, trajnimit dhe shërbimeve për këshillim falas dhe bashkëpunim në internet.

## REZULTATI 2

## Qeverisje më përgjegjëse

*Deri në vitin 2020, institucionet nacionale dhe lokale do të jenë më të afta, që në një mënyrë transparente të hartojnë dhe ofrojnë shërbime me cilësi të lartë për të gjithë përdoruesit, edhe atë me kosto efektive, jodiskriminuese dhe të ndjeshme ndaj gjinisë.*

## Kontributi në:



Qeverisja demokratike dhe e përgjegjshme  
Reformat në administratën publike, policinë dhe sektorin e drejtësisë  
Lufta kundër korrupsionit



Pikësëpari elementet bazë: Kriteret politike dhe Sundimi i ligjit  
23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore  
24: Drejtësia, liria dhe siguria  
19: Politika sociale dhe punësimi

Agjencitë e OKB-së që kontribuojnë në përbushjen e këtyre rezultateve:  
IOM, OHCHR, UNDP, UNECE, UNESCO, UNFPA, UNODC, UNOPS, UN Women

Qeveria dhe partnerët tjerë zhvillimorë:

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Sekretariati për Çështjet Evropiane, Enti Shtetëror i Statistikës, shoqëria civile, sektori privat, bota akademike dhe të tjerët.

## (2.1) Institucionet e qeverisje lokale të fuqizuara për të ofruar shërbime efikase dhe të drejta

Kapacitetet e përmirësuara të qeverisjes lokale rezultuan në shërbime publike efikase dhe me kosto efektive dhe një kënaqësi të shtuar të qytetarëve, veçanërisht në sektorin e mbrojtjes sociale. Një trend pozitiv në mundësimin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje përmes forumeve u vërejt në 70 nga gjithsej 81 komunat. Konsideratat gjinore dhe të rinjtë janë integruar në politikat kryesore të zhvillimit, vendimet dhe buxhetet në nivelin nacional, rajonal dhe lokal. Nismat e shumëfishta, përfshirë harmonizimin e procedurave rreth migracionit me ligjin e BE-së, kapacitetet e forcuar dhe aftësitë e ndërmjetësimit kulturor të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve sociale, rinovimi i spitaleve dhe mjediseve të akomodimit kontribuuan në shërbime dhe siguri më të mirë për migrantët dhe azilërkuesit.

Zgjidhjet digjitale, përfshirë pagesën elektronike të taksave, platformën e-mësimit të arritshme për të gjithë 1,347 këshilltarët komunalë në vend, dhe mjetet tjera siguruan vazhdimin e proceseve komunale të biznesit dhe ofrimin e shërbimeve gjatë pandemisë. Aplikacioni celular "Be Safe" (bëhu i/e sigurt)

*Komuna e Novacit është pjesë e programit të UN Women për promovimin e politikave dhe buxheteve të përgjegjshme gjinore: drejt qeverisje transparente, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, financuar nga Agjencia Zvicrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Ndërkombëtar Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA). Foto © UN Women*



siguron raportimin dhe ngritjen e vetëdijes për dhunën në familje (DhF) dhe dhunën me bazë gjinore (DhBGj).

## (2.2) Grupet e shoqërisë civile, individët dhe të rinjtë marrin pjesë drejtpërsëdrejti në proceset e marrjes së vendimeve dhe në mënyrë më aktive i monitorojnë institucionet nacionale dhe lokale

Mbështetja e OKB nga konsultimet e gjera dhe gjithëpërfshirëse midis qeverisë, shoqërisë civile dhe të rinjve rezultoi në politika, programe dhe vendime të përqendruara te njerëzit dhe të ndjeshëm ndaj të rinjve në të gjitha nivelet. Sondazhi i ndikimit të KOVID-19 te të rinjtë, veçanërisht te ata të lënë pas, përfshiu një seri konsultimesh me kolegët për çështje që ndikojnë në jetën e tyre. U promovua një koncept gjithëpërfshirës i edukimit seksual, së bashku me një platformë digjitale për arsimin e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht fëmijëve me çrregullim të spektrit të autizimit. Dy fushata të mediave sociale për konceptin e edukimit seksual, të drejtat e shëndetit riprodhues seksual (DShRS) dhe dhunës së bazuar në gjini (DhBGj) depërtuan te shumë të rinj në të gjithë vendin. Për më tepër, janë rritur kapacitetet e shoqërisë civile në financimin dhe menaxhimin transparent të bazuar në projekte, duke përfshirë projekte të shpejta të lidhura me pandeminë, që përfshijnë perspektivën gjinore dhe përfaqësimin e drejtë të grave tradicionalisht të nënpërfaqësuar në qeverisjen lokale.

## (2.3) Institucionet nacionale dhe lokale i kanë përmirësuar kapacitetet për zbatim të parimeve të sundimit të ligjit, llogaridhënies dhe transparencës në ofrimin e shërbimeve publike

OKB-ja vazhdimisht e ka mbështetur respektimin e parimeve të sundimit të ligjit nga institucionet e saja partnere, duke promovuar transparencën, përfshirjen dhe llogaridhënien e tyre. Hartuesit e politikave ishin të pajisur me të dhëna për të marrë vendim të duhur mbi përparësitë strategjike, ofrimin e shërbimeve të barabarta dhe menaxhimin e financave publike. Një numri të konsiderueshëm të komunave u është mundësuar që t'i publikojnë rregullisht të dhënat financiare, të bëjnë transmetim të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të këshillit të komunës, ta zbatojnë sistemin e integritetit, ta kryejnë rolin legjislativ dhe



mbikëqyrës dhe të kryejnë konsultime me palët e interesuara. OKB-ja ofroi mbështetje teknike në zhvillimin e një Programi të ri të zhvillimit të qëndrueshëm lokal dhe decentralizimit. Agjenda e Maqedonisë së Veriut drejt BE-së është konsoliduar me 60 pjesë të legjislacionit të harmonizuar me BE-në në fushat e reformës në drejtësi, energji, bujqësi, mjedis jetësor, tregti dhe arsim, si dhe kapacitetet e rritura të 600 nëpunësve civilë (mbi gjysma e tyre gra) dhe një portal publikisht i qasshëm i Planit nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së (PNML). Gjithashtu janë rritur aftësitë dhe njohuritë e gazetarëve për raportim në lidhje me zgjerimin e BE-së. Në sektorin e sigurisë, janë prezantuar mjetet digjitale për politikën e bazuar në prova në lidhje me të dhënat e armëve të zjarrit, kurse përdoruesit përfundimtarë janë trajnuar për funksionimin e duhur të sistemit.

OKB-ja i mbështeti disa iniciativa rajonale, që e promovojnë shtetin e së drejtës dhe qeverisjen e mirë përmes masave të synuara të kontrollit kufitar në porte dhe aeroporte që synojnë t'i trajtojnë të gjitha format e trafikimit të paligjshëm. Bazuar në kornizën e zgjeruar ligjore dhe institucionale, në vitin 2021 u nënshkrua një Marrëveshje me Qeverinë për krijimin e një grupi ndër-agjencie të përbërë nga një Njësi e Kontrollit të Transportit Ajror dhe një Task Forcë e përbashkët e aeroportit për ndërhyrje në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit. OKB-ja gjithashtu ndërtoi kapacitete dhe platforma rajonale që e përforcuan reagimin e autoriteteve të drejtësisë penale dhe bashkëpunimin kundër korrupsionit, flukseve të paligjshme financiare dhe trafikimit të armëve.

## REZULTATI 3

## Jetë më të mirë për personat vulnerabil

*Deri në vitin 2020 më shumë anëtarë grupeve të përjashtuara sociale dhe vulnerable janë fuqizuar për t'i ushtruar të drejtat e tyre dhe për të pasur cilësi më të mirë të jetës dhe qasjes së barabartë në shërbimet themelore.*

## Kontributi në:



Një shoqëri për të gjithë  
Reformat në sistemin arsimor dhe investimet në inovacion  
dhe teknologji informatike  
Shërbime sociale cilësore për të gjithë



18 (statistika)  
19 (politika sociale dhe punësimi)  
25 (shkenca dhe hulumtimi)  
26 (arsimi dhe kultura)

Agjencitë e OKB-së që kontribuojnë në përmbylljen e këtyre rezultateve:  
IOM, OHCHR, UNDP, UNFPA, UNHCR, UNICEF, UNODC, UNOPS, UN Women, OBSH

Qeveria dhe partnerët tjerë zhvillimorë:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, shoqëria civile, sektori privat, bota akademike dhe të tjerët.

### (3.1) Të dhënat e marra nga politikat e bazuara në të dhëna dhe programet që i synojnë grupet vulnerable të përjashtuara sociale

2020 shënon përfundimin me sukses të raundit të gjashtë të Hulumtimit klaster me më shumë indikatorë (MICS6) dhe azhurnimin e TransMonEE. Me mbështetjen e OKB-së, Enti Shtetëror i Statistikave e zhvilloi me sukses sondazhin, i cili gjeneroi një sasi masive të të dhënave të ndara në zonat, të cilat janë kryesore për mirëqenien e fëmijëve. Përkundër shpërndarjes së kufizuar, të dhënat e MICS6 tashmë kanë shërbyer për t'i adresuar boshllëqet e të dhënave duke përfshirë por jo duke u kufizuar në shëndetin dhe imunizimin e fëmijëve, arsimin parashkollor dhe mbrojtjen e tyre.

Si pjesë e vlerësimit të shpejtë të efekteve të pandemisë ndaj kategorive vulnerable, u realizua studimi mbi efektet sociale dhe ekonomike të pandemisë ndaj fëmijëve, për ta shqyrtuar ndikimin nacional në sektorët e lidhur me fëmijët - mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve, arsimin dhe shëndetin - u vlerësua ndikimi i financave publike, si dhe kapaciteti i qeverisë për t'u përgjigjur. Studimi theksoi qartë se më të rrezikuarit u goditen më rëndë, me 16,000 fëmijë shtesë që rrezikojnë të bien nën pragun e varfërisë [e vizualizuar]. Së bashku me partnerët, OKB-ja i përdori gjetjet për ta mbrojtur: përshtatjen e arsimit me kushtet e reja; shënjestrimin më të mirë të fëmijëve më të rrezikuar; ruajtjen e fëmijëve dhe grave nga dhuna, shfrytëzimin dhe abuzimin; minimizimin e ndërprerjeve të kujdesit shëndetësor rutinor dhe rritjen e besimit të publikut dhe të kërkesave për shërbime, duke përfshirë mbështetjen për shëndetin mendor.

*Një nga shumë fytyrat e qeshura që e bëri mbledhjen e të dhënave për Hulumtimit klaster me më shumë indikatorë (MICS) një përvojë shpërblyese. Raporti i Gjetjeve të Sondazhit u finalizua dhe u botua në maj të vitit 2020. Foto©UNICEF*



### (3.2) Më shumë persona të përjashtuar nga shoqëria marrin pjesë drejtpërdrejt në hartimin dhe realizimin e shërbimeve sociale

Qasja e pjesëmarrjes nga poshtë-lart të shërbimeve bëhet praktikë e rregullt në punën e OKB-së. Shumica e aktiviteteve janë shpërndarë në rezultate tjera, dhe vetëm ca prej tyre do të theksohen këtu.

Përmes programit të fuqizimit ekonomik të grave, OKB-ja e mbështeti Qeverinë për të hartuar tre shërbime të reja sociale, të cilat ishin planifikuar me reformën më të fundit shoqërore, por nuk ishin të disponueshme për qytetarët: 1) Shërbimet e pushimit (anëtarëve të familjes që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara iu ofrohen deri në 48 orë zëvendësim i vazhdueshëm); 2) Ndihma për Familjen (mbështetje në shtëpi për prindërit që kujdesen për të moshuarit gjatë 2-3 ditëve në javë), dhe 3) Kujdes për sëmundjen afatgjatë (mbështetje në shtëpi për anëtarët e familjes që kujdesen për persona të sëmurë, nga ekipet e punonjësve shëndetësorë dhe sociale). Zbatimi i tyre do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e kujdesit dhe do të forcojë rolin e grave në familjet, në të cilat ofrohet kujdes për personat në nevojë.

Sondazhimbarëkombëtar për t'i vlerësuar nevojat për zyrtarizimin e shërbimit të papaguar shoqëror dhe të kujdesit shëndetësor shoqëror/shëndetësor e përpiloi grupin e rekomandimeve të politikave për politikat fleksibile të punës në vendin e punës dhe i vuri në dukje hapat e ardhshëm për formalizimin e shërbimeve të kujdesit dhe promovimin e ekonomisë së kujdesit. Si rezultat i kësaj, janë hartuar dy masa të reja punësimi (që synojnë zhvillimin e një rrjeti kujdestarësh të aftë dhe të kualifikuar dhe individësh profesionistë) që u bënë pjesë e Planit Nacional Operativ të Punësimit 2021. Mjedisi për pilotimin e masave u mundësua me krijimin e 3 qendrave të pushimit dhe aftësimin e 80 personave në ofrimin e shërbimeve të kujdesit. Këto masa do t'u mundësojnë grave (67.5% të siguroesve të kujdesit) që të fitojnë njohje zyrtare të punës së tyre.

Përmes shërbimeve të integruara shëndetësore dhe shoqërore të bazuara në komunitet (brenda aktiviteteve kundër COVID-19), 4,121 persona (2,735 gra) nga Komunitat e Koçanit dhe Resnjës morën shërbime të ndryshme mbështetëse. Paket e furnizimit me ushqim dhe higjienë iu siguruan 110 familjeve me të ardhura të ulëta me vulnerabilitet, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara në komunitetet lokale.

### (3.3) Më shumë fëmijë i realizojnë të drejtat e tyre dhe gëzojnë standarde më të mira jetësore dhe mundësi në pajtim me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

Arsimi ka vazhduar në kohë për pothuajse të gjithë 300,000 nxënësit në Maqedoninë e Veriut pas mbylljes së shkollave në mbarë vendin. Duke e rivendosur platformën për Zhvillim të hershëm të fëmijëve (ZHHF) që është në zhvillim, për të mbledhur burime dhe për të mbledhur dhe shpërndarë video mësimore, OKB-ja e mbështeti një platformë nacionale të mësimin në distancë (Eduino), që e riktheu në mënyrë efektive arsimin e vazhdueshëm me cilësi për të gjithë 300,000 nxënësit në Maqedoninë e Veriut. Në më pak se një vit, Eduino u rrit në platformën e vetme me materiale edukative digjitale të verifikuara për fëmijë nga 3 deri në 18 vjeç, në pesë gjuhë mësimore. Këto materiale ndahen nga mësuesit gjatë orëve në internet, dhe prindërit në shtëpi, si dhe transmetohen çdo ditë në stacionin televiziv kombëtar. Eduino vazhdon të rritet, dhe tani ofron mbi 3000 video mësimore, 500 lojëra edukative për përdorim në shkollë dhe në shtëpi, dhe mbi 100 uebinare dhe burime për mësuesit dhe prindërit. Deri në dhjetor të vitit 2020, mbi 50 për qind e të gjithë mësuesve në vend përfituan nga këto mundësi mësimi profesional [vizualizim]. Përvoja institucionale e fituar në platformën Eduino, së bashku me burimet dhe kompetencat e zhvilluara, krijon një sistem mësimi në distancë në pronësi dhe të menaxhuar nga qeveria, i cili vazhdon të rritet në gjerësi dhe cilësi, duke i shërbyer gjithë sektorit të arsimit.


Ndihma e vazhdueshme teknike, avokimi dhe bashkëpunimi me partnerët rezultoi në një angazhim nga Qeveria për ta rritur shkallën e ulët të regjistrimit të fëmijëve të moshës 3 deri në 6 vjeç duke investuar në kopshte të reja dhe duke rivendosur ndërtesat ekzistuese publike për qendrat e arsimit në fëmijëri të hershme me një hua nga Banka Botërore. Ky angazhim gjithashtu vendosi qëllime të qarta deri në vitin 2024 për përmirësim në pajisje dhe ambiente. OKB-ja e mbështeti MPPS-në në krijimin e një kornizë të kompetencave si bazë për ndërtimin e një sistemi për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe avancimin e karrierës. Përmes programit gjithëpërfshirës të të mësuarit shoqëror dhe emocional, OKB-ja siguroi që mësuesit të marrin mbështetje të rregullt nga kolegët dhe qasje në mundësi kuptimplota të të mësuarit me krijimin e komuniteteve profesionale të të mësuarit.

Paralelisht me këtë, "Fushata Mësuesi ka rëndësi" ka arritur rezultate të rëndësishme duke depërtuar deri te rreth 75 për qind të popullsisë së përgjithshme përmes fushatës televizive. Rezultate të ngjashme janë arritur në kanalet digjitale, ku ka pasur qasje deri në afro 1 milion, duke ka angazhuar rreth 45,000 njerëz dhe rreth 250,000 video shikime në kanalet e mediave sociale të UNICEF.

Për t'i mbështetur reformat arsimore dhe rezultatet e përmirësuar të mësimin të nxënësve, OKB-ja e ndihmoi Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në identifikimin e boshllëqeve kryesore të sistemit për rezultatet e ulëta të të nxënësve. Kjo nxiti një dialog politik për reformën aq të nevojshme të sistemit arsimor. Duke filluar me një rishikim të Planit të veprimit të Strategjisë Nacionale të Arsimit 2018-2025, procesi i reformës vazhdoi me shumë politika kryesore të arsimit, siç ishte Ligji për arsimin fillor dhe Ligji për arsimtarët dhe personelin mbështetës dhe standardet kombëtare për arsimin fillor, të cilët e përcaktojnë fazën për reformimin e kurrikulës së arsimit fillor. Si rezultat i kësaj, siç është matur nga Programi i OECD për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) nga 2015 deri në 2018, përqindja e suksesit të ulët në secilin lëndë (lexim, matematikë dhe shkencë) është tkurrur për të paktën nëntë pikë përqindje. Vendi e regjistroi përmirësimin e vetëm më të lartë në suksesin

*UNICEF-i dhe partnerët kanë shënuar një vit nga themelimi i Eduino - ueb portalit për arsimim digjital, koordinim dhe zhvillim profesional i lançar në Mars 2020 për ofrimin e resurseve digjitale arsimore dhe mundësimin e mësimin për fëmijët në kushte të pandemisë.*

Foto©UNICEF



e leximit, vendin e dytë të përmirësimit në shkencë dhe të tretë në matematikë.

Për ta adresuar çështjen e dhunës ndaj fëmijëve, raportimin e pamjaftueshëm nga profesionistët e shëndetit dhe për të vepruar sipas të gjitha dyshimeve ose shqetësimeve, janë zhvilluar module korresponduese dhe janë trajnuar 10 trajnerë kryesorë për njohjen, parandalimin, raportimin dhe menaxhimin e dhunës kundër fëmijëve për vështirësi në funksionim. Trajnimi është plotësuar me shqyrtimin e pilotimit të përvojave të pafavorshme të fëmijërisë në 10 praktika të vështirësive në funksionim, me qëllim që të hulumtohen më tej rastet e mosfunksionimit të familjes, abuzimit fizik, emocional ose seksual dhe neglizhimit nga kujdestarët, dhuna e bashkëmoshatarëve ose e komunitetit si dhe parandalimi ose zbutja e shfaqjes së saj, duke menaxhuar rastet në një raport të mirëfilltë me traumën. Mbështetja dhe asistencat teknike të UNICEF-it ka qenë një hap më tej drejt zotimit të qeverisë për t'u bashkuar me Partneritetin Global për t'i dhënë fund Dhunës ndaj Fëmijëve dhe për miratimin e një Strategjie Nacionale (2020 - 2025) për t'i dhënë fund Dhunës ndaj Fëmijëve, me çka e ka trasuar rrugën drejt përparimit të mëtejshëm në këtë fushë. Gjenerimi i dëshmime të mbështetur nga UNICEF-i i ka formësuar veprimet e mëtejshme që kanë rezultuar në zhvillimin e kapacitetit për përmirësimin e identifikimit, referimit, raportimit dhe përgjigjes në rastet e dhunës ndaj fëmijëve. Boshllëqet e furnizimit janë adresuar pas krijimit të një pune ekipore shumë-sektoriale, në menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve. UNICEF-i gjithashtu e ka forcuar kapacitetin monitorues të Organit Nacional për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Neglizhenca.

Përmes linjave telefonike të ndihmës, 132 prindër, 35 prindër të fëmijëve me nevoja të posaçme dhe 12 fëmijë dhe adoleshentë kanë marrë mbështetje psikosociale, ndërsa rreth 700 kanë marrë pjesë në seanca në internet, ku është arritur shikueshmëri prej 110 000 të videove me fokus në temat e shëndetit mendor.

### (3.4) Më shumë persona me nevoja të posaçme mund t'i realizojnë të drejtat e tyre dhe t'i gëzojnë standardet jetësore në përputhje me Konventën e OKB-së mbi të drejtat e personave me nevoja të posaçme

Që nga miratimi i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KPAK) dhe Protokolli Opsional të saj përkatës në 2011, OKB e mbështeti Qeverinë për të filluar një sërë masash

*Përmes linjave telefonike të ndihmës, 132 prindër, 35 prindër të fëmijëve me nevoja të posaçme dhe 12 fëmijë dhe adoleshentë kanë marrë mbështetje psikosociale, ndërsa rreth 700 kanë marrë pjesë në seanca në internet, ku është arritur numri prej 110 000 shikimeve të videove me fokus në temat e shëndetit mendor.*



**ОТВОРЕНИ ЛИНИИ**  
ЗА ПРАШАЊА, ОДГОВОРИ И СОВЕТИ ЗА СЕГАШНАТА СОСТОЈБА

që synojnë përbushjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Për të ndihmuar në zhvendosje të paradigmes në përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara drejt një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut, u zhvillua dhe u pilotua modeli i ri i vlerësimit të aftësisë së kufizuar, të bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksionimit (KNF), Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (KNF). Ky ishte një hap i rëndësishëm për t'u larguar nga qasja e mëparshme për të vendosur nëse do t'u jepeshin përfitime në para njerëzve me aftësi të kufizuara, bazuar vetëm në kategorizimin e gjendjes së tyre mjekësore. Në fund të vitit 2020, u krijuan tre qendra (një nacionale dhe dy rajonale) për vlerësimin e fëmijëve bazuar në KNF, ndërsa vlerësimi funksional është përfshirë në Ligjin për arsimin fillor. Shërbimet e kufizuara në dispozicion për zbulimin dhe ndërhyrjen e hershme, në një kontekst të modelit mjekësor të përdorur gjerësisht për vlerësim, u adresuan nga zhvillimi i kapaciteteve të profesionistëve shëndetësorë (mjekët familjar dhe infermierët që realizojnë vizita në shtëpi), të plotësuara me pilotimin e Listës së modifikuar të kontrollit për autizmin të fëmijët e vegjël (M-Chat) dhe Klasifikimi ndërkombëtar i funksionalitetit (KNF) në 1% të praktikave të vështirësive në funksionalitet, duke e zgjeruar më tej veprimin dhe adresuar çështjen e referimeve të panevojshme në nivele më të larta të kujdesit shëndetësor, duke kursyer mjete dhe barrë të panevojshme për prindërit dhe sistemin shëndetësor. KNF-ja është përfshirë në kurrikulat universitare për studentët e mjekësisë dhe pediatriisë dhe specializimin e mjekësisë sociale, me qëllim të sensibilizimit të profesionistëve të ardhshëm mjekësorë në aspektet sociale të aftësisë së kufizuar, përtej modelit mjekësor.

Për ta adresuar çështjen e dhunës ndaj fëmijëve, mosraportimin e duhur nga profesionistët e shëndetit dhe për veprim sipas të gjitha dyshimeve ose shqetësimeve, janë zhvilluar module korresponduese dhe 10 trajnerë kryesor të trajnuar për njohjen, parandalimin, raportimin dhe menaxhimin e dhunës ndaj fëmijëve për vështirësi në funksionim. Trajnimi u plotësua me shqyrtimin pilot të përvojave të pafavorshme të fëmijërisë (PPF) në 10 praktika të vështirësi në funksionim, për ta eksploruar më tej ekzistencën e mosfunksionimit të familjes, abuzimin fizik, emocional ose seksual dhe neglizhimin nga kujdestarët, dhunën e bashkëmohatarëve ose të komunitetit dhe parandalimin ose zbutjen e shfaqjes së saj duke i menaxhuar rastet në mënyrë të duhur për ta lehtësuar traumën.

### Programi i përbashkët Puna nga poshtë lart – ndërtimi i modelit lokal të deinstitutionalizimit

Ky program i përbashkët, i zbatuar mes qershorit të vitit 2018 dhe dhjetorit të vitit 2020, u përqendrua në pilotimin e modeleve për shërbime dhe deinstitutionalizim të lehtë, me një fokus specifik gjeografik për banorët e institucionit të Banja BANSKO në rajonin e Strumicës. Puna e agjencive pjesëmarrëse të OKB-së - Fondi i OKB-së për Fëmijëve (UNICEF), UNDP, UN Women dhe UNFPA - dhe një kontribut të rëndësishëm në mbështetjen e zbatimit të agjendës nacionale të deinstitutionalizimit përmes përpjekjeve shumë-sektoriale. Duke ndërtuar një model të nivelit të komunitetit, ekipi i OKB-së demonstroi se si të ndërtohen ura për punësim të personave me aftësi të kufizuara; për sigurim të arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara; forcim të modeleve të kujdesit shoqëror dhe familjar alternativ, të bazuar në komunitet; dhe ofrim të shërbimeve të shëndetit seksual dhe riprodhues për gratë me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrja e plotë e personave me aftësi të kufizuara gjatë gjithë procesit të projektit ndihmoi në identifikimin e ngushticave dhe fuqizimin e individëve për të luajtur një rol aktiv. Shprehur në numra: 11 gra dhe burra tani jetojnë të pavarur në komunitet; 5 persona janë punësuar; 7 fëmijë janë transferuar në forma alternative të kujdesit. Përmes këtij veprimi, ekipi i OKB-së vërtetoi se opsionet e bazuara në komunitet janë një mënyrë e mundshme dhe e përbalueshme për ta lehtësuar jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara dhe modelet e zhvilluara të shërbimeve për replikim më të gjerë. Ky program u financua nga Fondi i mirëbesimit të më shumë donatorëve (MPTF) i partneritetit të OKB-së për t'i promovuar të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UN-PRPD); kontribuuesit e tanishëm kryesorë të saj përfshijnë Australinë, Finlandën, Norvegjinë, Suedinë dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Sigurimi i qasjes së plotë për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme dhe fëmijët e moshës parashkollore arriti një pikë kthese. Pas viteve të avokimit dhe modelimit të arsimit gjithëpërfshirës në shkollat fillore në vend, në vitin 2019 Ministria e Arsimit dhe Shkencës e rregulloi ligjërisht mbylljen e shkollave speciale fillore dhe fillimin e procesit të transformimit në qendrat e burimeve duke siguruar që të gjithë fëmijët të pranohen dhe mbështeten në një mjedis gjithëpërfshirës në arsimin e zakonshëm. Përmes programit të punës në komunitet, gjithsej 703 persona me aftësi të kufizuara nga të cilët pothuajse 400 fëmijë me aftësi të kufizuara morën shërbime të ndryshme sociale. 323 asistentë personalë dhe arsimorë u angazhuan për t'i mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara në kryerjen e detyrave të tyre mësimore në shkollat fillore dhe të mesme.

Ky moment historik u përsërit me sukses edhe në edukimin parashkollor. OKB-ja e ka mbështetur modelimin e konceptit dhe praktikave të arsimit gjithëpërfshirës në 30 shkolla fillore. Ky proces çoi në zhvillimin profesional të 2200 arsimtarëve të trajnuar në vend dhe 4500 të trajnuar me një kurs onlajn, dhe krijimin e një shërbimi të ri mbështetës në shkolla - ndihmë arsimore dhe personale. Për më tepër, përmes pilotimit të 25 kopshteve gjithëpërfshirëse ku u forcuan kapacitetet për të punuar me fëmijë me aftësi të kufizuara, OKB-ja krijoi ekupe gjithëpërfshirëse si mekanizma thelbësorë për praktikatat gjithëpërfshirëse të edukimit në fëmijëri të hershme (EFH) në të gjitha kopshtet anekënd vendit.

Këto përpjekje e kanë arritur kulmin me ndryshimin legjislativ, i cili i shfuqizoi grupet speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara në EFH si një praktikë dhe një rritje të përgjithshme të pranimit të përgjithshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme nga 4 për qind në 2014 në 24 për qind në 2018.

Në vitin 2020 janë hapur dy Qendrat e para për rehabilitimin dhe mbështetjen e orientuar drejt punës për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në Strumicë dhe Shkup dhe janë krijuar modele përkatëse. Qendrat kryen vlerësime funksionale të 50 personave, përfshirë 24 kandidatë për vetëpunësim, që rezultoi me krijimin e 20 ndërmarrjeve të vogla nga personat me aftësi të kufizuara.

Për ta mbrojtur shëndetin mendor të personave me aftësi të kufizuara gjatë kufizimit të lëvizjes si rezultat i COVID-19, Qendra në Strumica siguroi mbështetje psiko-sociale për 67 persona me aftësi të kufizuara, të akomoduar në institucionin e Banja Banske dhe 11 persona të zhvendosur në jetën e bazuar në komunitet. Për të mbështetur MPPS-në me planifikimin e ardhshëm, u përgatit një "Analizë e Kostos-Përfitimit lidhur me Koston Shtesë për Aftësi të Kufizuara", duke përfshirë edhe doracakët dhe mjetet tjera.

### (3.5) Më shumë anëtarë të komunitetit rom janë në gjendje t'i realizojnë të drejtat e tyre, të gëzojnë standarde dhe mundësi të përmirësuara jetësore, si dhe ta tejkalojnë përjashtimin social

Në vitin 2020, OKB-ja e mbështeti krijimin e ekipeve mobile të punonjësve socialë, që synojnë t'i identifikojnë dhe ndihmojnë fëmijët në rrugë, duke rezultuar me identifikimin e 362 fëmijëve të rrugës (38% vajza), 354 prej tyre (98%) që i përkasin komunitetit rom, ndërsa pjesa tjetër 2% janë fëmijë etnikë-shqiptarë dhe etnikë-maqedonas. Te 76% e përfituesve të asistuar është zvogëluar vulnerabiliteti dhe rreziku i dhunës, shfrytëzimit dhe abuzimit për shkak të qasjes së tyre në institucionet përkatëse dhe programet e mbrojtjes dhe riintegritit të ofruara nga shteti.

Me mbështetjen e OKB-së, Komuna e Shuto Orizarit dhe MPPS-ja e kanë përfunduar fazën e parë dhe e kanë nisur fazën e dytë të ndërtimit të kopshtit vetëm në këtë komunë. Me fazën e dytë, 136 fëmijë tjerë (ose gjithsej 306 fëmijë) duhet të kenë qasje në edukimin parashkollor, përfshirë edhe kujdesin për 70 fëmijë midis 9 dhe 24 muajsh. Ky shërbim që sapo është vënë në dispozicion, do t'ju mundësojë prindërve romë të kërkojnë punë. Përveç rasteve të rregullimit të edukimit parashkollor, kopshti do të sigurojë hapësirë falas për 100 fëmijë në rrugë, për t'u përfshirë në kujdesin dhe shërbimet për integrimin e tyre në aktivitetet e rregullta parashkollore dhe shkollore.

Përmes aktivizimit dhe shërbimeve mbështetëse nga mentorët e punësimit të romëve dhe programit ACCEDER (qasja holistike që punon në nivel individual, por edhe me familje tejkallim të pengesave kulturore), mbi 2,014 romë kanë pranuar shërbime për punësim. 216 romë morën pjesë në masa të ndryshme aktive të punësimit. Si rezultat i kësaj u krijuan 107 vende pune me orar të plotë.

Përmes Programit për punë në komunitet 613 persona të papunë, nga të cilët 71 ishin romë, fituan përvojë të vlefshme pune, ndërsa shërbime sociale u ofruan për 8,990 përfitues të fundit nga 52 komuna. Ndër përfituesit përfundimtarë që marrin shërbime të drejtpërdrejta sociale, rreth 350 ishin nga komuniteti rom.

### (3.6) Institucionet i kanë përmirësuar kapacitetet për zhvillim dhe implementim të politikave gjithëpërfshirëse, të bazuara në dëshmi, të cilat i kanë zvogëluar pabarazitë dhe përjashtimin social, gjegjësisht e kanë mbështetur zhvillimin pozitiv të fëmijëve

OKB-ja e ka mbështetur reformën e sapo filluar për mbrojtje sociale përmes përfshirjes së shërbimeve të reja të mbështetjes sociale dhe të kujdesit për familjet në rrezik në të gjithë

vendin. Shërbimet e ofruara nga Qendrat për Punë Sociale u përmirësuan me prezantimin e menaxhimit të rasteve që lejon punonjësit socialë të fitojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të nevojave të secilit përfitues, kuptim më të madh të përfshirjes së dobësive - përfshirë ato që vijnë nga konteksti i familjes - dhe ndërtim të besimit midis punonjësve socialë dhe përfituesve të shërbimeve. OKB-ja i ka ndërtuar kapacitetet e punonjësve socialë për ta marrë rolin e menaxherëve të lëndëve. Asistenca teknike në punën sociale, menaxhimi i lëndëve dhe njohuritë e sjelljes e arritën kulmin në zhvillimin dhe prezantimin e mjeteve të reja, moduleve të udhëzimit dhe trajnimit në punën sociale. Qendrat për Punë Sociale u forcuan më tej duke e rikualifikuar fuqinë e tyre të punës dhe duke punësuar punonjës të rinj socialë dhe personel tjetër profesional. Në vitin 2020 mbështetja vazhdoi me prezantimin e mbështetjes mentoruese për menaxherët e lëndëve, si dhe mbikëqyrjen e punës së tyre.

### (3.7) Politikat e kujdesit shëndetësor i adresojnë nevojat e grupeve vulnerabile dhe atyre të përjashtuara sociale, gjegjësisht kundërpërgjigjet më të mira të shërbimeve të kujdesit shëndetësor ndaj këtyre nevojave

It Nuk është për t'u habitur që OKB-ja i ka ofruar Qeverisë mbështetje të zgjeruar teknike, operacionale dhe politike për kontrollimin dhe zbutjen e gjendjes rreth COVID-19. Përveç mbështetjes së menjëhershme emergjente, mirëmbajtja e shërbimeve thelbësore gjatë krizës COVID-19 ishte ndër përparësitë kryesore të mbështetjes së siguruar në vitin 2020. Me mbështetjen e OKB-së dhe partnerëve të tjerë të zhvillimit, Qeveria e adaptoi shpejt intervenimin e saj për t'u marrë me reagimin e menjëhershëm ndaj COVID-19 në nivel të qendrave të shëndetit publik, përmes pilotimit të tele-konsultimeve dhe serisë së rregullimeve tjera.

Është bërë vlerësim rapid i pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) dhe nevojave për trajnim të materniteteve në lidhje me COVID-19, për t'i identifikuar nevojat prioritare të materniteteve. Kjo lejoi shpërndarjen e drejtë dhe transparente të PPM-ve të prokuruarat të OKB-së dhe furnizimeve të kontrollit infektiv.

Rekomandimet për zbulimin dhe menaxhimin e COVID gjatë shtatzënisë u zhvilluan dhe u përkthyen në gjuhët lokale për Gjinekologjitë/Akusheritë. Bazuar në këto materiale, janë organizuar seri të trajnimeve profesional në internet për Gjinekologjitë/Akusheritë përgjatë vitit 2020, me fokus në çështjet shëndetin seksual dhe reprodutiv (ShSR) në kontekstin e COVID-19. Mbështetja për personat e moshuar gjatë pandemisë

*Anëtar i ekipit mobil të Kryqit të Kuq, i mbështetur nga UNFPA-ja, duke sjellë ushqime dhe ilaçe për persona të moshuar në shtëpitë e tyre, gjatë shpërthimit të pandemisë Covid-19 - nëntor 2020, Shkup, Maqedoni e Veriut. Foto©UNFPA*



KOVID-19 u sigurua në partneritet me Kryqin e Kuq dhe OSHC-të. Aktivitetet mbi shëndetin seksual dhe riprodhues dhe dhunën me bazë gjinore u përshtatën për t'iu përgjigjur përparësive nacionale dhe Planit të Përgatitjes dhe Reagimit të Vendit ndaj KOVID-19.

Veç kësaj, mbështetja për fuqizim të mbulimit universal shëndetësor dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore ishte njësoj me rëndësi.

Aktivitetet e zbatuara në vitin 2020 rezultuan në modelin e ofrimit të kujdesit shëndetësor primar (KShP) që përqendrohet në nevojat shëndetësore të familjeve dhe komuniteteve, të prezantuar mes tjera përmes ndryshimit të paradigmes në rolin dhe përgjegjësitë e infermierëve të kujdesit primar. Deri në fund të vitit 2020, Programi i Zhvillimit Profesional për infermierët e kujdesit primar i kishte forcuar kapacitetet e më shumë se 300 infermierëve.

Janë rritur kapacitetit institucionale dhe është përmirësuar qasja nacionale për rezultatet më të mira shëndetësore të shtatzënisë dhe shëndetit të foshnjave. Një Plan i ri nacional shumëvjeçar për kujdesin para lindjes u zhvillua me mbështetjen e OKB-së, duke përfshirë planin e detajuar të zbatimit. Kjo punë lejoi një konvergencë të agjendës së partnerëve ndërkombëtarë dhe mbështetje të konsoliduar nga të gjitha palët e interesuara nacionale. Ishte një veprim aq i dobishëm dhe i rëndësishëm, sa që ishte integruar në Strategjinë nacionale të shëndetit dhe në planet e ardhshme teknike të mbështetjes së BE-së në përputhje me aderimin e vendit në mbështetjen financiare EPA III për Maqedoninë e Veriut. Mbështetja e shërbimeve të kujdesit para lindjes është bërë përmes 2 pilot aktiviteteve, që pritej të shtrihen në vitin 2021. Është bërë po ashtu përparim në futjen e sistemit të mbikëqyrjes dhe përgjigjes së akusherisë (SMPA), që synonte përmirësimin e shëndetit të nënës. Përmes punës së përbashkët të disa agjencive të OKB-së, që synojnë eliminimin e vdekjeve neonatale, për herë të parë u fillua kontrolli i vdekshmërisë para lindjes në Maqedoninë e Veriut, i cili do të bëhet një mjet thelbësor për ta formësuar politikëbërjen, planifikimin dhe monitorimin e sigurisë dhe mbrojtjes së nënave dhe foshnjave për brezat që do të vijnë. Dy dokumentet kryesore që u zhvilluan - Udhëzuesi klinik për tromboprofilaksi dhe Udhëzuesi klinik për hipertension gjatë shtatzënisë, e kanë ndihmuar Ministrinë dhe entet përkatëse të kujdesit shëndetësor në identifikimin e shkaqeve të vdekjeve të nënave dhe për hartimin e politikave të duhura, të bazuara në prova. Përpjekjet për avancimin e kapaciteteve të profesionistëve shëndetësorë në planifikimin familjar janë bërë me prezantimin e trajnimit në internet për kontracëpsionin, që do të menaxhohet nga Katedra për mjekësi familjare.

**Mbledhje e koordinatorëve shëndetësor me Ministrin e Shëndetësisë dhe drejtuesve të agjencive të OKB-së.** Foto ©OBSh



Strategjia e-shëndetësore e zhvilluar për herë të parë do të jetë një mjet i fuqishëm në duart e hartuesve të politikave shëndetësore për ofrimin efikas të shërbimeve shëndetësore, duke u bazuar në teknologjitë e reja me një shkallë të lartë të integritimit të sistemit dhe mobilitetin e shtuar të mjekut dhe pacientit. Një integrim tele-shëndetësor në sistemin nacional për regjistrin elektronik të shëndetit – Takimi im (Moj Termin) iu mundësoi mjekëve që të rezervojnë takime për pacientët e tyre në internet për telekujdes dhe kontribuon në ofrimin e shërbimeve shëndetësore më efikase, duke lejuar vazhdimësinë e kujdesit shëndetësor në situatë aktuale të lidhur me KOVID-19 dhe duke iu mundësuar pacientëve ta marrin kujdesin e nevojshëm nga shtëpia, nëse gjendja e tyre lejon ta marrin shërbimin pa u paraqitur fizikisht në klinikë.

Krijimi i një baze të të dhënave elektronike të imunizimit elektronik, e lidhur me të dhënat nacionale të e-shëndetit dhe sistemin e raportimit, lejon që të ketë një mbikëqyrje të plotë të situatës së vaksinimit në të gjithë territorin e shtetit dhe kështu të koordinohen më mirë nevojat e ardhshme për një vaksinim të gjerë KOVID-19. Pajisjet për diagnostikimin dhe mbrojtjen e pacientëve nga sëmundjet onkologjike dhe jo-onkologjike që iu dhuruan Institutit Universitar për Tomografi me Emision Pozitron (qendra PET), Klinikës Universitare të Radioterapisë dhe Onkologjisë, Institutit të Patofiziologjisë dhe Mjekësisë Bërthamore në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti "Sh. Kirili dhe Metodi", do ta shkurtojë kohën për diagnostikimin e sëmundjeve jo-ngjitëse, në veçanti, kancerin dhe sëmundjet kardiovaskulare dhe do të ndihmojë në shpëtimin e më shumë jetëve. Mbrojtja nga rrezatimi i pacientëve dhe profesionistëve shëndetësorë u sigurua përmes krijimit të një sistemi shtetëror për ndjekjen e dozës për rrezatim mjekësor duke i lidhur sistemet e skanimit në mbi 20 spitale dhe klinika.

Ka përfunduar studimi i hartës së objektit të trajtimit, i cili së bashku me Standardet Ndërkombëtare për Trajtimin e Çrregullimeve të Përdorimit të Drogës, Indikatorin e Kërkesës për Mjekim (IKM) dhe Mjeti i Sigurimit të Cilësisë së Trajtit UNODC, e formojnë pjesën e një pako themelore të sugjeruar për mjekimin, planifikimin dhe monitorimin e abuzimit të pacientëve me substanca. Numri i përgjithshëm i personave të trajtuar në 2019 duke përfshirë të gjitha shërbimet e disponueshme është 8055, megjithatë numri i personave të trajtuar vetëm duke përdorur opioid agonist është 2058. Secila shifër tregon trend pozitiv në raport me pikën fillestare.

Është prodhuar një strukturë e zgjeruar e dëshmimeve në lidhje me rritje e mbipeshës te fëmijët. Katër studime të ndërlidhura mundësuan mbylljen e boshllëqeve kritike të të dhënave dhe do të hapin rrugën për avokim të mëtejshëm dhe përgjigje multi-sektoriale. Studimi mbi mungesat e mikroelementeve ushqyese te fëmijët e moshës shkollare çoi në zhvillimin dhe miratimin e rregullores së re për t'i përcaktuar vaktet gjatë mësimin në shkollë. Studimi ekonometrik e ka llogaritur koston e përgjithshme të sëmundjeve të lidhura me mbipeshë (qoftë të drejtpërdrejta ose të tërthorta) përafërsisht 5% e BPV-së së Maqedonisë Veriore (482 milion euro ose 241 € për person/vit), duke treguar se shumë nga kjo kosto mund të shmanget duke parandaluar obezitetin që në moshë të hershme, duke edukuar publikun për rreziqet e ushqyerjes së dobët dhe përfitimet e ushtrimeve fizike. [vizualizoni] Një studim i sjelljes ka identifikuar dhe kategorizuar nëntë barrierë, që e pengojnë aftësinë, mundësinë dhe motivimin e fëmijëve për të ngrënë ushqime të shëndetshme dhe ndërhyrjet e përcaktuara për t'u testuar dhe vlerësuar.

Vlerësimi rajonal për fuqizime të fakteve në lidhje me shërbimet e vizitave në shtëpi përfundoi në nëntor të vitit 2019 me një

studim rasti të përqendruar në përvojën e vendit, që gjeneroi mësim dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshme, duke siguruar udhëzime për krijimin e një modeli të qëndrueshëm dhe shërbime të përshtatshme të komunitetit dhe të komunikimit. Aktivitete të tilla si rishikimi i procedurave standarde të funksionimit për infermierët që realizojnë vizita në shtëpi dhe digjitalizimi i formave të raportimit ishin duke u zhvilluar në vitin 2020.

### (3.8) Stigmatizimi dhe diskriminimi ndaj njerëzve të përjashtuar nga shoqëria dhe vulnerabil zvogëlohen përmes avokimit bindës dhe respektimit të standardeve të të drejtave të njeriut

Dyzet përfaqësues të qeverisë, Zyrës së Ombudsmanit, orgnariat për personat me nevoja të posaçme dhe OSHC-të e rritën të kuptuarit e tyre për kërkesat sipas KPAK-së dhe legjislaconit të ri kundër diskriminimit, në përputhje me standardin ndërkombëtar i cili, mes tjerash, e përfshin aftësinë e kufizuar si një terren specifik për diskriminim dhe mekanizëm të pavarur të ankesave. Fokusi ishte në barazinë thelbësore përballë asaj formale si parakusht për përfshirjen e aftësisë së kufizuar, fuqizimin dhe realizimin e plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke i dhënë përparësi parimit që askush të mos lihet pas dhe grupeve më të margjinalizuara.

### (3.9) Refugjatëve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare u jepet qasje në sistemin e azilit në vend, trajtohen në përputhje me regjimin ndërkombëtar të mbrojtjes dhe përmbushen nevojat e personave më vulnerabil

Në vitin 2020, OKB vazhdoi të sigurote mbështetje për migrantët tranzit, azilkërkuesit dhe refugjatët. 5,574 persona në dy qendrat e përkohshme të tranzitit në Vinojug dhe Tabanovce si dhe Qendrën e pranimit të azilkërkuesve. Personat e përfshirë përfituan nga këshillimi ligjor individual dhe/ose përfaqësimi për ta kapërcyer hendekun e mungesës së ndihmës juridike falas të shtetit. Për më tepër, OKB-ja dhe partnerët ofruan ndihmë humanitare dhe mjekësore për shpëtim të 15,690 azilkërkuesve dhe njerëzve në lëvizje përgjatë vijave kufitare.

Me mbështetjen e OKB-së, Kryqi i Kuq i Qytetit (KKQ) me përkrahjen e ekspertëve të Qendrës për Punë Sociale, ofroi shërbime të mbrojtjes sociale dhe mbështetje të integritit, duke siguruar që 6 fëmijë të kenë qasje në arsim, kurse në gjuhën maqedonase për 5 persona me mbrojtje plotësuese dhe 21 azilkërkues, 16 aktivitete rekreative dhe aktivitete të socializimit për 21 persona. Shërbimet e përkohshme ishin në dispozicion për azilkërkuesit në qendrën e pritjes, si dhe për personat në nevojë për përkujdesjen e OKB-së, që banojnë në strehim të rregulluar individualisht përmes KKQ-së.

Për t'i identifikuar më mirë nevojat thelbësore të refugjatëve dhe personave pa shtetësi, OKB-ja me partnerët e saj zhvilloi një vlerësim të shpejtë të nevojave në muajin prill. Bazuar në këtë vlerësim, OKB-ja e ndihmoi qendrën e pranimit të azilkërkuesve për t'i rritur standardet e higjienës në kontekstin

### Ndihmë ligjore falas për migrantët, azilkërkuesit dhe refugjatët drejtëpërdrejtë në qendrat e tranzitimit. Foto©UNHCR



e rekomandimeve shëndetësore COVID-19. Këto masa e zbutën efektin negativ të pandemisë midis këtyre personave përkatës, duke rezultuar gjithashtu në një numër shumë të ulët të azilkërkuesve dhe refugjatëve të infektuar dhe pa fatalitet, me të 3 azilkërkuesit që rezultuan pozitivë, të cilët u mjekuan nësoj sikurse edhe qytetarët tjerë. OKB-ja nisi dhe reklamoi në komunitet ueb faqen "Ndihmë" dhe Linjën telefonike për ndihmë 24/7 (telefon), punoi në ngritjen e ndërgjegjësimin për parandalimin e COVID-19 përgjatë pikave të rrugës së lëvizjeve të parregullta dhe vendeve të pritjes. OKB-ja siguroi kompjuterë dhe pajisje tjera teknike, për të mundësuar qasje më të mirë në informacione dhe lidhje gjatë kufizimeve të COVID-19 dhe për t'i rritur kapacitetet e qendrës për lehtësim të qasjes në arsimimin onlajn për fëmijët që kërkojnë azil.

OKB-ja ka asistuar në krijimin e hapësirës së këshillimit/intervistimit të sigurt në qendrat e pritjes Vizbeg dhe Vinojug, në mënyrë që ta përmirësojë komunikimin e dyanshëm me azilkërkuesit, si dhe të sigurojë një komunikim konfidencial dhe efektiv midis azilkërkuesve dhe partnerit që ofron ndihmës juridike.

Për t'i përmirësuar standardet e pranimit të azilkërkuesve dhe për t'i rritur kapacitetet e mbështetjes në forcat e veta, OKB-ja e mbështeti MPPS për të zhvilluar dy dokumente të rëndësishëm në 5 gjuhë: Rregullat e shtëpisë dhe Broshura e informimit për qasje në të drejta, të shpërndara për azilkërkuesit e vendosur në qendrën e pranimit në Vizbeg, si dhe siguroi pajisje teknike. Me mbështetjen e OKB-së, MPPS dhe Fakulteti Filologjik e prezantuan një platformë onlajn për mësimin e gjuhës maqedonase. Kjo do të mundësojë qasjen në klasat e gjuhës cilësore për azilkërkuesit menjëherë pas mbërritjes, pavarësisht nga vendndodhja e tyre.

OKB-ja e ka mbështetur përmirësimin e kapaciteteve njerëzore të autoriteteve që merren me azil, refugjatë dhe çështje migrimi. 77 pjesëmarrës përfituan nga një simulim i dëgjimit të azilit, të organizuar në bashkëpunim me Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, ndërsa rreth 16 zyrtarë kufitarë përfituan nga një trajnim mbi kufizimin e lirisë së lëvizjes.

## REZULTATI 4

## Mjedisi jetësor dhe reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë

*Deri në vitin 2020 individët e sektorit privat dhe institucionet e shtetit do t'i bazojnë veprimet e tyre në parimet e qëndrueshmërisë, ndërsa bashkësitë janë më rezistuese ndaj fatkeqësive dhe rreziqeve ndaj mjedisit jetësor.*

## Kontributi në:



Investimet në Zhvillimin e Qëndrueshëm: Zhvillimin Bujqësor dhe Energjinë  
Mjedisi i shëndetshëm  
Mbrojtja nga katastrofat natyrore



11: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural  
15: Energjia  
27: Mjedisi

Agjencitë OKB-së që kontribuojnë në përbushjen e tyre rezultateve në bashkëpunim me partnerët tjerë zhvillimorë:

FAO, IOM, UNDP, UNECE, UNEP, UNFPA, UNIDO, OBSH

Qeveria dhe partnerët tjerë zhvillimorë:

Kabineti i Zëvendës Kryeministrit për Çështjet Ekonomike, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Shëndetësisë, autoritetet lokale, institucionet shtetërore, shoqëria civile, sektori privat, bota akademike.

## Veprimet klimatike

Raporti i 3-të bional i Kornizës së Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) dhe Kontributet e Përmbledhura të Përcaktuara Nacionale (KPN), të përgatitura me mbështetjen e OKB-së, vendosin objektiva të rritura të zbutjes për reduktimin e emetimit të gazrave serë (GS), duke avancuar kështu zbatimin e Marrëveshjes së Parisit dhe përafrimin e vendit me Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së. Vendi është zotuar për uljen e 51% të emetimeve të GS-ve deri në vitin 2030 krahasuar me nivelet e 1990 (82% ulje në emetimet neto të GS deri në 2030 krahasuar me nivelet e 1990).

OKB-ja vazhdoi ta mbështesë fazën e heqjes së hidroklorofluorokarbureve (HCFC); s dhe pastrimi i vendeve të zgjedhura të kontaminuara me heksaklorociklohexane (HCH) për përdorim të ardhshëm industrial.

OKB vazhdoi të punojë në forcimin e kapaciteteve të vendit për veprim klimatik dhe finalizimin e një Programi të Punës Vendore për FKGj, i cili përfshiu zhvillimin e një metodologjie të re për përgatitjen e Programit të Punës Vendore të FKGj-së, vlerësimin e gatishmërisë së FKGj-së dhe nevojat e zhvillimit të kapaciteteve, hartëzimin e institucioneve të sektorit privat me rol ekzistues ose potencial për mbështetjen e investimeve në ndryshimin e klimës, ngritjen e vetëdijes dhe njohurive të palëve të interesuara nacionale në lidhje me procesin e akreditimit të

241,755 hektarë të mjedisve të mbrojtura në kuadër të menaxhimit të përmirësuar (mundësimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore)  
Foto©UNEP/Bozhinovski



FKGj dhe lehtësimin e hyrjes së drejtpërdrejtë në FKGj përmes një Thirrje të Hapur për shprehje interesi të Enteve të mundshme të qasjes së drejtpërdrejtë të FKGj-së.

Kriza KOVID-19 dhe zhvillimet politike të vitit 2020 patën ndikim negativ në veprimet klimatike pasi burimet e kufizuara iu ridrejtuat sektorëve ekonomikë më të prekur, për t'i mbajtur vendet e punës dhe jetesën. Pakot e shpëtimit ekonomik gjithashtu kishin një theks të kufizuar të gjellbër, andaj si rrjedhojë e kësaj mbrojtja e mjedisit jetësor nuk ishin një prioritet i menjëhershëm.

## Mbrojtja e resurseve natyrore

OKB-ja vazhdoi të sigurojë mbështetje për aspektet mbrojtjes së biodiversitetit dhe menaxhimit të tokës. Një studim i vlerësimit për Malin Sharr u përpilua, diskutua dhe verifikua me palët e interesuara, duke hapur rrugën drejt shpalljes së Malit Sharr si park nacional, që pritet bëhet deri në fund të vitit 2021; po ashtu procesi për rivlerësimin e liqenit të Ohrit filloi së bashku me Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (UNRN). Arritjet e tjera përfshijnë: azhurnimin e hartës nacionale të erozionit, baza e të dhënave për rrezikun e erozionit të tokës, shkalla e vulosjes së tokës dhe humbja e lëndës organike të tokës në tre zona pilot (Strumicë, Ohër dhe Prilep), si dhe harta të bimësisë së pyjeve në tre zona pilot (në Maleshevë) dhe Ograzhden), identifikimi dhe testimi i kuotave të propozuara për një specie të zgjedhur/barishte në të gjithë territorin e vendit me planin e sugjeruar të konservimit dhe rekomandimet për përdorim dhe mbrojtje të qëndrueshme.

Aktivitetet për identifikimin e dy korridoreve pilot nga Rrjeti Ekologjik Nacional i propozuar (MAK-REN), që janë të domosdoshme për testimin e mëtejshëm të masave specifike të zonës së filluar, duke përfshirë aktorët lokalë të interesuar për menaxhimin dhe restaurimin e pyjeve me vlerë të lartë të natyrës dhe habitateve të tjera. Ekipi më i gjerë i ekspertëve të biodiversitetit dhe pyjeve filluan punën e tyre në identifikimin e pyjeve me vlerë të lartë të natyrës duke kryer aktivitete të punës në terren në pilot vendet e zgjedhura (Bukoviç dhe Bellasicë), që do të çojnë në zhvillimin e udhëzimeve të menaxhimit deri në mesin e vitit 2021.

Së bashku me partnerët nacionalë, OKB-ja ndihmoi në ngritjen e profilit të vendit në lidhje me investimet në menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Shembuj të shkallëzuar që i demonstrojnë përfitimet



sociale dhe ekonomike nga mbrojtja e burimeve natyrore janë krijuar përmes zbatimit të një skeme granti për 25 zona të mbrojtura në të gjithë vendin, duke mbuluar sipërfaqen prej 241.755 hektarë. Më shumë se 600 përfaqësues të OShC-ve, qeverive lokale dhe autoriteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura i kanë përmirësuar kapacitetet për menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Për më tepër, 31 gra janë trajnuar dhe certifikuar si udhëheqëse malore në zonat e mbrojtura. Kjo e ka rritur ndërgjegjësimin e grave për mbrojtjen e natyrës dhe ka hapur mundësi të reja për gratë përmes turizmit të qëndrueshëm në zonat e mbrojtura.

## Bujqësia e qëndrueshme

OKB-ja e ka mbështetur zbatimin e raundit të parë të projekteve të konsolidimit të tokës nën Programin Nacional të Konsolidimit të Tokës për t'i ndihmuar pronarët e tokave bujqësore dhe komunitetet rurale, që ta adresojnë copëzimin e tepruar të tokës, për ta rritur konkurrencën e prodhimit bujqësor, për t'i përmirësuar kushtet jetësore dhe për të mundësuar menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonat rurale zonat. Në vitin 2020, konsolidimi i tokës përparoi në të nëntë zonat e synuara, duke mbuluar rreth 2,500 pronarë tokash dhe 3,000 hektarë tokë bujqësore.

Janë fuqizuar kapacitetet institucionale në nivel nacional dhe promovimi i praktikave të mira elastike në nivel lokal, me fokus në aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve për Shërbimin Nacional Hidrometeorologjik, zgjedhjen e vendeve për demonstrim pilot për shkollat e fushave të fermerëve lidhur me futjen e teknologjive të bujqësisë së mençur të klimës dhe hartimin e Strategjisë së ujitjes në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Gjithashtu në vitin 2020 filloi vlerësimi i dëmtimit të bujqësisë dhe metodologjia e humbjeve, ashtu siç ishin aktivitetet fillestare për avancimin e sistemit të farërave të vendit dhe kapacitetet për të siguruar farëra të përshtatshme dhe të qëndrueshme nën prizmin e ndryshimit të klimës.

## Ndotja e ajrit

Hapat fillestarë u ndërmorën për të krijuar një përgjigje kuptimplote ndaj ndotjes së ajrit në Shkup duke zhvilluar modele subvencioni për kategoritë e prekshme të qytetarëve, krijimin e një ueb platforme për mbledhjen dhe vizualizimin e të dhënave të monitorimit të ndotjes së ajrit, koordinimin e palëve të interesuara dhe pilotimin e një modeli të demonstrimit për masat që i adresojnë shkaqet e ndotjes nga ngrohja e shtëpive. Me mbështetjen e OKB-së përmes Laboratorit të Shkupit, Qyteti i Shkupit vazhdoi të kryesojë në zbatimin e masave prioritare të Strategjisë së tij të Ndryshimit të Klimës, duke zvogëluar kështu gjurmën e tij mjedisore dhe duke i përmirësuar kapacitetet e administratës publike për të hartuar dhe ofruar shërbime më të mira për qytetarët e tij. Gjithashtu, investimet në eficientësi dhe energjisë të dy ndërtesave publike - Shkolla e Mesme Bujqësore dhe Pyjore "Gjorge Petrov" në Kavadarë dhe kopshti "Detelinka" në Kriva Pallanka - ndihmuan në uljen e emisioneve.

## Ujërat e zeza

OKB-ja ka kontribuar në përpjekjet e koordinimit për të ndërtuar një impiant të trajtimit të ujërave të zeza (ITUZ) në Tetovë, duke pastruar vendin e projektit në fshatin Falishe. Kjo do të mundësojë që Komuna e Tetovës të ecë përpara me ndërtimin e ITUZ-së dhe duhet të ndihmojë në zvogëlimin e ndikimit negativ mjedisor të mbeturinave në rajonin e gjerë të Tetovës. Më tej, me mbështetjen e OKB-së 240 banorë të fshatit Suvodol, Komuna e Makedonski Brod kanë qasje në sistemin e kanalizimit pas

3,000 hektarë të bujqësisë në fazë të avancuar të konsolidimit të tokës.  
Foto©FAO



përfundimit të punimeve të ndërtimit; kjo ndërhyrje gjithashtu e uli ndotjen e ujërave nëntokësore.

## Zvogëlimi i rrezikut të fatkeqësive

Zbatimi i Kornizës Sendai për Zvogëlimin e Rrezikut nga Katastrofa u avancua përmes veprimeve të zbatuara në rajonin e Pollogut, me fokus në kuptimin e rreziqeve të katastrofave, përmirësimin e qeverisjes së plotë të Rrjetit për Pologun e qëndrueshëm, rritjen e rezistencës së zvogëlimit të katastrofave dhe zhvillimin e një udhërrëfyesi për financimin e rrezikut nga përmbytjet dhe transferimin e rrezikut. Menaxhimi i rrezikut nga përmbytjet në rajon u zhvendos nga reagimi vetëm në sisteme të integruara për t'i menaxhuar rreziqet, dobësitë dhe ekspozimin e komuniteteve dhe aseteve, në mënyrë që t'i parandalojë dhe zbutë humbjet, dhe ta lehtësojë ndikimin e përmbytjeve të ardhshme.

Kapacitetet e Shërbimit HydroMet janë forcuar përmes mbështetjes së dhënë për zgjerimin e rrjetit nacional të stacioneve hidrologjike dhe meteorologjike. Në rajonin e Pollogut, 32 stacione u modernizuan dhe/ose u vendosën, gjegjësisht 14 stacione në pellgun e lumit Drin. Po ashtu, HydroMet iu dha versioni i fundit i bazës së të dhënave/softuerit klimatologjik CLIDATA së bashku me pajisjet e reja për teknologji informatike (TI). Kjo ndihmë do ta përmirësojë mbledhjen e të dhënave dhe kapacitetet analitike të Shërbimit HydroMet, por gjithashtu krijon një bazë për krijimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm në pellgun e lumenjve të Pollogut dhe Drinit. Qasja unike për azhurnimin e vazhdueshëm të Planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytja (PMRRP) për rajonin e Epërm/rajoni i Vardarit/Pologut me të dhëna dhe informacione nga kërkimi dhe studimet e reja, si dhe modelimi i bërë si pjesë e përgatitjes së dokumenteve teknike, siguroi që PMRRP ngel dokumenti relevant i planifikimit.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse është dokumenti kryesor që duhet t'i jep trajtë dhënies përparësi të intervenimeve për zbutjen e rrezikut fillestar dhe alokimin e fondeve. Plani gjithashtu duhet të merret në konsideratë gjatë zhvillimit të përdorimit të tokës dhe planeve urbane, si dhe të planeve tjera të zhvillimit të komunave dhe rajonit. Pastrimi dhe largimi i 35t sedimenteve nga dalja e lumit Drini nga Liqeni i Ohrit dhe pjesa urbane e shtratit të lumit Drin në gjatësi prej 765 metra e zvogëloi rrezikun e përmbytjes në Qytetin e Strugës (rreth 16,500 banorë) dhe u mirëprit nga qytetarët sepse shtrati i lumit nuk ishte pastruar në 40 vitet e fundit.

Përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë të OKB-së për përgjigjen ndaj krizave COVID-19 (shih raportin kryesor, seksioni i përgjigjes

*OBSH duke dhuruar monitorë për pacient, oksimetra të pulsit dhe termometra digjital infra të kuqe për mbështetje të menjëhershme në Klinikën e Neurologjisë në Shkup. Foto ©OBSH*



KOVID-19), zbatimi i masave të gatishmërisë së hershme dhe mbështetja për zhvillimin e kapaciteteve ishin thelbësore për forcimin e kapacitetit të sistemit shëndetësor për përballje me krizën. OKB-ja e mbështeti rritjen e kapacitetit fillestar të testimit të vendit nga 150 teste/ në ditë në 3,500 teste/ditë. Protokollet specifike të OBSH-së për mbrojtjen e shtëpive të të moshuarve u zbatuan një muaj para se të zbulohej rasti i parë KOVID-19 në vend, andaj më këtë mënyrë u kursyen këto institucione nga përhapja e pandemisë.

Krijimi i Qendrës së Inteligjencës Epidemike dhe Operacioneve Emergjente të mbështetur nga OKB-ja e ka rritur kapacitetin e vendit për menaxhimin dhe monitorimin e emergjencave, e ka forcuar komunikimin dhe koordinimin dhe e ka rritur kapacitetin e gjurmimit të kontakteve.

Si pjesë e përgjigjes emergjente ndaj pandemisë KOVID-19, OKB-ja ka siguruar prokurimin e 65 pajisjeve për ventilim mekanik, 29 monitorë të kujdesit intensiv, 10 përqendruar statik të oksigjenit, komplete për mbi 100,000 teste, mbi 35,000 artikuj të specializuar të pajisjeve mjekësore si kateter, infuzion

## 3,500 punonjës shëndetësor të trajnuar

sistemet e pompës dhe shiringa. OKB-ja dhuroi institucioneve të kujdesit shëndetësor në vend ose iu mundësoi blerjen dhe dorëzimin e mbi 2 milion artikujve të pajisjeve mbrojtëse personale, duke përfshirë maska, doreza, skafanderë, maska të tejdukshme, mbulesa këpucësh dhe kapota mbrojtës, si dhe mbi 5,000 litra dezinfektues dhe pastues për të ndihmuar në mbrojtjen e personelit mjekësor dhe pacientëve.

Përshatatja e përshpejtuar dhe shtrirja e programeve të trajnimit që synojnë punonjësit shëndetësorë për çështje specifike të KOVID-19 mbuloi më shumë se 3,500 punonjës të kujdesit shëndetësor, duke rritur me forcë kapacitetin e fuqisë punëtore shëndetësore të vendit në të gjithë shtetin. Përvetësimi i këtyre kurseve të akredituara u monitorua rregullisht në partneritet me drejtorinë e e-shëndetit (<https://obuki.zdravstvo.gov.mk/login>).

OKB-ja e mbështeti zhvillimin e një baze të të dhënave të integruara nacionale të rasteve pozitive KOVID-19, duke tërhequr të dhëna nga laboratorët nacionalë që kryejnë testimin; dhe ngritjen e një liste digjitale të fuqisë punëtore shëndetësore në dispozicion për ta mbështetur planifikimin e kapaciteteve të rritjes.

Zbatimi i sondazheve të depërtimit të sjelljes gjatë vitit 2020 i mbështeti vendimmarrësit dhe komunikuesit në lidhje me të kuptuarit e pranueshmërisë nga popullata të masave të shëndetit publik, njohuritë dhe besimin e tyre ndaj masave dhe ofroi depërtim në perceptimet e rrezikut.

Puna për gatishmërinë e emergjencave vazhdoi përmes rishikimit vjetor të Planit të veprimit të Pakos minimale të shërbimit fillestar (PMSHF) mbi shëndetin seksual dhe riprodhues, e realizuar në mënyrë pjesëmarrëse, për ta përfshirë kontekstin e KOVID-19; po ashtu u mbajtën trajnime shtesë për PMSHF.

## REZULTATI 5

## Barazia gjinore

*Deri në vitin 2020 institucionet nacionale dhe lokale do të mund më mirë të hartojnë dhe realizojnë shërbime të cilësisë së lartë për të gjithë përdoruesit, në mënyrë transparente, me kosto efektive dhe duke iu përmbajtur parimeve të ndjeshmërisë gjinore.*

## Kontributi në:



Barazia gjinore dhe mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat  
Parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave  
Bërja e politikave dhe buxhetimi i përgjegjshëm ndaj gjinisë i bazuar  
në të dhëna të ndara



23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore  
19: Politika Sociale dhe Punësimi  
19.7: Anti-diskriminim dhe mundësitë e barabarta

Agjencitë e OKB-së që kontribuojnë në përmbushjen e këtij rezultati:  
FAO, IOM, OHCHR, UNDP, UNFPA, UNICEF, UN Women

Qeveria dhe partnerët tjerë zhvillimorë:

Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, njësitë e vetëqeverisjes lokale, Avokati i Popullit, shoqëria civile, sektori privat, bota akademike dhe të tjerët.

### (5.1) Legjislacioni mbi dhunën gjinore dhe kundër diskriminimit është harmonizuar me standardet ndërkombëtare

OKB-ja kontribuoi në përafrimin e legjislacionit nacional për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Ligji kundër diskriminimit i njeh të gjitha bazat e ndaluara nga e drejta ndërkombëtare duke përfshirë, për herë të parë, orientimin seksual dhe identitetin gjinor, si dhe format serioze të diskriminimit. Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen kundër Dhunës ndaj Grave (ligji DhGj), i hartuar në fund të vitit 2020 dhe i miratuar menjëherë pas kësaj, siguroi zbatimin e Konventës së Stambollit të Këshillit të Evropës, si dhe standardet përkatëse të OKB-së të dhe Direktivat e BE-së. OKB-ja ofroi këshilla në zhvillimin e një Ligji të ri të barazisë gjinore dhe një strategji dhe plan nacional të veprimit, ndryshime në kodin penal për të përfshirë krime të reja kundër grave dhe një ligj të ri mbi kompensimin e financuar nga shteti për viktimat e të gjitha formave të krimeve të dhunshme, përfshirë DhGj-në dhe DhF.

OKB-ja e ka mbështetur Ministrinë e Mbrojtjes dhe ka kontribuar në zhvillimin e Planit të dytë nacional të veprimit (PNV) për Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, nga Agjenda për gratë, paqen dhe sigurinë. Qeveria e miratoi një kornizë strategjike për PNV-në, si dhe planet operative të institucioneve që do ta zbatojnë PNV-në.

### (5.2) Institucionet publike dhe OSHC-të i kanë rritur kapacitetet për parandalimin e diskriminimit dhe dhunës gjinore, gjegjësisht mbrojtjen e të mbijetuarve

Kapacitetet e institucioneve publike dhe OSHC-ve janë rritur më tej për t'i zbatuar konceptet e barazisë dhe për ta adresuar në mënyrë efektive diskriminimin. Në vitin 2020, Zyra e Ombudsmanit mori 60 ankesa mbi diskriminimin dhe lëshoi 24 mendime; shoqëria civile raportoi 130 raste DhGj-së që përfunduan me një epilog gjyqësor. Gjithsej 350 nëpunës publikë dhe 40 profesionistë, duke përfshirë administratën komunale, shërbimet sociale dhe përfaqësuesit e OSHC-ve, të cilët ofrojnë shërbime mbështetëse dhe ndihmë juridike për viktimat, i kanë avancuar njohuritë e tyre mbi barazinë gjinore dhe DhGj-në. Dy qendra shtesë të veprimit kundër sulmeve seksuale janë vënë në funksion, të cilat janë kritike për ndihmën e menjëhershme dhe referimin e viktimave.

### (5.3) Ministrinë përkatëse/institucionet publike dhe Ombudspersoni i kanë rritur kapacitetet për të trajtuar diskriminime të shumfishta të grupeve më të marginalizuara të grave dhe për t'u përgjigjur nevojave të tyre

Përgjigje multi-disiplinore dhe koordinimi ndër-sektorial në trajtimin e diskriminimit, pabarazive gjinore dhe DhGj-së është përmirësuar përmes përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve, fushatave të ndërgjegjësimit, materialeve të informacionit dhe mjeteve inovative që përqendrohen në grupet që përballen me diskriminim të shumfishtë në rrezik për t'u lënë pas. OKB-ja ndihmoi në prodhimin e protokolleve speciale për funksionimin e sigurt të qendrave të strehimit për viktimat e DhGJ, si dhe dy protokolle shtesë për funksionimin e sigurt të qendrave të referimit të sulmeve seksuale në kontekstin e KOVID-19, duke bërë të mundur mbështetjen dhe shërbimet e ndihmës më efektive.


### (5.4) Organizatat e shoqërisë civile i mbështesin dhe përfaqësojnë në mënyrë më efektive gratë dhe vajzat në adresimin e pabarazive gjinore në sferën publike dhe private

Mbështetja e OKB-së për shoqërinë civile i dha më shumë hov ngritjes së zërit për gratë dhe agjencive të grave dhe vajzave në adresimin e pabarazive gjinore, stereotipave negative dhe dhunës ndaj grave. Autoritetet nacionale dhe lokale i bashkuan forcat me gratë dhe organizatat bazë për t'u ngritur dhe ndërmarrë veprime

*Trajnim dyditor mbi barazinë gjinore dhe luftimin e stereotipave gjinorë në mbrojtje, organizuar nga Ministria e Mbrojtjes, me mbështetjen teknike të UN Women. Trajnimi është pjesë e aktiviteteve për ta përkujtuar 20 vjetorin e Rezolutës 1325 të UNSCR dhe 25 vjetorin e Deklaratës dhe Platformës së Pekinit për Veprim. Foto©UN Women/Ministria e Mbrojtjes*



*Mediat kanë rol të fuqishëm të cilin duhet ta luajnë në luftën kundër dhunës së bazuar në gjini. OSHC-ja HOPS - Projekti për Mundësi të Shëndetshme-Shkup me organizatat partnere "Koalicioni Margjinat" dhe "Rrjeti Nacional për parandalimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje" kanë zhvilluar tri module për përmirësimin e njohurive mbi dhunën e bazuar në gjini për lloje të ndryshme të profesionistëve mediatik: Kjo iniciativë është pjesë e programit të BE-së dhe UN Women "Zbatimi i Normave, Ndryshimi i Mendjeve", i financuar nga Bashkimi Evropian". Foto©UN Women/OSHC Hops*



për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave. 263 gra marrin pjesë në formësimin e 144 rekomandimeve të politikave lokale. Pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje, së bashku me buxhetimin e përgjegjshëm ndaj gjinisë dhe prioritizimin e nevojave specifike gjinore në kohë pandemie është përmirësuar përmes ndërtimit të kapaciteteve, shtrirjes së informacionit dhe iniciativave të rrjetëzimit. Platforma në internet për studentët për ta ndarë me të tjerët punën e tyre në lidhje me DhKG dhe DhF dhe një aplikacion celular "Bëhu i/e Sigurt" e zhvilluar në 3 gjuhë (shqip, maqedonisht dhe gjuhë rome) është përdorur gjerësisht për ndërgjegjësimin dhe raportimin e DhGj-së.

Mbështetja e OKB-së e shumëfishoi mbështetjen dhe krijoi ndërhyrje më të forta midis grave dhe organizatave bazë dhe autoriteteve nacionale dhe lokale në integrimin gjinor dhe adresimin e pabarazive gjinore, stereotipave negative dhe dhunës ndaj grave, përfshirë:

- Fushatën e avokimit për fuqizimin e grave e udhëhequr nga dy organizata të grave, 14 organizata lokale bazë dhe dy shoqata të autoriteteve lokale;

- 263 gra që morën pjesë në formulimin e 144 rekomandimeve të politikave për programet komunale dhe buxhetet gjinore; 36 përfaqësues të OShC-ve të aftësuar për mbikëqyrje të politikave dhe buxheteve komunale nga perspektiva gjinore;
- 15 OSHC që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës me bazë gjinore ishin bashkëpunëtorë aktivë dhe ofruan përmbajtje në aplikacionin celular "Bëhu i/e sigurt";
- 18 profesionistë të shkollës së mesme u trajnuan për parandalimin e dhunës ndaj grave; dhe
- 1,897 persona përfituan drejtpërdrejt nga implementimi i projekteve të OShC-ve në 5 komuna, prej të cilëve 535 burra, 396 gra dhe 966 fëmijë, fokusi i të cilave ka qenë në angazhimin e të rinjve dhe njerëzve nga grupet e ndjeshme, gjë që rezultoi në angazhimin e 989 personave të përfshuar nga shoqëria, përfshirë fëmijët romë, personat me aftësi të kufizuara dhe shoqërimin e të rinjve gjatë pandemisë KOVID- 19.

**(5.5) Zyrtarët publikë e kanë përmirësuar kapacitetin për t'i analizuar të dhënat e ndara gjinore dhe i kanë përfshirë konsideratat gjinore në formulimin dhe zbatimin e politikave dhe buxheteve në nivelin qendror dhe lokal**

Numri i politikave dhe buxheteve të krijuara është rritur përtej objektivave të përcaktuara për vitin 2020 - 14 ministri (10/15) dhe 21 komuna (15/81). Është përgatitur Strategji e re Nacionale për Barazinë Gjinore (2021-2026), Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2021-2027) dhe Strategjia e Zhvillimit Rajonal (2020-2029), është përgatitur Projektligji i Buxhetit Organik, të cilat kanë një fokus të fortë në ndërthurjen dhe pjesëmarrjen kuptimplote të grave në proceset e planifikimit dhe buxhetimit. Projektligji i Buxhetit Organik, për herë të parë, përfshin parime të përgjegjshme gjinore. Kapacitetet e zgjeruara lokale përfituan 51 programe dhe plane të veprimit për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave me një alokim adekuat të buxhetit të përgjegjshëm ndaj gjinisë, onlajn platformën në pronësi lokale dhe Indeksën e Zhvillimit të Komunës si një burim për të dhënat e ndara gjinore.

